Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 9 (101). SHTATOR 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

PANAIRI I LIBRIT

Ta kthejmë librin në odat e Dibrës...

Nga **ILMI DERVISHI** - FAQE 16

BOTIME

Një libër për Kolgjegjën dhe etnokulturën

Nga **FEJZULLA GJABRI** - FAQE 15

TOPONIMIA

Gurabardha e Dibrës dhe Maqedonia

Nga **AGIM ÇADRI** - FAQE 19

BLOGGER

JASHTË RRUGËS:

S'kam ku ec!

DITARI I NJË VAJZE:

Katundar nderi!

FAQE 12

SKAVICA

Rikthehet debati: Të ndërtohet apo jo!



- **Pse dështoi tenderi në dhjetor 2008?**
- **Skavica, me një digë apo me tre diga?**
- **Çfarë parashikon projekti i KESH për ndërtimin e dy digave në vend të Skavicës së madhe?**
- **A vazhdon ideja e Skavicës së projektuar në vitet 1980 apo mbeten zgjidhje të mundshme ndërtimi i 2 apo tre digave?**
- **Specialistët: Zgjidh nevojat për energji dhe bën funksionale kaskadën e Drinit.**
- **Kundërshtarët: Mbyt "hambarin" e Dibrës, ndan Dibrën në dy pjesë dhe e bën jo funksionale. Dëmtohet ekosistemi. Mbyt trashëgiminë historike dhe kulturore. Kompensimi i ulët dhe krijon probleme sociale gjatë shpërnguljes së popullsisë.**

Një panoramë e historisë së hidrocentralit që ka penguar zhvillimin e rajonit që nga vitet '60 të shekullit të kaluar.

Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 4-5

Rruga e Arbrit

Rama: Jemi duke **finalizuar** një marrëveshje për **financimin**

Gjatë vizitës në Kinë në fillim të muajit shtator, Kryeministri Edi Rama u takua me homologun e tij kinez, Li Keqiang. Raportimet e para të mediave theksuan se dy kryeministrat kanë diskutuar për investimet kineze dhe se qeveria kineze do të mbështesë ndërmarrjet kineze të ndërtimit të angazhohen në zhvillimin e infrastrukturës në Shqipëri. Gazeta "Tema" raportoi se një nga investimet kineze do të ishte edhe autostrada Shqipëri - Maqedoni.

FAQE 2

Oda Dibrane

Festivali i këngës, valles humoristike, **ritit** dhe **alegorisë**

Festivali "Oda Dibrane" hap dyert e saj më 23-26 tetor 2014, duke shënuar njëkohësisht edhe 20 vjetorin e saj. Këtë vit, për herë të parë festivali do zhvillohet edhe në Dibër të Madhe, duke hapur kështu një epokë të re në mënyrën e organizimit. "Oda Dibrane" ka nisur nisur jetën e tij në vitin 1994, i konceptuar në fillim si takim i rapsodeve popullore.

FAQE 7

Studim

Reka e Epërme, **plagë e pashëruar** në popull

Edhepse pjesa dërmuese e banorëve të Rekës së Epërme, ishin të detyruar të migrojnë në vise të ndryshme të botës, ata pa dallim feje sot kudo që gjenden qëndrojnë krenar, nuk ju tremben tërbimit të politikës as në të kaluarën dhe as sot.Bartin mbi supet e tyre kudo që gjenden traditën, folklorin, ritet, veshjen popullore shqiptare e tjerë.

NGA **EDIBE SELIMI-OSMANI** - FAQE 21

Edi Rama: "Ka një komponent që lidhet drejtpërdrejt me mbështetjen e qeverisë kineze, por ka dhe një komponent tjetër qe lidhet me krijimin e kushteve për sipërmarrjet private kineze. Për sa i përket pjesës që lidhet me qeverinë kineze, ne praktikisht jemi duke finalizuar një marrëveshje për financimin e punimeve për Rrugën e Arbrit, dhe ndërkohë jemi duke diskutuar për një serë projektesh të reja...

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 9 (101). 1 - 30 Shtator 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: R.Gjini, A.Keta, F.Xhani, S.Mëziu, H.Përnezha, J.Selmani, D.Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Kontribuan për këtë numër:

Marin MEMA
Hysen LIKDISHA
Edibe SELIMI - OSMANI
Abdurahim ASHIKU
Fejzulla GJABRI
Hamit TAKA
Ilmi DERVISHI
Agim ÇADRI
Xhelal ROCI
Ramadan AJAZI
Mevlud BUCI
Rasim BUCI
Selman MZIU
Zabit LLESHI
Mehdi DEMA
Namik LAÇI

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Falënderojmë z. Kadri Cani dhe Defrim Methasani për kontributin e dhënë për gazetën.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640


Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Kryeministri Edi Rama deklaron nga Kina:

Jemi duke finalizuar një marrëveshje për financimin e punimeve për Rrugën e Arbrit



Gjatë vizitës në Kinë në fillim të muajit shtator, Kryeministri Edi Rama u takua me homologun e tij kinez, Li Keqiang. Raportimet e para të mediave theksuan se dy kryeministrat kanë diskutuar për investimet kineze dhe se qeveria kineze do të mbështesë ndërmarrjet kineze të ndërtimit të angazhohen në zhvillimin e infrastrukturës në Shqipëri. Gazeta "Tema" raportoi se një nga investimet kineze do të ishte edhe autostrada Shqipëri - Maqedoni.

Më datë 11 shtator, gjatë një interviste për radion e jashtme kineze CRI, pyetjes së gazetares se "Cilat fusha shikoni më me përparësi për zhvillimin e bashkëpunimit me Kinën?", kryeministri Rama iu përgjigj:

"Ka një komponent që lidhet drejtpërdrejt me mbështetjen e qeverisë kineze, por ka dhe një komponent tjetër qe lidhet me krijimin e kushteve për sipërmarrjet private kineze. Për sa i përket pjesës që lidhet me qeverinë kineze, ne praktikisht jemi duke finalizuar një marrëveshje për financimin e punimeve për Rrugën e Arbrit, dhe ndërkohë jemi duke diskutuar për një serë projektesh të reja, ku do të përmendja projektin e sistemit hekurudhor që mund të jetë një projekt i financueshëm nga pala kineze, duke pasur parasysh dhe interesimin e shprehur nga qeveria kineze për rajonin në tërësi në këtë aspekt, projektin e autostradës së kaltër, gjë që e kemi biseduar edhe në takimin e Bukureshtit, padyshim projekte që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e bujqësisë dhe jo vetëm të infrastrukturës, peshkimit, por edhe të arsimit...".

Pas kthimi nga Kina qeveria shqiptare nuk ka bërë ndonjë deklaratë të hollësishme për rezultatet e takimeve. Një burim i tha gazetës se në fund të muajit shtator, një delegacion kinez do të vijë në Tiranë dhe do të inspektojë terrenin nga do të kalojë Rruga si dhe do të diskutohet për detaje të marrëveshjes.

Ministri i Financave Shkëlqim Cani, gjatë një vizite në Minisrën e Bulqizës, pyetjes së gazetarëve për ndonjë informacion shtesë për marrëveshjen me kinezët lidhur me rrugën, tha se "'Rruga e Arbërit´ ka hyrë në rrugë, por ende problemi nuk është zgjidhur".

Ndërkohë që po flitet për një investim kinez, me shumë gjasa në formën e një koncensioni, janë rritur shpresat për ndërtimin e një rrugë më standarde të larta europiane, në parametrat e një autostrade.

Për ndërtimin e një autostrade Shqipëri - Maqedoni është folur edhe më herët.

Shefki Aliti është një inxhinier, i cili merret me projektim dhe ndërtim rrugës në Maqedoni. Ai ka një eksperiencë 30 vjeçare të ndërtimin e rrugëve në Maqedoni, Zvicër etj. Shefki Aliti është një ndër të parët që ka përgatitur një projekt ide për Rrugën e Arbrit që nga viti 2007, dhe në atë projekt ide ai fliste për një autostradë, e cila nuk parashikonte vetëm rrugën, por edhe linjë hekurudhore.

Gjatë një intervistë për gazetën Rruga e Arbërit në Korrik 2014, ai theksonte se "Projekti përmban gjithë nivelet e një projekti gjeneral, duke llogaritur përshkrimin teknik dhe një historik të shkurtër të Rrugës Arbrit. Rruga është projektuar me katër korsi me nga 3.5 m secila, dy korsi ndihmëse me 2.5 m, bankinat dhe brez gjelbërimi në anësore me nga 1.5 m. Pra, projekti përcaktonte një profil-gjerësi prej 25,5 m dhe gjatësia e trasesë nga Tirana, Dajti, Bulqiza deri në kufirin shqiptar-maqedonas me një gjatësi prej 64 km. Projekti përcaktonte shpejtësinë prej 100-120 km /orë dhe i jepte rrugës një karakter autostrade europiane".

Sipas Alitit, "atij iu premtuan se do të shpallej tender për projektin zbatues të autostradës Rruga e Arbrit dhe na kërkuan neve të përpilojmë edhe studimin mjedisor. Së bashku me Sazan Gurin formuam një grup pune të shkencëtarëve shqiptar dhe e mbaruam studimin voluminoz dhe e dorëzuam te këshilltarët e ministrit. Ata premtuan se, neve, grupit te inxhinierëve nga Maqedonia do të na caktojnë punimin e projektit zbatues. Projekti cakton edhe veprat e artit dhe tunelet. Projekti parasheh ndërtimin e 9600 m tunele si dhe 2460 m vepra arti. Projekti ishte i punuar me profile tërthorë dhe gjatësorë. Gjithashtu, projekti caktonte koston e ndërtimit, pra ka një parallogaritje për vlerën në euro". Por Aliti në atë intervistë akuzoi drejtuesit e ministrisë se "Thjesht e morën projektin tonë të nivelit gjeneral dhe e ndanë në katër pjesë, dhe pa fije turpi ua dhanë firmave të afërta me ministrin dhe stafin e ministrisë. Ata, firmat, sëbashku me inxhinierët e ministrisë e deformuan komplet projektin tonë, duke projektuar një trase të re afërsisht e ngjashme me projektin tonë, por me gabime fondamentale, me trase me një kahje dhe me shpejtësi maksimale 80 km/orë, jashtë standardeve evropiane, me shumë kthesa jashtë standardeve. Shpejt e shpejt i filluan punimet për një autostradë qe nuk ka lidhje me standardet e ndërtimit të rrugëve. Pra filloi ndërtimi i një rruge lokale dhe jo një autostrade që duhet të lidhë dy shtetet dhe më tej"

Gjatë vitit 2008 Drejtoria e Rrugëve e ktheu disa herë projektin, njëherë duke kërkuar të projektohej si rrugë me gjerësi 7.5 metra, dhe më pas si rrugë me gjerësi 9 metra. U desh ndërhyrja e Ministrit të Transporteve të asaj kohe që të ndërhyhej me një projekt për një rrugë me gjerësi 11 metra, përfshirë bankinat anësore.

Deklaratat e kryeministrit nga Kina se do ndërtohet një autostradë, në fakt kanë rritur shpresat, jo vetëm për gjetjen e financimeve, por edhe për ndërtimin e rrugës me standarde të larta.

Opinioni publik në vend dhe shoqëria civile e kanë pritur me skepticizëm deklaratën e kryeministrit Rama nga Kina. Të mësuar me premtimet boshe të politikanëve për vite me radhë, besimi te qeverisja rikthehet vetëm kur makineritë ti shohim në punë...

B.Karoshi

reportazh




Foto panoramike: Në Qafë të Murrizës, aty ku ndahet kufiri mes Dibrës dhe Tiranës dhe ku shihet me sy të lirë Qafa e Tujanit dhe Qafa e Buallit.... Foto: © B. Karoshi

Pas Tiranës...vjen Dibra

Udhëtimi përmes Brarit, Zall Dajtit, Kodër Shupalit, Zallbastarit, Bastarit e fshatit Kaçu, duket si një kthim pas në kohë.

Nga **MARIN MEMA** *

Jemi vetëm pak kilometra nga Tirana, por asgjë nuk të bën të kuptosh përveç pozicionit gjeografik në hartë, se këto zona i përkasin pikërisht kryeqytetit. Gjurmët e rrugës së Arbërit, që duhet të prekë këtë zonë, humbin shpejt, ndërsa rruga, një shteg i stisur, dredhon sipërmi.

"Nga lartësia e qafës së Murrizit mund të shikosh edhe pallatet shumëkatëshe të kryeqytetit, e po ashtu nga i njëjti vend, në krahun tjetër, mund të shikosh edhe qafën e Buallit, që i paraprin qytetit të Bulqizës. Nga ky vend duhet të kalojë rruga e Arbërit, që do të bashkonte të gjithë këtë zonë. Në fakt, sot kjo është një pikë kufitare, një pikë ndarëse, që mban të izoluar dhjetëra fshatra, një zonë të tërë, mes tyre edhe fshatin e Xibër Murrizit, që sot për kilometra duhet të ishte një lagje e kryeqytetit, por në fakt ndodhet pafundësisht larg tij".

Rruga në zbritje është edhe më e vështirë se ngjitja, aq sa hera-herës duket se një gabim i vogël mund të të flakë poshtë në humnerë.

Xibër Murrizi, me rreth 900 banorë, ngrihet i shpërndarë në të gjithë terrenin e thyer të zonës. Zyrtarisht ndodhemi vetëm 27 apo 28 kilometra nga kryqyteti, edhe pse na është dashur rreth dy orë e gjysmë për të mbërritur këtu.

"Ne, edhe me këtë periudhë, dmth pa ardhur dimri, vetëm me shira, përdorim zinxhirët, sepse nuk del makina fare", shprehet Idajet Velsula.

"Dy orë në këmbë, 1 orë me makinë. Ku të shkojmë, ngelet makina kur bie borë. Shumë vështirë të vijmë në Tiranë", thotë Aqif Tahiri.

Fshati, tokat i ka të pakta. Ato llogariten jo më shumë se 5 dynym për familje, e që banorët i mbjellin me domate, patate, misër apo fasule, duke marrë një prodhim të mjaftueshëm vetëm për përdorim personal. Edhe ata që kanë diçka më shumë, e kanë të vështirë, për të mos thënë të pamundur, ta tregtojnë diku.

"Me nga një lopë, me nga tre-katër të imta, me atë pak tokë që kanë, prodhojnë domate, patate, vendi është prodhues, por s'ka ujë vaditës. Nuk ka ku të çosh mallin, dëmtohet ta marrësh 1 orë ta transportosh me kafshë, ta nxjerrësh te makina, plus të shkosh dy orë deri në treg. Atje nuk ke mbështetje, se nuk të le kush të sistemohesh në asnjë vend, sepse je i ardhur prej rruge edhe tallen, ka raste që del, por vjen policia e mallin ta hedh në asfalt, ngelesh i mjeruar", thotë Halil Diku.

Edhe ata që merren me blegtori nuk e kanë më të lehtë, përkundrazi...

"S'ka për t'i llogaritur fare. Shet një viç 400-500 mijë lekë, 4-5 qingja, pak tokë, këto janë të ardhurat tona. Me atë viç, nëse i marr 500 mijë lekë, unë e zëmë 100 mijë lekë i dua në muaj, ja shkoj 4-5 muaj, po muajt e tjerë? Pra me një viç të shitur, duhet të jetoj 1 vit", thotë Gani Dalipi.



Pamje nga fshati Xibër - Murrizë, aty ku do kalojë Rruga e Arbërit. Foto: © B. Karoshi

Për të kuptuar gjendjen e vështirë ekonomike, mjafton të ndalesh në një prej pikave të tregtimit në fshat, nëse mund të quhet vërtet kështu. Dertet e borxhet kanë mbytur jetët e banorëve.

"Këtu unë jam me fletore, kam lista, lista prej 20 vjetësh. Është shumë e vështirë, që nuk vijnë me ato lekë", shprehet Halil Beshiri.

Shtëpive u ndihet pesha e kohës e kjo sepse, edhe nëse duan të restaurojnë diçka, duhet të paguajnë shumëfish sjelljen deri në fshat të mjeteve të nevojshme. Një kamion me rërë kushton jo më shumë se 3 mijë lekë, ndërsa për ta sjellë deri në fshat plot 20 mijë, e po kështu me tjegullat, me tullat, gurët a shumëçka tjetër.

"Edhe xhenazet, kur na vdesin njerëzit në spital, nga gropat dhe nga rruga që është kështu pa vënë dorë, u plas hemorragjia. Leji të tjerat, se nuk ke ç'i përmend fare", tha Mehmet Sula.



Dyqani i fshatit Xibër - Murrizë.

Vetë banorët, kohë më parë, kanë vënë një pjesë të shtyllave të energjisë e transformatorin, ndryshe, edhe sot do të ishin në terr, nëse gjithçka do të kish mbetur në dorë të strukturave përkatëse. Fundja ata këtu nuk ekzistojnë, apo më mirë duken si një vegim i largët.

"Nuk kemi asnjë farmaci për të marrë një medikament të vogël, vuajmë. Fshati ynë është shumë i varfër, përkrahemi me ndihmë ekonomike shumë të ultë, pensioni gjithashtu i ulët", shprehet Beqir Beshiri.

Fshatit, që duhej të ishte një pjesë e lagjeve të Tiranës, - kilometrat të paktën e imponojnë këtë, - problemet nuk i mbarojnë kurrë. Përkundrazi, ato duken po aq të larta sa edhe qafa e Murrizit, që i mban të ndarë nga pjesa tjetër.

Banorët tashmë presin me sytë nga rruga e Arbërit, ajo është shpresa e tyre e vetme, ashtu si për të gjithë zonën që ky aks do të prekë. Në një rast tjetër, Xibër Murrizi me natyrën e njerëzit e tij do të ishte një vend turistik, një oaz i vogël me natyrë të paprekur, shumë afër Tiranës së betonit, e megjithatë deri më sot kryeqyteti është larg, ndërsa Xibër Murrizi merr frymë i izoluar aty pas.

** Reportazhi është transmetuar në emisionin "Shqipëria Tjetër" në Top Channel. Titulli është i redaksisë. Falenderojmë autorin lejen e dhënë në botimin e këtij reportazhi.*

Rruga e Arbërit nr. 101
raport

SKAVICA

Rikthehet debati: Të ndërtohet apo jo!



Nga **BUJAR KAROSHI**

LAJMI QË RIKTHEN DEBATIN

Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës rishfaqet sërish në qendër të vëmendjes së qeverisë shqiptare.

Është Ministri i Energjisë dhe Industrisë z.Damian Gjiknuri, i cili gjatë një interviste për Radion e Jashtme të Kinës, duke folur për hapësirat e zhvillimit ekonomik mes dy vendeve, theksoi se "gjatë kontaktit me konsorciumin Power China Corporation patëm një diskutim shumë intensiv me ta lidhur me disa projekte me interes të përbashkët në fushën e prodhimit të energjisë elektrike, siç është hidrocentrali i Skavicës, duke rënë dakord për disa hapa të mëtejshëm se si mund ta zhvillojmë këtë projekt, si edhe për një projekt të mundshëm në sektorin e shpërndarjes së energjisë elektrike, sidomos për të luftuar fenomenin e vjedhjes së energjisë elektrike, nëpërmjet teknologjive dhe aplikacioneve që janë përdorur në vende që kanë pasur situata të ngjashme. Jemi në një rrugë të mbarë, jemi duke diskutuar dhe presim që ekipet e specialistëve kinezë të vijnë në Shqipëri dhe të hulumtojnë nga afër çka do të bëjmë në lidhje me zgjidhjet teknike të propozuara dhe më pas të shikojmë zgjidhjet ligjore dhe financiare të këtyre projekteve".

Kjo deklaratë ka rikthyer edhe njëherë në qendër të debatit në vend nëse duhet ndërtuar apo jo Hidrocentrali i Skavicës. Një pjesë e opinionit, kryesisht lokal, është kundër ndërtimit të saj, ndërsa qeveria dhe projektues hidrocentralesh në vend shprehin domosdoshmërinë e ndërtimit sa më të shpejt të saj.

SKAVICA, NJË PROJEKT I VJETËR APO NJË VEPËR E MADHE?

Ideja për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës fillon që në vitet 1960. Pas studimesh për rreth dy dekada, rreth viteve 1980 filloi të flitej publikisht për të. Sipas projektit të asaj kohe,

hidrocentrali do të ndërtohej në grykën e Skavicës, ku shtrati i Drinit të Zi ngushtohet deri në 40 metra në një gjatësi 5-6 kilometra. Që në atë kohë studimi kishte paraparë dy zgjidhje te cilat në vetvete përbënin dy projekte të ndryshme.

Zgjidhja e parë parashikonte ndërtimin e një dige 163 metra të lartë, që krijonte një liqen artificial me nivel normal të tij në kuotën 445 metra mbi nivelin e detit. Vëllimi i digës do të ishte 11 milionë metër kub. Ky variant përmbyste luginën e Drinit të Zi deri në kufi me ish-republikën Jugosllave të Maqedonisë. Vëllimi i liqenit do të ishte 2.7 miliardë metër kub, sipërfaqja 60 km katror, fuqia e instaluar 350 megavat, si dhe energjia e prodhuar në vit do të ishte 1 miliardë kvh. Kosto e ndërtimin në këtë variant ishte parashikuar 600 milionë USD.

Zgjidhja e dytë parashikonte një digë shumë më të lartë, 210 metra, po në Skavicë, që e shfrytëzonte luginën e Drinit tërësisht. Vëllimi i digës do të ishte 16.5 milionë metër kub. Kjo digë krijonte një liqen me nivel normal në 485 metra mbi nivelin e detit dhe që kishte shtrirje e përmbyste deri në brendësi të territorit maqedonas. Diga ishte e parashikuar në të dy zgjidhjet të vendosej në kuotën 305 m mbi nivelin e detit në ceketinën e luginës, të krijuar nga lumi Drin i Zi (Gryka e Skavicës). Vëllimi i liqenit do të ishte 6.5 miliardë metër kub, më shumë se dyfishi i Liqenit të Fierzës. Sipërfaqja 95.5 km katror, fuqia e instaluar 350 megavat, si dhe energjia e prodhuar në vit do të ishte 1.3 miliardë kvh. Kosto e ndërtimin në këtë variant ishte parashikuar 950 milionë USD. Ky variant do të krijonte një kaskadë të në Drin me rregullim disavjeçar.

FUQIA ENERGJETIKE E DRINIT

Nga pikëpamja energjetike, lumi i Drinit nuk është thjeshtë lumi më i madh i vendit, por janë karakteristikat e tij gjeografike që e bëjnë atë edhe në aspektin hidroenergjetik një lumë "gjigant" për Shqipërinë. Në bazë të studimeve të bëra nga ekspertë të huaj dhe të vendit rezulton se koeficienti i shfrytëzimit energjetik të këtij lumi është 0.53, koeficient ky sa dyfishi i lumenjve të tjerë. Gjatësia e lumit prej 285 kilometra, por edhe pjerrtësia e rrugës që ai përshkruan duke nisur nga kuota 485 metra mbi nivelin e detit në rrjedhën e sipërme në kufirin me Maqedoninë, deri në kuotën 23 metra mbi nivelin e detit në Fushën e Nënshkodrës, e bëjnë të mundur të ketë një tregues kaq të lartë hidroenergjetik. Drini ka një pellg ujëmbledhës 11 756 kilometra katrore. Për sa u takon prurjeve, Drini e ka mesataren vjetore 352 metër kub ujë në sekondë.

Specialistët e energjetikës mendojnë se sipas këtyre të dhënave lumi Drin ka potencial të madh në rezervat hidroenergjetike, që llogariten në 6-8 miliardë kilovat/orë energji. Në një gjuhë teknike kjo do të thoshte se ky lumë zotëronte 42 për qind të rezervave të shfrytëzueshme të lumenjve te vendit.

TENDERI I DËSHTUAR DHE REAGIMET POLITIKE

Më datë 17 dhjetor 2008, pas një ftese ndërkombëtare të shpallur nga Ministria e Ekonomisë, u hap faza e parë e procedurës konkurruese, ajo e parakualifikimit të ofertuesve për Hidrocentralin e Skavicës. Në parakualifikim u u paraqitën shoqëritë: Konsorciumi Italian TGK në përbërje të të cilit janë shoqëri italiane me eksperiencë në fushën e projektimit dhe ndërtimit të veprave energjetike. Korea Electric Power Corporation, që është Korporata Energjetike e Koresë së Jugut, që siguron energji elektrike prej 120 vjetësh, zhvillon projekte energjetike në disa vende të botës. STATKRAFT, shoqëri norvegjeze e cila është një nga shoqëritë më të rëndësishme energjetike në Europë. VERBUND - shoqëri Austriake që zotëron rreth 90 hidrocentrale. KELAG GRUP është një nga konsorciumet më të mëdhenj të prodhimit të energjisë në Austri. "R.Ë.E" AG, shoqëri gjermane, e cila kontrollon rreth 2800 MË nga energjia hidrike.

Në atë kohë shoqata "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi" reagoi fuqishëm kundër tenderimit. Ajo deklaroi atëherë se pesë mijë anëtarë e saj nuk janë dakord me procedurat e ndjekura për tenderimin, si dhe denoncoi njërën nga firmat pjesëmarrëse në tender për pazare të fshehta me drejtuesit e komunave. Shqetësimin e tyre ia paraqitën edhe prefektit të asaj kohe, z. Xhafer Seiti, i cili nga ana e tij i nisi një letër Ministrit të Ekonomisë, ku i rekomandonte që në procesin e mëtejshëm të tenderimit të merreshin parasysh edhe kërkesat e shoqatës.

Më datë 5 janar 2009, komisioni i vlerësimit të ofertave duhej të shpallte fituesit për vazhdimin në fazën tjetër, por kjo nuk ndodhi kurrë. Qeveria shqiptare pranoi dështimin vetëm një vit më vonë, duke ia vendosur për këtë fajin krizës ekonomike që kishte filluar të godiste eurozonën.

Pajtim Bello, ish zëvendës ministër i Ekonomisë në qeverinë socialiste, në shkurt 2010 akuzonte qeverinë se e ka dështuar me qëllim ndërtimin e Skavicës. Ai thoshte në një intervistë për gazetën "Telegraf" se "për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës ka pasur Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 299 date 6/5/2005 dhe ky vendim u hodh poshtë nga Qeveria "Berisha", pa asnjë arsye të qenësishme. Ende nuk kane shpjeguar përse nuk vazhduan procedurat për lidhjen e kontratës koncensionare, por nëse do të ishte proceduar seriozisht ne sot do te kishim në punë një nga agregatet e Hidrocentralit të Skavicës."

Ndërsa kryeministri i asaj kohe, Sali Berisha ia vuri fajin për këtë krizës ekonomike. "Mesa duket, thotë ai gjatë një mbledhje qeverie, kriza e thellë financiare bëri që këto kompani të mos mund t'i dalin zot ambicieve dhe projekteve të tyre. Atëherë, ne jemi para dy alternativave. E para është të shkojmë sërish të tender. Por ka edhe një alternativë tjetër që, të jem i sinqertë me ju, më është dukur gjithnjë më mira, që qeveria shqiptare të marrë përsipër ndërtimin e kësaj vepre të mrekullueshme energjetike".

"Skavica është një projekt gjigant me një kosto minimale gjysmë miliardi Euro, thotë ai, dhe nuk ishte në rrezen e mundësisë sonë. Por tani është krijuar një situatë tjetër. Situata është më premtuese që qeveria të konsiderojë vetë ndërtimin e kësaj vepre gjigante. Ministria e Ekonomisë dhe Energjetikës, KESH-i dhe agjenci të tjera duhet ta shqyrtojnë me hollësi, duhet të hapë tenderin për projektin, nga studimet fillestare deri tek projekti i zbatimit, ose të përcaktojë parimet dhe ta tenderoi me çelësa në dorë", thoshte në atë kohë ai.

Emin Mysliu, një nga projektuesit dhe drejtuesit e hidrocentraleve më të mëdhenj në vend, si Fierza, Komani, Vau i Dejes, etj., e sheh më se të mundshme realizimin e këtij investimi. Por duke marrë shembull ndërtimin e HEC-eve të tjerë mbi Drin, Mysliu theksonte për gazetën "Shekulli" në atë kohë, se Skavica mund të bëhet realitet, por me kushtin që për projektin me kosto rreth 500 milionë euro të vendosin specialistët e KESH-it.

PROJEKTI I KESH, DY HIDROCENTRALE

Në vitin 2010 KESH depozitoi në Ministrinë e Energjetikës një projekt, ku theksonte se Skavica është vetëm njëri nga dy hidrocentralet e planifikuara të ndërtohen. Ky studim, që ka pasur mbështetjen e Bankës Botërore dhe asistencën teknike të kompanisë franceze Sogreah, i ka bërë një vëzhgim të hollësishëm të gjithë zonës që nis nga Skavica e deri në kufi me Maqedoninë. Ekspertë kanë përcaktuar disa pika dhe mbi to janë bërë studimet. Pikat e studimit janë grupuar në dy pjesë. Ata janë Kovashica, Dovalani, Katundi i Ri, Fushë Muhuri, dhe grupi i dytë Ura e Dodës dhe Skavica. Pasi janë marrë në konsideratë të gjithë këto pika ekspertët e kanë vlerësuar se si më të përshtatshmet janë Katundi i Ri dhe Skavica. Për digën e Skavicës janë studiuar tre lartësi të ndryshme, 340, 385 dhe 410 metra. Përllogaritjet tregojnë se më e përshtatshme dhe me më pak kosto është Skavica 385. Studimi i bërë është i gjatë e i hollësishëm, plot me të dhëna teknike. Në vija të përgjithshme ai planifikon që në Katundin e Ri, të ngrihet një digë 50 metra e lartë. Kjo digë mundëson ngritjen e një hidrocentrali me fuqi 49 megavat, gati sa dyfishi i Shkopetit. Për ndërtimin e kësaj dige ekspertët përllogarisin një kosto rreth 100 milion euro. Sigurisht kësaj shume i duhen shtuar edhe shpronësimet që në këtë rast janë shumë më pak se në variantet e mëparshme të Skavicës. Diga e Katundit të Ri përllogaritet se do të përmbytë 87 ha sipërfaqe tokësore prej të cilës 17 hektarë janë tokë arë. Ndërkohë ekspertët kanë përllogaritur që Skavica 385 si



Pamje nga Lugina e Drinit të Zi. © Foto: B.Karoshi

më e përshtatshmja mund të ketë një digë rreth 80 metra të lartë. Kjo garanton një hidrocentral me fuqi diku tek 119 megavat dhe për ndërtimin e saj kërkohet një financim prej 215 milion euro. Kjo lartësi e digës së Skavicës me rreth 30 metra më shumë nga Katundi i Ri sigurisht që shkakton përmbytje edhe më të mëdha. Sipas studimit ky variant i Skavicës përmbyt një sipërfaqe tokësore 1788 hektarë prej së cilës tokë arë janë 719 hektarë. Ky projekt redukton ndjeshëm përmbytjet. Por krahasuar me projektet ekzistuese ai redukton ndjeshëm edhe fuqinë e Skavicës, e përgjysmon atë. Po ashtu ky variant nuk bën më rregullim disavjeçar të kaskadës.

DRINI DUHET SHFRYTËZUAR, NUK DUHET PËRMBYTUR

Vesel Hoxha, anëtar i Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe një ndër bashkëpunëtorët e një firme të huaj që synonte të ndërtonte hidrocentrale mbi lumin Drin në vitet 2009-2010, mendon se "për tu ndërtuar një vepër energjetike në radhë të parë kërkohet transparencë e plotë, për të gjitha detajet e projektit, jo një punë e mbyllur në zyrat qeveritare. Pastaj, mbi këtë bazë transparence, të qartë e të kuptueshme për të gjithë, mund të jepen pozicionimet dhe mendimet konkrete, ndaj veprës në fjalë. E thënë me fjalë të tjera, duhet diskutuar e duhet pozicionuar mbi bazën e një projekti konkret, për të dhënë mendime konkrete".

"Si njohës i zonës por, pa pretenduar shumë në njohjen e saj, mendoj se mbi lumin e Drinit te Zi duhen të ndërtohen tre hidrocentrale. Hidrocentrali i parë duhet ta ketë digën aty ku janë bërë studimet, në Skavicë, ku matjet topografike flasin për një kuotë absolute rreth shifrës 305 m mbi nivelin e detit. Diga e dytë mendoj se duhet të ngrihet ose ndërtohet në vendin midis Kodrës së Bitrit (me lartësi mbi nivelin e detit 428 m) dhe Kodrës ose Majës se Thekanushit, me kuote absolute 515 m mbi nivelin e detit). Ndërsa diga e tretë mund të ndërtohet mbi Katundin e Ri, aty ku lumi Drini i Zi fillon e ngushtohet".

"Që vendi të zhvillohet, diku duhet të ndërtohet, qoftë ky ndërtim për vete, për fisin, për lagjen, për fshatin apo qytetin, për krahinën, qarkun apo për gjithë vendin. Problemi qëndron në atë që: Të ndërtohet duke u bazuar në studime shkencore, në pajtueshmëri të plotë me mjedisin dhe në marrëveshje të plotë me të zotët e shtëpisë, në rastin e veprave te natyrave të tilla, duke i bërë hesapet me hanxhinë, siç thotë populli", shkruan në një opinion të tij në gazetën "Rruga e Arbërit" në vitin 2010.

Gjithashtu, argumenteve të shtruara se me ndërtimin e hidrocentraleve zona do të kthehet jo funksionale dhe do ndërpriten rrugët e komunikimit, ai thotë se qeveria duhet të bëjë një studim të plotë urbanistik për zonën. Jemi në shekullin e 21-të dhe domosdo që, ndërtimi i tre digave do të shoqërohet me një riurbanizim të rajonit, me një infrastrukturë të re, ndoshta duke shfrytëzuar dhe tri digat e propozuara"

REAGIMET "KUNDËR"

Ali Hoxha është President Nderi i Shoqatës "Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të Pellgut të Drinit të Zi". Ai thekson tre argumentet kundër ndërtimit të Skavicës.

Së pari, thotë ai, në aspektin ekonomik, Dibra është "Myzeqeja", hambari i zonës verilindore të Shqipërisë. Ky pellg i Dibrës ka mbajtur me bukë jo vetëm gjithë Dibrën, por edhe Lumën, Mirditën e Matin, bile dhe Tiranën. Por dëmi ekonomik, për ne, qëndron në plan të dytë në krahasim me dëmin që shkaktohet në aspektin gjeopolitik dhe etnokulturor.

Në aspektin gjeopolitik Dibra e Poshtme do të shpërbëhej, sepse pjesa lindore e Dibrës do t'i bashkëngjitej pjesës tjetër që ka mbetur nën pushtimin serbosllav qysh prej vitit 1913, kurse pjesa tjetër e Dibrës, në anën perëndimore të Drinit të Zi, do të copëtohej dhe do t'u bashkëngjitej rretheve të Kukësit, të Mirditës dhe të Matit. Pra, praktikisht nuk do të ketë më Dibër

Në aspektin etnokulturor dëmi është i pallogaritshëm, sepse nga përmbytja e këtij territori, asgjësohet një qytetërim i tërë, një etni e tërë, do të zhdukej e gjithë Dibra me gjithë historinë e saj, gjithë ato gjurmë të qytetërimit të lashtë iliro-pellazge, si dhe Principata e Kastriotëve dhe terreni ku u zhvilluan 19 betejat fitimtare të Skënderbeut, kundër superfuqisë më të madhe të botës në atë kohë, nga 24 beteja gjithsej që ai bëri kundër Perandorisë Osmane. Po kështu do të zhdukeshin edhe të gjitha varret e mijëra dëshmorëve të rënë për mbrojtjen e atdheut nga pushtuesit e të gjitha kohërave, duke u përmbytur përgjithmonë nga uji i atij "deti" artificial.

Ai më tej bëhet më i ashpër, duke i quajtur "tradhtarë të kombit " të gjithë ata qeveritarë që bëjnë përpjekje për ta ndërtuar hidrocentralin e Skavicës. "Të gjitha përpjekjet dhe projektet për shitjen, përmbytjen dhe asgjësimin e Dibrës dhe të historisë së saj janë tradhti kombëtare. Kjo sepse energjia e prodhuar nga HEC-i i Skavicës është projektuar jo për nevojat kombëtare, por për eksport dhe së dyti, për faktin se aq energji që parashikohet të prodhojë HEC-i i Skavicës, Dibra i ka të gjitha resurset, që nga ujëvarat e saj mund të ndërtohen rreth 10 (dhjetë) HEC-e të vegjël, të cilët do të jepnin po aq energjia elektrike sa ç'parashikon HEC-i i Skavicës, pa u dëmtuar asnjë pëllëmbë tokë. Në këtë aspekt, tradhti kombëtare do të bënim edhe ata dibranë që do të braktisnin trojet e veta, "vetëm për një euro", pasi do të humbasin identitetin e vet."

Një shembull të ngjashëm u vjen nga matanë kufirit. "Dibranët nga ndërtimi i liqenit artificial të Dibrës dhe hidrocentralit të Spiles nuk panë asgjë të mirë për këto 40 vjet pos humbjes të rreth 5000 ha tokës më pjellore dhe që vaditej nga dy lumenj, burimi kryesor i ekzistencës të numrit më të madh të familjeve dibrane", i shkruante Argëtim Fida, në atë kohë kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe, gazetarit Abdurahim Ashiku, i cili është bërë një "zëdhënës" i përpjekjeve të kundërshtarëve të Skavicës.

Ashiku është kundër ndërtimi të çdo varianti të tij. "Si me një digë, si me tri diga, Dibra në rrënjë të saj shuhet", - thotë ai. Gjithë mendimet dhe opinionet kundër ai i ka përmbledhur në një libër publicistikë dhe vazhdimisht i kujton opinionit qëndrimin e tij kundër. "Midis 70 specialistëve të angazhuar 50 vjet më parë për studimin e kaskadës së Drinit - topologë, gjeologë, hidrologë, ing, hidroteknikë, mekanikë, elektrikë etj., nuk përmendet asnjë specialist mjedisi: agronom, zooteknik, inxhinier pyjesh, biolog, historian, arkeolog etj. Nuk merret mundimi dhe sot të pyeten askush prej tyre, a thua se jeta ekziston vetëm në saj të energjisë elektrike. Ashiku, ashtu si dhe Ali Hoxha, mbështesin mendimin se Dibra ka fuqi energjetike të fshehura, sidomos në hidrocentralet e vegjël. "Unë mendoj se në vend të Skavicës të ndërtohen një sërë hidrocentralesh të mesëm mbi degët e Drinit në Mallë, Veleshicë, Setë, Gramë, Gjalagjosht, Murrë, Okshtun... dhe qindra hidrocentrale të vegjël mbi degëzime më të vogla e

mbi kanale ujitës. Kam përmendur një studim të viteve '80-të ku vetëm nga ngritja e hidrocentraleve mbi kanalet ujitëse dhe ujësjellësin e Peshkopisë prodhimi i energjisë elektrike rritej nga 15 milionë kilovatorë në 220 milionë që, siç thuhej atëherë, "Dibra ngrohej dhe gatuante me energji elektrike".

Gazetari Ashiku ka hartuar edhe një platformë me 9 pika për t'i bërë ballë përpjekjeve për ta ndaluar ndërtimin e hidrocentralit, mes të cilave spikat krijimi i një "Fondacioni për Mbrojtjen e Dibrës", që do të marrë përsipër gjithë procesin për kundërshtimin e ndërtimit të hidrocentralit.

Murat Koltraka, një ndër aktivistët e shoqatës "Për mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi", në një sërë shkrimesh me argumentet kundër Skavicës thekson se "40 vite ndërtimi i kësaj vepre ka frenuar e mban të ndrydhura energjitë e komunitetit të 30 fshatrave të këtij rajoni, projekte për zhvillim e mirëqenie, ecjen përpara të tyre në raport me mundësitë që ata kanë. Ata nuk janë e fajtorë para askujt, pse janë banorë të këtij vendi. Sipërfaqja e tokës bujqësore në Dibër është rreth 19 000 ha, kurse toka nën kulturë është 12 500 ha. Skavica fundos 10 600 ha ose 55% të fondit të tokës në total. Ky rezervuar fundos nën ujë 8000 ha tokë nën kulturë, ose 64% të saj për tërë Dibrën. T'i heqësh Dibrës 64% të tokës nën kulturë në rajonin më pjellor që përbën bazën e ekonomisë bujqësore për të, do të thotë të zbrazësh Dibrën nga dibranët"

"Nuk është rastësi as ai vendim fatal i vitit më 1913, kur Dibra një etni, një gjak, një gjuhe, me një kulturë, me një histori të përbashkët dhe në kufijtë e vet natyror ndahet në: Dibra e Epërme që u kaloi sllavëve dhe në Dibra e Poshtme që i mbeti Shqipërisë. Nuk është normale, që pas një shekulli Dibra e Poshtme të rindahet në dysh nga veriu në jug. Një projekt i tillë prish unitetin ekonomik dhe etnokulturor të Dibrës së Poshtme duke sjellë pasoja të rënda për të. Kjo vepër shkëput komunikimin e fshatrave kodrinor e malorë në perëndim me ata që mbetën në lindje", thekson studiuesi i historisë dhe kulturës, Murat Koltraka.

Të njëjtën ide me Koltrakën ndan edhe ish deputeti i Dibrës, Idriz Xhomara. Në një shkrim të tijin në gazetën "Rruga e Arbërit" në prill 2011, ai shkruan se "Ideja e ndërtimit të këtij hidrocentrali si rregullator i gjithë kaskadës të Drinit ka fillimin që në vitin 1984. Pa vazhduar më tej gjithë zhvillimi i pellgut të Drinit është mbajtur peng i kësaj ideje. Në një zonë me tradita shumë punëtore pothuajse ka munguar ose është ndërprerë fare krijimi i pemtorëve, vreshtave, ndërtimi apo riparimi i shtëpive apo çfarëdo investim tjetër. Dhe tani pas më shumë se një çerek shekulli, kjo mund të konsiderohet pa mëdyshje si një nga efektet me negative si në aspektin ekonomik që e përmendëm më lartë si dhe në atë social duke akseleruar shumë shpërnguljen e banorëve të kësaj treve".

"Banorët e zonës së përmbytur do të marrin një shpërblim dhe sigurisht që do të zgjedhin dhe vendin ku do të vendosen. Por problemi është për ato që do të mbeten mbi kuotën e sipërfaqes të ujit, 485 m ku do të vështirësohet infrastruktura rrugore, shkollat, qendrat shëndetësore dhe mundësi të tjera që lidhen me përballimin e jetesës të cilët sipas meje do të kenë dhe detyrimin për të mbartur, transmetuar dhe zhvilluar atë traditë, kulturë dhe histori që përmendëm më lart", mbyll shkrimin e tij Xhomara.

REAGIME "PRO"

Përveç specialistëve të energjisë, zyrtarëve të KESH, firmave që duan ta ndërtojnë, edhe një pjesë e banorëve janë për ndërtimin e hidrocentralit. Por shumë prej tyre nuk janë në gjendje të argumentojnë idetë e tyre.

Agim Kasa, ish përgjegjës i statistikës në Dibër në vitet 1985-1992, në një shkrim në "Rruga e Arbërit", mars 2010, rreshton argumentet ekonomikë që bëjnë të domosdoshme ndërtimin e hidrocentralit.

"Pozicioni natyror – gryka e ngushtë ku rrjedh lumi dhe shpatullat e forta shkëmbore, e bëjnë atë një vend të përshtatshëm dhe të sigurt për ndërtimin e hidrocentralit. E jo vetëm për këtë arsye, por Skavica krijon rezerva ujore për gjithë hidrocentralet e vendosur pas saj: Fierza, Komani e Vau i Dejës duke optimizuar tërë funksionimin e kaskadës së Drinit".

Një tjetër zë, Ing. Emin Mysliu, jeta e të cilit është e lidhur ngushtë me hidrocentralet, e quan Skavicën punën e pambaruar të të gjithë linjës së shfrytëzimit të rrjedhës së lumit Drini i Zi për prodhimin e energjisë elektrike. Dhe për shkak të rëndësisë dhe kapacitetit të madh ujëmbledhës të rezervuarit, Skavica cilësohet si investim gjigant, i cili duke shtuar prodhimin e energjisë elektrike me 350 – 400 megavat, rrit jo pak por 15 % prodhimin e energjisë elektrike në vend.

Duke mbështetur këtë mendim të Mysliut, Kaca në shkrimin e tij thekson se "hidrocentrali i Skavicës është një vepër e madhe dhe se ndërtimi i veprave të mëdha kërkon edhe sakrifica të mëdha".

"Jam për ndërtimin e Skavicës, sepse mes dy alternativave zhvillimi ekonomik, me dobiprurëse për vetë ekonominë është prodhimi i energjisë elektrike se sa zhvillimi agrar i zonës orientuar nga bujqësia, blegtoria apo pemëtaria. Një histori shumëvjeçare, me gjithë format e ndryshme të pronësisë mbi tokën nuk flet tjetër veçse për zonë me zhvillim të varfër ekonomik. Baseni ujëmbledhës i Skavicës përmbyt tokën më pjellore të Dibrës, siç është Lugina e Drinit të Zi, që së bashku me Maqellarën na ka pëlqyer ta quajmë "hambari i Dibrës", por nuk ka qene krejt kështu. Skavica duhet të ndërtohet, sepse nga ndërtimi i saj sigurohen më shumë të ardhura nga prodhimi dhe shitja e energjisë, prandaj duhet menduar si të jemi zgjidhje e problemit të ndërtimit dhe jo te kthehemi në problem për ndërtimin e Skavicës", - shkruan Kaca.

"Pavarësisht argumenteve, ai bie dakord se qeveria duhet ta rishikojë politikën e kompensimeve dhe shpërnguljes së banorëve, në mënyrë që ata të mos kthehen në të braktisurit nga shoqëria apo të grabiturit nga qeveria. Skavica është ajo që duhet do t'i japë më shumë dritë Luginës së Drinit të Zi", thekson ai.

* * *

Argumentat "Pro" dhe "Kunndër" nuk mbyllen me kaq. Gjatë shkrimit të këtij raporti pyeta edhe një banorë të zonës, toka e të cilit mbytet, pavarësisht çfarë hidrocentrali do ndërtohet. "Trupi ynë nuk është një bateri celulari, dhe mes nevojës për t'u ushqyer apo nevojës për energji, kemi nevojë për tokat tona, për të prodhuar bukë për fëmijët tanë".

Ndaj deri në fillimin e punimeve duket se ka shumë punë për të bërë nga të gjithë aktorët, që nga qeveritari i parë deri te qytetari i fundit në breg të Drinit...

Rruga e Arbërit nr. 101

Ministri i Financave Shkëlqim Cani, deputet i Dibrës inspekton punimet në pusin e thellësisë në Bulqizë

Cani: Po i shikoni vetë që po i mbajmë premtimet

'Rruga e Arbërit´ ka hyrë në rrugë, por ende problemi nuk është zgjidhur

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Shkëlqim Cani, Ministri i Financave, njëherësh edhe deputet i qarkut të Dibrës vizitoi para pak ditësh Qarkun e Dibrës. Ai në fillim u ndal në Burrel, ku mori pjesë në ceremoninë e rifillimit të punës në Uzinën e Ferrokromit, më pas ndaloi në Bulqizë.

Gjatë vizitë në minierën e Bulqizës më 13 shtator për të parë investimet për hapjen e pusit të thellësisë së kësaj miniere, ministri i Financave Shkëlqim Cani, është ndjerë ngushtë para të pranishmëve që e shoqëronin në këtë vizitë, pasi pyetjes për ndërtimin e "Rrugës së Arbërit" nuk ka mundur t'i japë një përgjigje përfundimtare pozitive. Pyetjes së gazetarit për rifillimin e punimeve për ndërtimin e kësaj rruge, Cani iu përgjigj me gjuhë diplomatike kur tha se 'Rruga e Arbërit´ ka hyrë në rrugë, por ende problemi nuk është zgjidhur. Dhe përderisa problemi ende përfundimisht nuk është zgjidhur, nuk mund të themi se ky është një premtim i mbajtur nga ana jonë".

Ai kujtoi se premtimi i bërë në fushatën e zgjedhjeve të 23 qershorit për hapjen e thellësisë së minierës, ku garantohet vijimësia e punës për 800 minatorë të punësuar, si dhe ai për uljen e moshës së daljes në pension të minatorëve, tashmë ju i shihni edhe vetë që janë bërë realitet.

Po kështu gjatë kësaj vizite ministri Cani, tha se edhe një tjetër premtim ai për dhënien e përqindjes së rentës minerare për bashkinë e Bulqizës, së shpejti do të bëhet realitet. Pasi pengesë këtu ka qenë ligji i vjetër që me një dorë e jepte dhe me dorën tjetër e merrte rentën minerare. Së shpejti kjo gjë do të marrë zgjidhje, -tha Cani, ku pushteti vendor do të marrë atë që i takon nga renta minerare. Pra shikoni që kemi mbajtur premtimet e bëra në fushatë - tha ministri.

Nisur nga vizita e kryeministrit Rama në Kinë, ku mediat raportuan se janë siguruar fondet për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, dibranët pritën që ministri dhe deputet i tyre tu jepte sihariqin që endërrojnë që nga 2005-a kur dhe nisën premtimet gjatë çdo fushate zgjedhore për ndërtimin e kësaj rruge.

Bisedime me kinezët pati edhe në Tiranë para se kryeministri Rama të shkonte në Kinë. U mendua se një gjë e tillë do të përfundonte në Kinë gjatë vizitës së kryeministrit, por edhe këtë herë këto bisedime duket se nuk janë mbyllur. Dibranët e pritën me mjaft kërshëri vizitën e ministrit dhe deputetit të tyre Cani, pasi pritnin të dëgjonin nga goja e tij lajmin e mirë për sigurimin e fondeve për ndërtimin e rrugës për tu çliruar njëherë e përgjithmonë nga ankthi i gjatë i kësaj pritje që vazhdon prej të paktën 9 vitesh.

Kujtojmë me këtë rast se një ndër mijëra premtime që janë bërë nëpër të gjtha fushatat elektorale nga të majtët apo nga të djathtët, qoftë për zgjedhje vendore apo parlamentare, është rruga e Arbërit, që do të bashkonte verilindjen e Shqipërisë me kryeqytetin.



Natyrisht kjo ishte dhe mbetet joshja më e madhe me të drejtë për dibranët, pasi është i vetmi investim që do t'i bëhej kësaj zone, pasi të tjerat do të vinin me rradhë. Ishte Fatos Nano ai që së pari e premtoi atë, më pas Sali Berisha, sërish Nano dhe përsëri Berisha. "Rrugën e Arbërit e ka premtuar Fatos Nano, por ajo është projekt i joni dhe ne do ta bëjmë, -tha Berisha në zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005 dhe përsëri e premtoi atë edhe në zgjedhjet e 18 shkurtit. Por jo vetëm ai, edhe opozita e premtoi, dhe kështu ka vazhduar me radhë, por deri më tani ende asgjë. Ndaj ajo që na frikson e shton ankthin është mendimi se mos edhe tani me afrimin e zgjedhjeve vendore kemi të bëjmë me ripremtime të serisë për ndërtimin e Rrugës së Arbërit?!

Ministri i Financave Shkëlqim Cani është ndjerë ngushtë para të pranishmëve që e shoqëronin në këtë vizitë, pasi pyetjes për ndërtimin e "Rrugës së Arbërit" nuk ka mundur t'i japë një përgjigje përfundimtare pozitive. Pyetjes së gazetarit për rifillimin e punimeve për ndërtimin e kësaj rruge, Cani iu përgjigj me gjuhë diplomatike kur tha se 'Rruga e Arbërit´ ka hyrë në rrugë, por ende problemi nuk është zgjidhur. Dhe përderisa problemi ende përfundimisht nuk është zgjidhur, nuk mund të themi se ky është një premtim i mbajtur nga ana jonë".

Në këto premtime mbrapa nuk ka mbetur edhe LSI-ja, ndaj dhe pritej me mjaft shpresë dhe ende duhet të shpresojmë se qeveria aktuale Rama-Meta, do ta finalizojnë këtë projekt, për të nxjerrë Dibrën dhe dibranët nga izolimi.

Projekti për ndërtimin e Rrugës së Arbërit është lançuar si projekt me rëndësi rajonale edhe nga ministri aktual i Transporteve Haxhinasto dhe me të drejtë pasi kjo rrugë është aneks i korridorit të 8-të që lidh Shqipërinë me Maqedoninë. Ndërkohë ekspertët vlerësojnë se rruga e Arberit lidh ekonomitë e tri rajoneve me përparësi të ndryshme natyrore dhe ekonomike: rajonit bregdetar, rajonit malor që janë Bulqiza, Klosi, Dibra dhe viset e Sharrit dhe rajonit kontinental që janë Kërçova, Gostivari, Tetova dhe Shkupi.

Gjithsesi është momenti kur të gjithë bashkë, përfshirë edhe shoqërinë civile dhe Shoqata e Intelektualëve Dibranë, të punojmë pa u lodhur për sensibilizimin e ndërtimit të kësaj rruge, pasi është detyrimi ynë si bij të saj për të mos e lënë Dibrën më të izoluar e të braktisur.

Rivihet në punë uzina e ferro-kromit në Burrel

Uzina e Ferro-Kromit në Burrel vihet në pune pas 7 vitesh qëndrimi e mbyllur.

Rehabilitimi i uzinës dhe vënia në punë e furrës u bë i mundur nga investimi prej 500 mijë dollarë i kompanisë AlbChrome, pjesë e Balfin Grup.

Gjatë vizitës së tij në këtë uzinë, Ministri i Financave Shkëlqim Cani, vlerësoi investimin strategjik në këtë zonë duke theksuar rëndësinë që ka për rajonin por edhe vendin.

Nga ana e tij Administratori i uzinës njohu Ministrin me punën e bërë, por edhe me planet e kompanisë për të ardhmen.

Projekti, i cili ka nisur ne Janar 2014, në fazën e parë ka pasur si objektiv kryerjen e rimontit të Furres si dhe instalimin dhe testimin e një sërë makinerish dhe pajisjeve.

Gjatë kësaj faze AlbChrome ka investuar rreth $300,000;

Në sajë edhe të punës së përkryer të stafit të Uzinës, u bë e munduar rindezja e furrës së shkrirjes.

Projekti do të vijoj me faza të tjera investimesh, menjëherë kemi filluar me rikonstruktimin e ndërtimeve në uzinë. Në këtë mënyrë, AlbChrome përmbush edhe një detyrim tjetër koncesionar.

Pas vizitës në Uzinën e Ferro-Kromit Ministri i Financave vizitoi edhe Minierën e Bulqizës ku edhe pa nga afër punimet për hapjen e pusit të thellësisë. Ai vuri në dukje se për zonat e pasura me minerale do të përcaktohet qarte sa nga të ardhurat e rentes minerare do të përfitojnë

Me investimet e kryera nga kompania Ministri Cani vlerësoi rëndësinë impaktin pozitv hapja e vendeve të punës ka për komunitetin e kësaj.



Firmos dhe **komento peticionit** në **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

oda dibrane

Nga datat 23-26 tetor 2014 festivali do të zhvillohet në Peshkopi dhe Dibër të Madhe. Marrin pjesë grupe folklorike nga gjithë trojet shqiptare.

Oda Dibrane - festivali i këngës, valles humoristike, ritit dhe alegorisë

Festivali "Oda Dibrane" hap dyert e saj më 23-26 tetor 2014, duke shënuar njëkohësisht edhe 20 vjetorin e saj.

Këtë vit, për herë të parë festivali do zhvillohet edhe në Dibër të Madhe, duke hapur kështu një epokë të re në mënyrën e organizimit.

"Oda Dibrane" ka nisur nisur jetën e tij në vitin 1994, i konceptuar në fillim si takim i rapsodeve popullore. Në të morën pjesë kryesisht grupe dhe shoqata kulturore nga Shqipëria dhe Maqedonia si dhe artistë që bënin jetë të pavarur artistike.

"Ky aktivitet pati jehonë si ndër të parët e këtij lloji dhe u mirëprit, thotë Veli Vraniçi, drejtor i Festivalit. "Që në fillimet e këtij Festivali, kërkesat tonë si organizatorë qenë për më shumë. Por për mungesë përvoje, financimesh dhe shkallën e njohjes për jetën artistike të simotrave tona në të gjitha trevat shqiptare, qofshin këto institucione shtetërore apo shoqata, fizionimia e këtij manifestimi ishte e papërcaktuar mirë dhe bindshëm. Ne si organizatorë deshëm që ky festival të kthehej mbarëkombëtar dhe të kishte specifikën e tij të papërsëritshme që do ta dallonte nga festivalet që zhvilloheshin në Shqipëri dhe në viset e tjera.

Edhe në vitin 1995 ky festival pati pothuajse të njëjtën fizionimi, u konceptua si takim i rapsodeve popullore por duke futur në të elementë të tjerë si vallen etj.

Për herë të parë ky festival mbarëkombëtar u filmua dhe u transmetua nga Televizioni Publik Shqiptar. Kjo krijoi publicitetin e mjaftueshëm për njohjen tashmë të një aktiviteti me përmasa të gjera nga institucionet artistike të specializuara dhe qarqet artistike të interesuara për tematikën e këtij manifestimi.

Në vitin 1996 pati një viti ndërprerje, për arsye të mos financimit dhe mungesës së interesimit nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, me mendimin e një festivali që përsëritej. Në këtë vit Ministria e Kulturës inicioi një festival rapsodësh në Lezhë dhe e quajti atë kombëtar.

Festivali "Oda Dibrane" rinisi në vitin 1997, megjithë trazirat që ndodhen në Shqipëri. Organizimi i këtij Festivali u rikonceptua, duke e kthyer atë në një takim ku pasqyrohej tradita e popullit tonë në një gjini krejt të veçantë, në atë të këngës dhe valles humoristike, ritit dhe alegorisë. Dhe që nga vitit 1997 ky festival është zhvilluar pa ndërprerje duke u konsoliduar vazhdimisht dhe duke krijuar një emër të padiskutueshëm në të gjithë Shqipërinë dhe më gjerë.

Festivali mbarëkombëtar "Oda Dibrane" ka si qëllim të parë të bashkojë artistët shqiptarë pavarësisht nga kufijtë, me idenë se "Oda Dibrane" do të jetë mikpritëse e "Odës Shqiptare". Është një takim specifik, origjinal në llojin e vet jo vetëm në Shqipëri por dhe më gjerë. Është takim i këngës dhe valles popullore humoristike, ritit dhe alegorisë.

Qëllimi i tij është ri rizgjojë këto vlera të papërsëritshme të kulturës tonë, ti sjellë në kohë dhe ti bëjë të asimiliueshme për shikuesit. Në këtë festival paraqiten dhe rite të lashta si dhe vegla karakteristike muzikore. Ky festival krijon mundësinë për një rizbulim të tyre.

Tashmë, ky festival është bërë tradicional dhe, duke qenë i përvitshëm u jep mundësi grupeve dhe trevave të ndryshme të kërkojnë, zbulojnë dhe paraqesin vlerat karakteristike të tyre në këtë fushë. Specialistët më të mirë në këtë fushë e kanë quajtur këtë festival një zbulim dhe kontribut të çmuar në kulturën dhe traditën shqiptare. Ai ka krijuar emër dhe është bërë shumë i kërkuar. Kërkesat për pjesmarrje nga e gjithë Shqipëria dhe trevat ku banojnë shqiptarë janë të shumta dhe kjo krijon mundësinë e seleksionimit të vlerave që paraqiten në të.

Ky festival krijon një atmosferë të rrallë festive në qytet jo vetëm për artëdashësit e tij, por dhe për artistët pjesmarrës dhe vetë zonat nga vijnë ata. Këtë e tregojnë jo vetëm kërkesat e grupeve për pjesmarrje, por dhe kërkesat e shumë artdashësve nga Shqipëria dhe jashtë saj, për tu krijuar mundësinë e ndjekjes së tij. "Kjo na ka detyruar që veç konkurimit në sallën e Pallatit të Kulturës të planifikohen dhe shfaqje jashtë në shesh, ku numri i shikuesve është tepër i madh", thotë Veli Vraniçi.



Numri i artistëve dhe grupeve konkuruese ka ardhur duke u rritur çdo vit. Gjithashtu është rritur së tepërmi gjeografia e pjesmarrësve. Nga viti i parë ku morën pjesë pak grupe nga krahinat kufitare me Peshkopinë, sot vijnë grupe jo vetëm nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi si dhe nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, por edhe grupe folklorike nga rajoni.

Kjo veprimtari artistike me përmasa kombëtare zhvillohet në qytetin e Peshkopisë në radhë të parë për arsye simbolike. Duke qenë një qytet afër kufijve politike përfaqëson një trevë lidhëse të kulturës shpirtërore të krahinave të ndryshme, u krijon mundësinë grupeve të mbajnë gjallë këngën dhe vallen humoristike, ritin dhe alegorinë.

Në këtë kuptim përfitues janë dhe vetë qytetarët dibranë që u krijohet mundësia të shijojnë këtë pasuri të pafund të kulturës kombëtare. Përfitues janë dhe grupet dhe shoqëritë kulturore artistike të shqiptarëve matanë kufijve. Përfitim shumë i madh është dhe shkëmbimi i vlerave kulturore historike dhe krahasimi i tyre nga studiuesit dhe vetë artistët popullorë, që në një farë mënyre ritregojnë lashtësinë e popujve të tyre. Biznesmenët dibranë që përfitojnë direkt ekonomikisht nga ky festival.

Festivali "Oda Dibrane", duke patur si kriter kryesor konkurimin e grupeve me këngë e valle popullore humoristike, rite dhe alegori, si vlera më e spikatur e këtij takimi, por dhe e vetë folkut tonë, e bën këtë festival të pakonkurent e të pangjashëm me asnjë festival tjetër. "Ne mendojmë se ky festival është krejt i veçantë dhe jashtë kufijve të Shqipërisë", thotë Vraniçi.

Vit pas viti Odës Dibrane i janë shtuar risi të reja, jo vetem me konkurimin e grupeve pjesëmarrëse, por edhe me veprimtari të tjera kulturore. Janë hapur ekspozita fotografike, etnografike, etj, dhe këtë vit, për herë të parë do të hapet edhe një Panair i Librit të Autorëve Dibrane.

Gjithashtu, gjatë ditëve të odës Dibrane do të qëndrojë e hapur edhe ekspozita fotografike "20 vjet Oda Dibrane".

Këtë vit për herë të parë një natë e Odës do të mbahet në qytetin e Dibrës së Madhe, duke hapur kështu një risi të re në organizim si dhe duke premtuar se në të ardhmen festivali do të jetë më i madh dhe më cilësor.

Festivali organizohet nga Qendra Kulturo Peshkopi me mbështetjen e bashkisë Peshkopi dhe Komunës së Dibrës së Madhe. Gjithashtu, festivali ka përkrahjen e Ministrisë së Kulturës dhe Vodafone Albania, si dhe një numri biznesesh lokale e qendrore, mes të cilëve "Gjoka Konstuksion", "Perxhola shpk", hotele "Korabi" dhe "Veri" Peshkopi, Risku shpk, Botimet M&B, etj.

Korresp. "Rruga e Arbërit"



Vlerësimë për Odën Dibrane

Prof.Dr. Ramazan H. BOGDANI:

Ky festival "de fakto" i ka kaluar kufijtë dhe ka realizuar bashkimin kombëtar. Me këto veprimtari do të vëmë gjurmë të forta për identitetin e kulturës kombëtare. Më e rëndësishmja është prurja kulturore nga e gjithë Shqipëria.

IBRAHIM ROÇI, KAVAJË:

Ndjej kënaqesi që ka emrin "Odë" se është odë e nëntë maleve. Oda ka edhe këngën, edhe vallen, edhe alegorinë. Mesa duket "Oda Dibrane" është shtysa e veprimtarive të tjera në rrethe.

Prof. AFËRDITA ONUZI:

Një falenderim për organizatorët, pasi janë këta njerëz që ne jemi mbledhur e diskutojme, se duam ta bëjmë sa më mirë "Odën". Kam ndjekur 7 edicione dhe çdo vit bëhet më mirë se herët e tjera. Jam e kenaqur me veshjet popullore që kanë dalë në skenë.

MELEQ KAPLLANI, KANINË, VLORË.

"Oda Dibrane" është bërë i njohur si aktivitet. Për ne është nder që arritëm të marrim pjesë.

Bali Sahiti, GJILAN, KOSOVË:

Nga përvoja dhe rezultati i punës së palodhur të organizatorëve të Odës Dibrane" ne fituam përvojë për organizimin e Festivalit të Gjilanit.

ZIJA ALIU, VITI, KOSOVË

Lëvizjet e para për bashkim kombëtar i kemi parë tek "Oda Dibrane". Pasuria shpirtërore është më e madhe se pasuria ekonomike.

Shaban Shabani, GJILAN, KOSOVË

Kemi ndjenja të veçanta për "Odën Dibrane". Ky Festival është një derë e hapur për të gjithë shqiptarët. Është një ruajtje e traditës dhe një rizgjim.

Shefqet Doda, Mat:

Nga pikpamja e organizimit Festivali "Oda Dibrane" është në nivelin e një Festivali Kombëtar.

Shkollave të reja të Bllacës e Tërnovës iu shtuan edhe ato të Gjurasit dhe Topojanit në Komunën Shupenzë. Shkollat e reja u pajisën me mjetet e nevojëshme mësimore për zhvillimin normal të mësimit.

Rihapet shkolla e mesme profesionale në degën gjeologji-miniera

Nga **HYSEN LIKDISHA**



Viti i ri akademik shkollor 2014-2015, ka sjellë në Bulqizë edhe rihapjen e shkollës së mesme profesionale në degën e gjeologji-minierave. Shkolla ka funksionuar edhe para viteve '90-të, ku kanë dalë qindra teknikë specialistë, aq të kërkuar në Minierën e Bulqizës, më e madhja në vendin tonë.

Rihapja pas më shumë se dy dekadave e shkollës së mesme profesionale në degën gjeologji-miniera, ka krijuar një mbwshtetje më të mirë, jo vetëm për nxënësit që mbarojnë arsimin e detyruar 9-vjeçar në qytetin e Bulqizës, të cilët me mbarimin e kësaj shkolle, por edhe për ata të të gjithë rrethit, të cilët me mbarimin e kësaj shkolle e kanë të siguruar punësimin në minierë.

Për të bërë me dije të interesuarit, shkolla funksionon në godinën e Gjimnazit të Bulqizës i saporikonstruktuar, me ambiente e hapwsira tejet funksionale e bashkwkohore.

Shkolla është rihapur nën kujdesin e Ministrisë së Mirqenies, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me bashkinë Bulqizë, kompaninë Alb Crom dhe drejtorinë e Gjimnazit. Në këtë shkollë do japin mësim inxhinierë specialistë nga më të mirët e kompanisë AlbCrome që punojnë në minierën e Bulqizës, si dhe mësues të gjimnazit në shkencat natyrore.

Më 16 shtator e inspektuan shkollën drejtori i burimeve njerëzore pranë kompanisë Alb Crome, Emin Shini, Piro Jani, drejtor i Formimit Profesional për Verilindjen në Ministrinë e Mirëqenies, Rinisë e Sporteve, të shoqëruar nga kryebashkiaku i Bulqizës, Myfit Duriçi, si dhe drejtoresha e gjimnazit dhe njëherësh e shkollës së mesme profesionale të sapohapur, Floranda Gurra.

Drejtori i burimeve njerëzore të kompanisë AlbCrome, Emin Shini, bëri prezente për nxënësit e kësaj shkolle modelin e kontratës që garanton punësimin e tyre pas mbarimit të kësaj shkolle, si dhe shprehu gatishmërinë e kompanisë për të investuar për sigurimin e bazës materiale në funksion të realizimit të praktikave mësimore. Në këtë linjë edhe kryebashkiaku Myfit Duriçi garantoi se bashkia do të tregojë kujdes maksimal në plotësimin e kushteve infrastrukturore për një mësimdhënie e mësimnxënie të standardeve të duhura bashkëkohore.

"Sot është një ditë shumë e gëzuar për ne që me shumë vështirësi ku u desh një bashkëpunim i gjithë faktorëve që bënë të mundur hapjen e vitit të parë të shollës teknike të minierave. Këtu eksperienca ka funksionuar, me këtë rast dua të përshëndes edhe nxënësit e regjistruar ku për mendimin tim ata kanë bërë investimin e duhur për veten e tyre duke u regjistruar në këtë shkollë", tha në fjalën e tij përshëndetëse drejtori i formimit profesional për verilindjen në Ministrinë e Mirëqenies, Piro Jani.

Ndërkohë, 33 nxënësit e regjistruar mes emocionesh u shprehën se ndjehen mjaft të gëzuar që u jepet rasti për të vijuar mësimin në këtë shkollë, pasi me mbarimin e saj kanë mundësi të nisin një punë të sigurtë në minierë, si dhe mund të ndjekin shkollën e lartë në degën e gjeologji-minierave. Ndërkohë edhe pse kuadri mësimdhënës është plotësuar, mbetet problem ardhja e plan-programeve mësimore, ku sipas inxhinierit Nexhmedin Marku, mësohet se praktikat profesionale do zënë rreth 60 për qind të programit mësimor.

Bulqizë, mbyllen dy shkolla 9-vjeçare

Fëmijët e dy fshatrave Çerenec dhe Viçisht në komunën e Gjoricës të rrethit Bulqizë, ende nuk kanë patur fatin e bashkmoshatarëve të tyre për të vijuar mësimin në shkollë. Shkak për mosnisjen e mësimit është bërë mbyllja e dy shkollave 9-vjeçare përkatësisht në fshatrat Çerenec dhe Viçisht.

Mësohet se sipas urdhërit të Zyrës Arsimore Bulqizë, fëmijët e këtyre fshatrave duhet të vijojnë mësimin në shkollën 9-vjeçare të fshatit Gjoricë, qendër e kësaj komune. Por banorët e këtyre fshatrave kanë kërkuar që fëmijët e tyre të vijojnë mësimin në shkollën 9-vjecare të komunës Shupenzë me pretendimin se e kanë më afër për rreth 2 kilometra.

Veç kësaj një tjetër pretendim i prindërve është edhe fakti se Zyra Arsimore nuk merr përsipër transportin e këtyre nxënësve. Kështu në të tilla kushte kur nxënësve u takon që të udhëtojnë deri në rreth 2 orë në këmbë, u duhet që të sigurojnë vetë transportin me furgon, gjë që e kanë më të lehtë për të shkuar në Shupenzë pasi e kanë edhe më afër.

Ndërkohë banorët dhe nxënësit vetë shprehen se në shkollën 9-vjeçare të Shupenzës kanë kushte më të mira si dhe mësimdhënie nga një trupë mësimore më e kualifikuar.

Prej 1 jave 35 nxënës të këtyre dy fshatrave vijojnë të mbeten jashtë dyrve të shkollës së Shupenzës në oborrin e saj, pasi nuk lejohen të vijojnë mësimin nga ana e drejtorit të kësaj shkolle, Arian Kaja.

Sipas drejtorit mësohet se për lëvizjen e nxënësve nga njëra shkollë në një tjetër ka disa rregulla strikte, ku gjithsesi për një gjë të tillë duhet miratimi i zyrës arsimore. Ndërkohë ai shprehet se është i gatshëm dhe i ka të gjitha mundësitë për akomodimin e këtyre nxënësve në shkollën e drejtuar prej tij.

H.L

Fillim i mbarë

Nga Zabit LLESHI
Mehdi DEMA



Analizat e punës mësimore-edukative, në drejtoritë e shkollave dhe në shkallë rrethi, Zyra Arsimore e rrethit Bulqizë, i përfundoi brenda muajit korrik, duke përcaktuar detyra e objektiva të reja, për vitin shkollor 2014-2015. Organizimi i mirë i punës dhe ndjekja me përkushtim e detyrave, si nga stafi i zyrës arsimore ashtu edhe nga mësuesit e shkollave, mbylli me sukses fushatën për përgatitjen e shkollave për mësim. U kryen shumë punë: U lyen shkollat e klasat, u ngritën apo rifreskuan ambiente e terrene sportive, u sistemuan bazat materiale dhe orenditë shkollore, etj. Bashkëpunimi i drejtorive të shkollave me këshillat e komunave Shupenzë, Gjoricë, Zerqan dhe Bashkinë Bulqizë, i dha frytet e veta.

Shkollave të reja të Bllacës e Tërnovës iu shtuan edhe ato të Gjurasit dhe Topojanit në Komunën Shupenzë. Shkollat e reja u paisën me mjetet e nevojëshme mësimore për zhvillimin normal të mësimit. Vështirësitë e terenit të vështirë malor, për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare në Gjuras, u përballuan nën kujdesin e pa kursyer të deputetit Përparim Spahiu. Në gëzimin e nxënësve dhe banorëve të fshatit, për inagurimin e kësaj shkolle, mori pjesë edhe zv. Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Znj. Nora Malaj .

Shkolla e Homeshit dhe ajo e Trebishtit, në muajin maj, festuan rrespektivisht 120 dhe 100 vjetorin e çeljes së tyre. Në këtë kuadër, drejtoritë e shkollave dhe mësuasit, i pritën festat me veprimtari të shumta shkencore, kulturore, artistike e sportive, në miedise mbresëlënëse dhe shpresëdhënëse. Kësisoj, fillimi i vitit të ri shkollor, i gjeti këto shkolla më të kompletuara se çdo herë. Kontributi nga komunitetet qe i ko nsiderueshem.

Më 15 shtator, në Bulqizë filluan mësimet edhe 32 nxënës në shkollën profesionale të minierave. Rihapja e kësaj shkolle qe e mirëpritur nga banorët e kësaj zone, të cilët prej dekadash e kanë të lidhur jetën e tyre me minierën e kromit. Shumë djem dhe vajza të Bulqizës, dhe jo vetëm, mbaruan shkollat e larta dhe u dipllomuan si inxhinierë (Gjeologjie, çpimi,pasurimi, etj.) duke mbajtur mbi shpatulla peshën e prodhimit të kromit dhe perspektivën e minierës.Vitet ikin dhe koha bën të vetën. Gjenerata e viteve të para të shkollës po i afrohet pensionit. Një brez minatorësh, zjarmtarësh, inxhinierësh, bashkë me shumë punëtorë të kualifikuar, do të lënë punën. Ky boshllëk duhet të rimbushet. Përvoja e grumbulluar nuk duhet humbur. E kush më mirë se inxhinierët dhe punonjësit e kualifikuar si: Jorgo Kola, Hamza Gura, Zija Ndrukaj, Sefedin Shabani, Fadil Cani, Nezir Lica, Sulejman Alia, Medat Zogu, Bukurosh Koçi, Selim Daci, etj. mund të kontribuojnë me përvojën e tyre?

Me optimizmin që e karakterizon drejtoreshën e Zyrës Arsimore Bulqizë, Znj. Bedrie Manjani, na thot se do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e të gjitha problemeve që do t'i dalin Shkollës Profesionale të Minierave dhe stafit të saj, për realizimin me sukses të programeve dhe objektivave.

Në rrethin e Bulqizës filluan mësimet 6 shkolla të mesme me 1118 nxënës, 20 shkolla 9-vjeçare e 38 shkolla fillore me 6926, 20 kopështe me 800 fëmijë. Në terrenin e hapur dhe të vështirë të këtij rrethi; që nga Martaneshi, Okshtuni, Trebishti, Topojani e Gjurasi, do të japin kontributin e tyre modest, 472 mësues.

Në ditët e para të hapjes të shkollës u shpërnda dora e fundit e librit shkollor për të gjitha ciklet. Paranjoftimi për vendet e shitjes së librave krijoi lehtësi në shpërndarje duke eleminuar ndonjë vonesë që u konstatua, për ndonjë shkollë të largët, në vitin paraardhës.

Mirë punuan për shpëndarjen e librit shkollor drejtoritë e shkollave si: "Xhevdet Doda"e " Shefqet Tançi" në qytetin e Bulqizës, Shupenzë, Ostren i Math, Valikardhë, etj., përkatësisht, me drejtorë: Lindita Kaja, Irena Biba, Arjan Kaja, Bardhosh Koçi, Rami Lami.

Hartimi i planeve mësimore në përshtatje të plotë me programet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, është ndjekur me përparësi nga zyra arsimore e rrethit. Kujdes po bëhet për efikasitetin e punës në departamente, sipas lëndëve të ndryshme, për përhapjen e përvojës së përparuar, si brenda dhe jashtë këtyre departamenteve. Edukimi fiziko-sportiv në shkollë, këtë vit do të zbatohet simbas një programi të ri, pasqyruar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, në " Platformën e edukimit fiziko-sportiv në sistemin arsimor parauniversitar".Kjo platformë synon përgatitjen fizike, argëtimin e nxënësve, mbrojtjen dhe riaftësimin e shëndetit, rritjen e rrezultateve sportive, dashurinë për shokun e kundërshtarin, rritjen e ndjenjës së humanizmit e të kolektivitetit, etj.

Realizimi i këtyre objektivave, si pjesë e reformës arsimore, kërkon mendim, energji, gjithpërfshirje të mësuesve të edukimit fizik, të dashamirësve të sportit, të sportistëve të vjetër e të rinjë, që me kënaqësi, konstatojmë se nuk mungojnë në këtë zone; si në qytet edhe në fshat. Përmendim këtu vajzat skiatore të Klenjës dhe mësuesin e apasionuar Fadil Alia, djemtë e Shupenzës, kampion të rrethit në futboll e voleiboll, me mësues Gëzim Mata, Shega Alliu e Maliq Dumani, shkollat Zogje e Zerqan, për lojërat popullore, me mësues Shukri Xheleka e Mehdi Ceka, shkolla Gjoricë, voleiboll-vajza, me mësues Fadil Cami e Fehmi Lika, shkollat e qytetit Bulqizë e Fushë-Bulqizë, për ngjitjet malore, me mësues Jashar Shehu e Ilir Disha, shkollat Tuçep e Ostren, për mundje të lirë, shembulli i mësuesit të Gjoricës, Aleksandër Dumani, për organizimin e mjaft ndeshjeve sportive me nxënësit dhe të rinjtë e Shupenzës, Gjoricës, Viçishtit, Homeshit, etj.

Për realizimin e këtyre objektivave, është me shumë vlera bashkërendimi i veprimtarive me simpatizantët e sporteve dhe ndihma e bisnesmenëve, siç qe rasti për organizimin e përvjetorit të shkollës së Homeshit, ku nuk mungoi ndihma e pakursyer e zotërinjve Luan Manjani, Luan Turja, Baftjar Rusi, Genc Turja e Hajri Cami. Një shembull për t'u përgëzuar, përgjithësuar e ndjekur.

Të gëzon fakti se stafi i Drejtorisë së Zyrës Arsimore Bulqizë, është i ri në moshë e në mendime, të papërtuar, të përgjegjshëm e të vendosur për realizimin e detyrave në kuadrin e reformave arsimore e sportive.

Fillimi është i mbarë. Urojmë suksese !

reportazh



Grama nuk është vetëm një kullotë për bagëtitë, por është një oaz ku njerëzit kurohen dhe shpirti çlirohet...

Në Gramë mes bukurive të natyrës

Nga **NAMIK LAÇI**

Mendimi për udhëtim në vendlindje erdhi spontanisht pas një bisede me dy moshatarë, duke folur për fshatin, për njerëzit që nuk jetonin, për të moshuarit, për brezin tonë dhe për të rinjtë në fshatin Brest i Poshtëm.

Biseda u përqendrua më tepër tek "filozofet" e këtij fshati, për natyrën e tyre e për veset. Njëri nga ne tha me qesëndi se ajo fabrikë është mbyllur dhe si vështirë të hapet më.

Në Brest ka intelektualë me shkollë të lartë: doktorë, profesorë, gjeneralë, por "filozofë" të muhabetit dhe odave dibrane nuk ka më. Në këto e sipër biseda kalohej te natyra dhe puna që është bërë në dekada në bujqësi e blegtori në këtë fshat. "Blegtorinë, - thotë Liman Laçi, pasionant në këtë fushë, e ka mbajtur Grama gjithmonë.

"Grama është për 4 muaj, por tetë muajt e tjerë nuk i mban kjo fusha e Kastriotit", - ia ktheva unë.

"Në Gramë deleve e lopëve ju bëhet "motor" i ri, - ndërhyn me shaka Rushit Laçi.

"Bagetia , - thotë Përparim Laçi... , me profesion veteriner, në Gramë rigjenerohet ,rigjenerohet edhe njeriu ,ndryshon pamjen dhe gjithçka në organizëm".

***

Të katërt së bashku vendosëm të vizitonim Bjeshkën e Gramës. Rruga e shtruar me asfalt nuk na dha mundësi të shikonim as Kodrën e Gështenjës, Celiasin e Kastriotëve e as "Gurin e Nuses" me legjendën e saj të famshme. Tek Lapidari i Sllovës lamë asfaltin dhe u futëm në një rrugë të fshatit Sllovë që vetëm rrugë nuk mund të quhej. Rrugë pa rrugë u futëm në pyllin e livadhit të gjatë një natyrë e bukur, ku mund të merrje frymë thellë...

Në mes të rrugës filluan të bëheshim "pishman", pasi ajo nuk dallohej nëse ishte "rrugë dhish" apo "rrugë makinash", për vizitorët që duan të shkojnë në bjeshkë.

Ata që ishin me mua më thonin që është rrugë që e kishte hap ushtria. Me shpirt e me dhëmbë u ngjitëm te Varri i Sejmenit. Arritëm në bjeshkë dhe u qetësuam pak, pasi deri atëherë asnjëri nga ne nuk fliste, ndoshta nga lodhja e rrugës së mundimshme.

Në mbrëmje arritëm tek Stanet e Çidhnakëve. Pas një nate të qetë, në mëngjes u ngjitëm në bjeshkë te liqeni, që ishte me të vërtetë një bukuri e rrallë. Bjeshkë e bollshme, sa të zë syri një natyrë të gjelbërt, me ujë të bollshëm e të ftohtë me të rënë ballit .Në çdo 100 m kishte një burim uji. Edhe atje poshtë Gurit të Kuq ka një burim, - thotë Limani.

"Atje do të shkojmë", - i them unë dhe rrugës na zunë sytë ujë që vlonte e nxirrte shkumë, thua si të ishte përzier me sapun.

Natyra ishte krijuar në atë mënyrë që uji bënte një zhurmë melodioze në çdo dy minuta, si një simfoni që përsëritej e përsëritej pa mbarim. Uji që vinte nga poshtë i ngrinte gurët sa një filxhan kafe rreth 5 cm.

Lamë ujin që vlonte dhe ngjitemi lart. Dy ishin kuriozitetet e mia, ujin te Guri i Kuq dhe Brezin e Butë, që ngjante nga lart me një tarracë. Ngjitemi lart për në majë ose në Qafë të Gurit të Kuq dhe afro 50 m pa u ngjitur atje, vëmë re një krua në formën e një lugu, që buronte në shpat të Bjeshkës së Dede (Skepit). Aty shuajmë etjen dhe në Qafe të Gurit të Kuq kthehemi dhe shikojmë



nga perëndimi edhe malet e Runjës e të Lurës, të cilat dukeshin si fusha e jo si male, aq sa harroje se ndodheshe në malin e lartë të Korabit. Në të katër anët shikoje Bjeshkën e Gramës të ndarë dhe me pronarët që shfrytëzonin çdo detaj të natyrës mahnitëse. Pas Gurit të Kuq, Bjeshka e Abazallarëve dhe përballë Bjeshka e Shehelerëve të Vleshës. Përballë nesh Bjeshkët e Çidhnës, një perlë e vërtetë e natyrës.

Bashkë me të, aq sa mund të shikonte syri, ishin Bjeshka e Elez Isufit, e Spate dhe Skepe (Dede), e Blliçes, Bjeshka e Kaloshëve (e Zonjave) deri në Lake të Korabit, që ndan kufirin e Maqedonisë me atë të Shqipërisë. Në Lake vumë re edhe të famshmen Grykë e Radikës. Këtu kurioziteti ishte i madh, pasi veç ngjarjes historike të kësaj gryke, ishte edhe fakti i zhurmës së madhe të ujit të kësaj treve.

Limani më tregoi Bjeshkën e Shterpave, një arkitekturë mahnitëse e mëmës natyrë.

- Kjo është Bjeshka e Shterpave, deleve që kulloten këtu u filtrohet gjaku nga burimi me ujë dhe u ripërtërihet komplet organizmi, - thotë Limani.

Biem poshtë nga Bjeshka e Zonjave, në të cilën pashallarët turq e kishin përzgjedhur për të bërë pushimet me zonjat e tyre. Në qafë të Bjeshkës së Zonjave ishte Gjibra e Zonjave, një vend vërtetë për ta eksploruar. Përballë nesh, në veri të Gjibrave gjendeshin Shllinashit, ku kalonin ata që ëndërronin për një jetë më të mirë në kohën e diktaturës. Tani ajo shërbente si vend për gjuetinë e dhive të egra. Përballë, në majë të Bjeshkës së Vrajnit, ndodhej Kësula e Priftit.

Ramë nga Qafa e Bjeshkës së Zonjave në Gjibrat e Epërme dhe në ato të Poshtme dhe poshtë Shllinasve dy shkëmbinjtë në formën e tiganëve, që natyra u kishte dhënë formën e tiganëve. Te liqeni i Grames pamë që diga poshtë ishte amortizuar dhe rridhte në disa vende, problem që duhet parë, pasi ishte rrezik për zonat poshtë.

Ky udhëtim në Grame ishte i paharrueshëm, me pamje mahnitëse, ku syri mund të shikonte një arkitekturë perfekte të bërë nga natyra dhe e paprekur nga dora e njeriut. Aty njeriu gjen qetësi shpirtërore dhe shërim për mushkëritë tona.

...është koha për t'u pajtuar...
KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com
vetëm 600 lekë në vit



Foto: © Gazmend Kërkuti

Jeta baritore dhe disa elementë të saj

Nga **MEVLUD BUCI**

Në tërësinë e kulturës blegtorale të malësisë tonë, të Katër Grykëve e mbarë Dibrës edhe në specifikat lokale, një vend të rëndësishëm zë edhe kultura e punës së bariut. Sidomos dukuri me vlerë të kësaj tradite paraqesin jeta baritore dhe disa elementë të jetës e teknologjisë së saj. Objektet e kulturës materiale të prodhuara dhe të përdorura nga barinjtë në trevat e rrethit tonë kanë vlerën e një dokumenti historik origjinal. Ato heshtazi por me siguri të plotë, flasin për veçoritë e jetës baritore, për botëkuptimin e psikologjisë, për shije estetike dhe ndjenjat, për pasurinë e motiveve të larmishme të jetës së bariut, shpirtin e tij krijues, atdhetarizmin e flaktë ndaj tokës së bjeshkëve, mençurinë dhe tërë botën e vyer prej njeriu të lidhur pas jetës e tufës, pas stanit dhe objekteve të cilat shprehin forcën e pa shtershme krijuese të tij. Gjurmët e punëve, kushtet e ruajtjes dhe të mbrojtjes në kohra, vendosmërinë për të përballuar vështirësitë, dashurinë dhe përkushtimin për blegtorinë, punët, punimet e mjeshtërinë e blegtorit, gjuha e thjeshtë, e bukur lidhur me tufën, enët, stanin e jetën baritore pranë vathës e tufave në kullotë. Duke vëzhguar rreth jetës baritore në trevën e Katër Grykëve si dhe në ato të Lurës, Kalasë së Dodës, Muhurrit, Çidhnës del se objektet materiale të gdhendura prej druri siç ishin kupa, kërraba, furka, boshtinj ibënin barinjtë, mjeshtër të tjerë pranë stanit a mrizeve të tufave, punonin lugë, enë uji dhe buti në forma nga më të ndryshme, të tjerë më të pasionuar prodhonin djepa, magje, arka nusesh etj. Në trevën e Kacnisë duke vështruar rreth jetës baritore ndesh në faktin se ajo ishte e lidhur ngushtë me pyje, me stanin, me objektet e larmishme të drurit. Në format nga më të ndryshmet janë kupat e përdorura nga barinjtë, shtrungat për mjeljen e tufës, kokat e kërrabave të barinjëve. Ndër objektet e përdorimit të përditshëm të bien në sy furkat e punuara me shumë hijeshi nga barinjtë. Këto tërheqin vëmëndjen jo vetëm me format e tyre mjaft të larmishme, por edhe me motivet e përdorura për zbukurim si trekëndësh të mbushur me vija, rrathë bashkëqendrorë, rozeta, motiv i diellit etj. Të pasura në lloje e zbukurime janë enët e ujit e të bulmetit. Midis kësaj pasurie të vyer nga kultura materiale popullore e malësorëve tanë në fushën e jetës baritore zënë vend të rëndësishëm edhe të bien në sy për format harmonike enët e Kacniasve. Në punimet e tyre të thjeshta derdhet vërtet talenti, pasqyrohet jeta e stanit ku në kompleks jepen punime që shërbejnë për mbajtjen e bulmetit, enë ku pasqyrohet mjeshtri e punimit e trashëguar ndër breza deri në ditët tona. Ndër elementët më me interes që karakterizojnë jetën baritore janë burimet e këngëve, veshje e barinjëve, format e llojet e enëve të ujit e të bulmetit, natyra dhe mjediset e stanit, mjeshtria e punimit të objekteve që inevojiteshin të cilat përbëjnë një spektakël të vërtetë nga ku gjejmë këndvështrimi për të njohur jetën baritore. Vetë tereni malor e i pyllëzuar e trevës sonë, natyra e bjeshkës dhe e pllajave, mrizet e ftohta pranë burimeve zgjidheshin nga barinjtë, lugjet në të cilat u hidhej kripa tufave, rregullsia e mjediseve të vathëve apo zgjedhja e vendit ku vendosej stani janë një dëshmi e qartë, të cilat na njohin më së miri me shijen e hollë estetike të malësorëve tanë, me larminë e pasur e të vyer të jetës baritore. Duke qëmtuar(dmth, gërmuar, shkëputur) nga natyra e kësaj jete gjejmë element të së bukurës dhe të së madhërishmes, njohën sensin poetik baritor, ku nëpërmjet onanimisë në melodinë e hershme të fyellit derdheshin fjalët ku shprehej e bukura, ndjenja e lirisë, ndershmëria, dashuria e malli i tokës, dashuria për qingjat, barin e njomë, lulet shumë ngjyrëshe të kurorës, fyellin me të cilin bariu iflet bareshës që vjen nga maja e malit:

"A xhexhesh a nuk xhexhesh?
Mos je shurdhë si s'përxhexhesh.
A çuet a je n"xhumë,
Çohu e mblith tanë katunë,
Se dash kaleshin na e kanë pre.
Qenavrapin na e kanë vra;
Njersa misht e dashit t'hanë,
të tanë hajdutët këtu janë. . . "

Në vetë retorikën dhe anoniminë e motivit kushtrues të kësaj kënge derdhet shpirti vigjilent ibariut, malli për bjeshkët dhe tufën, zbulohet qartë e bukura dhe e madhërishmja, elementë të cilët izbulojnë si natyrën e jetës së brendëshme baritore dhe në tërë dukuritë e kulturës shpirtërore e materiale të kësaj jete. Motivet lirike, epike si dhe mjeshtria e elegjisë krijuar nga malsorët tanë e kanë burimin nga vetë jeta baritore. Nga këto elegji ku plot prej tyre që shquhen si për mbrujtje me filozofinë popullore, thellësinë e mendimit për satirë e alegori. Këto janë shprehje e vërtetë e atij shpirti të madh krijues që ka karakterizuar si mbarë popullin, ashtu edhe malsorët e trevës tonë, vajtimoret poetesha, të cilat duke pasur si bosht të vargjeve "dashin" kanë shpreh me tërë urrejtjen natyrën e sistemit feudal në të kaluarën e errët. Elegjia me motive nga jeta baritore buron si vetë rrëkeja e malit me hovin e saj të rrëmbyeshëm, na jep qartë elementët e tragjikes e të kronikës:

"Dash more dash,
brinjat nji pash,
krajet për pashallarë,
shpatllat për agallarë,
mishin për bajraktarë,
langun për katunarë,
kocijtë për zagarë…. "

Jeta baritore, këngët, motivet, shprehjet, emërtimet gjuhësore (toponimet), punët e stanit, përçojnë mjaft interes studimor. Sigurisht që mbetet për tu thelluar, vëzhguar, krahasimi e pasqyrimi ityre. Më parë nga të gjitha studiuesi duhet të nxjerrë, kur dhe pse ka dalë kjo këngë, cilat janë arsyet që kanë nxjerrë atë? Cila është shtrirja e tyre në krahina të ndryshme?Kështu mund të arrihet në konkluzione më të vyera për njohjen e historisë së popullit tonë. Këngët si një ndër elementët e kulturës shpirtërore dhe artistike të jetës baritore kanë dalë në ato rrethana, kur vihej në provë gatishmëria e atdhetarizmi, kur rëndonte mbi supe pasha e rregjimit të egër feudal. Shtrirja e tyre në trevat malore të Dibrës dëshmon qartë për jetën e pasur, por edhe të vështirë të barinjëve . Këto këngë që ipërkasin shekullit të kaluar na njohin me dramacitetin e kësaj jete në stane pranë tufave, në unitetin e veprimit e lidhjen midis njerëzve të thjeshtë të bjeshkëve tona, janë tabllo e vërtetë e kujdesit për të mbrojtur tufat nga grabitja prej hajdutëve etj. Nga fundi i shekullit XIX tregonte 107 vjeçari Asllan Daçi, icili 76 vjet ka punuar bari, në majën e Shullanit të Poshtëm të Murrës përballë malit të Çetës në vjeshtë ishin 13 barinj me tufat e dhenve. Ata u rrethuan nga hajdutët, të cilët u rrezikuan për t'u marrë bagëtitë. Njëri prej barinjëve i binte mjaft mirë kavallit.

-Po bjeri njëherë, itha njëri nga hajdutët.

-Ti presim gishtin e vogël, atëherë të fillojë t'i bjerë sërish, tha hajduti tjetër, sepse kështu nuk mund të bëj ndonjë lajm . Bariut nga fisi Miha ia prenë gishtin e vogël dhe megjithatë ai e mori me saktësi e mjeshtëri melodinë. Në katundin e vjetër (sot lagje e Qafëmurrës), Murrë, një vajzë e re sapo dëgjoi melodinë jep kushtrimin dhe menjëherë fshatarët i shpëtojnë tufat dhe barinjtë. Kjo lloj marrëveshje e lajmërim kuptohet që pasqyron më së miri unitetin e malsorëve, gatishmërinë në ndihmë të tjeri tjetrit, pasqyron qartë elementin më kryesor të jetës baritore ku duket zëri i kushtrimit në mbrojtje të tufave. Ashtu sikurse kultura shpirtërore e artistike edhe kultura materiale janë pasuri të vyera të cilat na dëshmojnë se gjithmonë në qendër të vëmëndjes së tij bariu dibranë ka patur kujdesin për tufën. Ai ka bërë shumë përpjekje dhe ka derdhur shumë djersë e mund pa kursim për të sistemuar kullotjen, bjeshkën, livadhin e zabelin, si një ndër bazat kryesore për të garantuar jetesën e familjes nëpërmjet mirëmbajtjes së tufave. Ndër ato element kryesor të jetës baritore është edhe veshja e bariut gjë e cila tregon më së miri për kulturën e pasur material, për traditën e mrekullueshme, e cila u pasua ndër breza. Duke vjelë mendimet e barinjëve në Qafëmurrë mësojmë se dollama që vishte bariu gjatë kullotjes së tufës peshonte mesatarisht 20 kilogram. Kjo kishte mangë me kollçak nën të dy brylat deri tek llërat. I viheshin 3-4 pash gajtan në sejcilën anë, dy xhepa në krahorë dhe dy të tjerë në anë tek mesi. Gjatësia e dollamës ishte 20 centimetra poshtë lakut të gjurit. Dollamën e ka patur Llan Biba, i cili jetoi në fundin e shekullit të kaluar (XIX). Ajo peshonte mbi 25 kilogram dhe kishte në sejcilën anë të saj dy gajtana e nga 12 palë mëngë me gjërësi 25-30 cm. Ndër llojet e veshjeve të barinjëve ishte edhe mangorja e cila vishej përmbi xhamadan. Ajo kishte mangë të gjata dhe vinte nga gjatësia deri në ije, dy kollçakët që viheshin poshtë brylave, gajtanat që rrethonin pjesën e përparme dhe fundin si dhe atë rreth fytit e qerpjen sipas prerjes. Për të bërë një mangore duheshin deri në 4-5 kiogram lesh, dy fije gajtan për sejcilën nga të katër qepjet, në fund mangorja rrethohej nga brezi, sipër saj veshej kajukja. Mozaiku i vërtetë i elementeve të jetës baritore duket në mjaft element si tek mënyra e gdhendjes, qëndisjet e kupave apo mënyra e punimit të bulmetit e përdorimi i enëve të stanit. Shkopinjtë që i bënin prej thane, dëllinje, palme, famleti etj, të cilët ishin të fortë por edhe ktheheshin më mirë në forma të ndryshme. Vetëm nga druri i frashërit nuk bënin shkopinj tregon bariu Ram Daçi, sepse nga që ky ishte shumë idendur, ekzistonte gojëdhëna se po t'u biesh tufave me shkop frashëri ato t'i ha ujku. Thuhej, tregon bariu, se kur ujku ishte gojëmbyllur po qe se do t'i fërkonte gojën frashëri do t'i çilej menjëherë dhe kështu do të vërsulej mbi tufa. Muza popullore e jetës së barinjëve është e pasur. Elementët e kësaj jete janë dëshmi e përpjekjeve, zgjuarsive e mjeshtërive të barinjëve. Vetë gjetjet e mjeteve si dhe mënyrat e ndërtimit e të gdhendjes së tyre përbëjnë një teknologji, e cila paraqet interes, sepse kjo na tregon mbi jetën e traditën e vyer baritore. Në Qafëmurrë barinjtë e tufave shkopinjtë izgjidhnin sipas natyrës të vetë trevës. I rrotullonin në një dru dushku në formë të rrumbullaktë pasi t'i ngrohnin në prush apo hirin e nxehtë të zjarrit. Kujdes të veçantë ikushtonin gdhendjes e lëmimit të shkopit. Në gjysmë elart barinjtë gdhendin mbi shkop gjarpërinj, 3-4 gjysmë hëna rrjesht lulëzonje etj. Shkopi kishte gjatësi mesatarisht 1 metër e 20 centimetra deri në 1 metër e 30 centimetra. Në kokën e shkopit zakonisht vinin një hekur ose teneqe dhe i

(Vijon në faqen 11)

skicë

Jeta baritore dhe disa elementë të saj

jepnin formën e një temruke të rrumbullakët e cila vlente për ta përdorur edhe ndaj bishës, por herë herë kryet e shkopinjëve e bënin edhe në formë të përshtatur me dy anë të dalura. Përkujdesje të veçantë dhe mjeshtëri në ndërtimin e saj, barinjtë e kushtonin edhe vathës. Këtë e vendosnin në anën ku e kapte më mirë dielli e që nuk e rrihte veriu. Për 100 kokë dele ose dhi përdornin përdornin rreth 50 trina. Vathohej toka afër shtëpisë ose livadhit. Vathimet bëheshin edhe me gardh me thupra ahu e hunj deri dy metra të gjatë. Tek qafa e vathës vihej stani ibariut me shtroje dhe mbulesë dërrase ku flinin 1 ose 2 barinj, të cilët edhe ruanin tufat gjatë verimit të tyre. Karakteristika më të dallueshme ndërtimi në jetën baritore paraqet stani i bjeshkatarëve, siç e quanin në trevën e Katër Grykëve, enët e bulmetit si dhe ndërtimi e gdhendja e tyre nga ana e barinjëve. Ky stan ishte ilartë 2 deri në 3. 5 metra, 3-4 metra igjërë dhe 4-5 metra igjatë. Në hyrje të tij vendosej një shtroje me fie rose gjethe ahu të thata, kurse sipër tyre viheshin tre-katër lëkurë deshësh në të cilat pushonin barinjtë ose vizitorët e ardhur. Periudha më e përshtatshme për verimin e tufave në zonën tonë ishte fundi imajit deri në fund të shtatorit. Një dukuri tjetër në kompleksitetin e jetës baritore dhe të elementëve të saj përbëjnë edhe e bulmetit të stanit të bjeshkëtores. Brenda në stan bëhej një shtrat prej dërrase një metër i lartë e një e njëzet i gjërë mbi të cilin vendoseshin enët e bulmetit si shegat, mëtini, shtruga, kupat e tjera. Kupat e nxënjes së kosit i bënin nga druri i palmës, pak më të thelluara se tepsitë dhe me dy vegë në anë. Sejcila kupë nxinte gati 4-5 kilogram qumësht, por kur bjeshkatoret mbulonin majsën në sejcilën kupë hidhnin 1-2. 5 kilogram qumësht të ngrohur pak ku kjo sasi të arrinte deri 2 centimetra. Ky qumësht i derdhur me kupa rrinte deri në 12 orë , i merrej majsa e trashë rreth 1 centimetër, kurse pjesa tjetër e qumështit të mbetur bëhej djathë duke i futur rranë nga stomaku i qingjit apo i kecit. Kullimi i djathit bjeshkëtorja e bënte telirës e cila e kishte madhësinë sa gryka e kupës dhe në njërën anë të rrumbullakores së saj kishte tri vrima në formë trekëndëshi ndërsa nga pas i ngjitej vega mbajtëse e drunjtë. Madhësia e talirës ishte sa gryka e shtamës shegës apo kupës me të cilën ajo përputhej , kur mbi të kryhej kullimi i djathit. Hirra e mbetur kullohej në një trastë basme, pas nxënjes, zierjes nxirrte gjizën. Ajo që mbetej pas saj quhej thartirë dhe bjeshkatorja që gatuante bulmetin këtë nuk e fuste në përdorim fare. Teknologjia e jetës baritore dhe elementët e saj pasqyrojnë vërtet një art, flasin për mjeshtërinë e punimit të bulmetit e të enëve, për motivet e larmishme të gdhendjes. Duke u njohur me elementët e jetës baritore e të teknologjisë së saj na del në pah tradita e mrekullueshme e kulturës materiale, popullore shfaqet me tërë bukurinë mjeshtëria e trashëguar ndër breza, gjë e cila përbën një thesar të vyer në fondin kulturor të jetës baritore. Në thellimin e njohjes të teknologjisë së punimit të bulmetit në stanin e bjeshkatores në Qafëmurrë, Prat, Runjë, Zmaç, Tolle, Shtrungës, Bulaç etj, mësojmë se majsa e marrë prej qumështit tek tufat në stan tundej në shegë me ujë burimi a me ujë dëbore të marrë nga shpellat e strehët e kurprës, sepse në këtë mënyrë nxirrej sasia e konsiderueshme gjalpi. Në shegë majsa tundej me një dru të lëmuar në formë lajse në gjatësi 1 me 20 centimetra duke e përzier nga e majta në të djathtë apo anasjelltas e duke ilëshuar ujë të ftohtë kun ë fund dilte gjalpi e dhallti të cilin e bënin shëllirë djathi. Shegat prej druri të arnenit e rrallë herë nga pisha, ahu, budi 4 deri në 5 orë të tillë. Veç këtyre në stan përdoreshin edhe shtrungat e mjeljes së tufave. Ata ishin në formë kusiash por më të gjata, merrnin mesatarisht 15 deri 20 kilogram qumësht. U viheshin 3 deri 4 rrathë druri dhe vega e ngritur lart që arrinte gjatësinë 15 deri 20 centimetra. Kupa e bariut dhe luga e drurit bëheshin më tepër nga duri i palmës nga se ky lëmohej më shpejt. Kupa merrte 1 kilogram deri 1-5 kologram kos, qumësht apo gjizë, ajo mbyllej nga kapaku, të cilit i bëhej një e thelluar në anën e jashtëme nga ku puthitej plotësisht me trupin e kupës. Qysh në gjetjet e hershme e deri në kohën tonë duket qartë mjeshtria e punimit të kupës së bariut. Barinjtë me përvojën e gdhendjes të motiveve në trevën tonë si Dik Daçi, Ramë Shehu, Asllan Nika, Kurt Lala e të tjerë njihen si mjeshtër të punimit të drurit sidomos të mjeteve të bariut, ndërsa vyrtuoz të tjerë popullor si Hasan Stafa, Met Bruçi, Mahmut Margjoka, Rexhep Murati, Liman Losha, Destan Demiri, Selman e Hasan Demiri njihen si punues të talentuar të enëve të bulmetit, të cilat përdoreshin në stanin e bjeshkatores. Motivet e gdhendjes në kupat e bariut ishin të larmishme si shqiponja, lulezonja, flamuri, armë, gjysmë hënë, motive idiellit, trekëndësha të mbushura me vija e të tjerë. Barinjtë dhe nënpunësit që shquheshin në gdhendje zakonisht mbanin këto mjete si teskën luce, garthorin i cili gërryente fundin e anëve, lëmojsin, daltën e shpimit, sqeparin, mefsen e rrathëve. Të tëra këto u shërbenin për të realizuar gdhendjen dhe mjeshtërinë e punimit të enëve. Jeta baritore është e pasur në elementët e saj, ajo përbën spektaklin e vërtetë të traditës sonë të mrekullueshme. E cila dëshmon për vitalitetin, për shpirtin atdhetar e punëtor të njerëzve tanë të thjeshtë. Kulturën baritore si mbarë kulturën e vyer të brezave mbetet që ta njohim, trashëgojmë e ta pasurojmë, sepse përbën kulturën e vyer popullore, një pjesë të shpirtit krijues e të traditave tona. Studimi i kësaj jete në trevat tona është me interes dhe përbën ende burime që pasqyrojnë qartë kulturën materiale popullore, shpirtin krijues e talentin e malësorëve tanë, vazhdimësinë e traditave të brezave, bukuritë e jetës baritore.

Eja në Botën e Ngjyrave
"ZAYA STUDIO"
nën kujdesin e piktorit Zaim Elezi, me një eksperiencë të madhe në këtë fushë
ORGANIZON KURSE PËR TË GJITHA MOSHAT
Së bashku ne mund:
- Të mësojmë të vizatojmë
- Të mësojmë të pikturojmë
- Të mësojmë gjithçka rreth artit figurativ
Adresa: **Rr. "Zenel Baboçi", pall. Ferar.** ***Tel:*** **068 22 46 400**

Ngarje e jetuar – Nga Dr. **SELMAN MEZIU**

Gjeografia e një fisi dhe polici

Saimiri nisi të tregoi me plotë pasion:

Ishte ditë shtatori dymije e katër. Prodhimet e stinës kërkoheshin nga njerëzit e qytetit tim. Mora udhën drejt Lezhës me kamion. Atje ishte një prodhues i mirë i rrushit të tavolinës. Kishim kryer ushtrin bashkë, e kurrë nuk i kishim shkëputur lidhjet. Në hyrje të qytetit më ndaluan dy polic. Pasi u mënjanova, mora dokumentat dhe shkova në drejtim të tyre. Njëri nga ato filloi kontrollin. Ndërsa tjetri me fytyrë të imët, por me gjatësi pothuajse dy herë më shumë se unë më thotë:

- Të ka skaduar patenta, kështu që duhet të leni makinën në polici. Pasi të rinovoni atë mund të vini këtu. Përndryshe…

- Me çfare të udhëtoj për në Peshkopi,- iu thash disi nervoz, por edhe i friksuar të cilën e ruaja të fshehur brënda qënies time.

- Kjo nuk na hynë në punë, zgjidheni vetë, – më përgjigjet polici tjetër që më mori e pa dokumentat e mia.

Brënda një javë u ktheva. Në sportelin ku duhesh të dërgoja dokumentat i njëjti punonjës policie. Pasi më mori ato, çuditërisht më ftoi për një kafe. E pranova, por më grryente përbrenda ftesa e këtijë njeriu që më mundoi kaq shumë. Tani asht hedhur në krahun e një njeriu të mirë. Çfare fshihet prapa këtijë gjesti bujarie? Mendoja në heshtje.

Pasi morëm kafetë, ai me thotë: - Më quajn Nikoll Camaj. Kam zbrit nga Plani i Dukagjinit në Lezhë kur erdhi demokracia.

Nuk mundja të mos ndërhyja: - Atëhere jemi vllazën, me të njëjtin llagap, ndoshta një fis. Dhe vazhdova: - Nga e keni origjinën? - e pyeta, duke pritur pothuajse me gojë hapur përgjigjen.

- Prejardhja jone qindra vjeçare asht nga Lami i Madh i Matit. Kështu ma ka treguar gjyshi, - më thotë qetësisht ai por fytyrë qeshur.

Unë mezi mbajta veten nga një gëzim i brendshëm. Nuk dija si të shprehesha. Por çuditërisht Nikolla ma lexoi mendimin në shprehjen e fytyrës dhe ndërhyri me plotë finesë:

- Tashma asht rradha juaj, më tregoni për historine e fisit tuaj.

Saimiri mblodhi veten dhe filloi:

- Edhe prejardhja e fisit tim asht nga i njajti fshat siç e thatë juve. I larguar për gjakmarrje. Jemi fis i shtueshëm. Gjëndemi në Peshkopi, Maqellar, Shupenzë, Viçisht, Gjoricë, Tiranë etj. I kemi dhane këtijë vendi, shkrimtar, dëshmore të luftës e të punes, ministra etj.

Nikolla dëgjoi me vëmendje ligjerimin. Të dy biseduan gjatë. Polici foli për Shkrimtarin, poetin, e studiuesin Martin Camaj. Njeri me kulturë të lart, njohesi i shkëlqyer i gjermanishtes. Bashkëpunëtor i Revistes ''Shejzat,, ''Koha Jonë,, e drejtuar nga Shkodrani Lec Shllaku e investuesi i botimit Isa Ndreu.

Ndërsa shoferi krenohesh me poetin, publiçistin e mjeshtrin e monografive Sakip Cami, me ish ministren e Arsimit për me se dhjetë vjet Tefta Cami etj. Foli per mjeshtra të ndryshem, dëshmor dhe heronj.

Koha kaloi pa u ndjerë. Bashkëbisedimi ishte i ngrohte, i hapur. Dukeshin sikur ishin njohur prej disa dhjetëvjeçarësh. U ndamë duke shkëmbyer numurat e telefonave dhe me shtërngim duarsh.

Saimiri mori makinën dhe e ngarkoi me rrush. Hangri disa kokrra. Ai ishte i amël si mjalti. I verdhëzuem e kokërr madh. Ndërsa përball shikonte shpatin e kodrës me rrjeshtat e shermeneve. A thua kështu ndodh edhe me fiset, me njerëzinë?- mendoi ai e në goje ndiente shijen e amël të rrushit të ngranun, e bisedën e ngrohtë me policin Camaj.

GRIMCA HISTORIKE

Tanima njihet historikisht se grupime popujsh, fisesh, familjesh, individësh kanë lëvizur e lëvizin në drejtime të ndryshme, për arsye, ekonomoke, politike, mungese ushqimi, terrorit e masakrave të luftrave të karaktereve të ndryshme apo në shqipëri nga krahina në krahine edhe për arsye gjakëmarrje, kërkime për zona të lira jetese, për të kërkuar punesim etj etj.

Janë bërë kërkime për të zbuluar prejardhjen e fiseve, por ende ka mbetur shumë për të bërë. ''Fisi Cami është shperngulur (Lami i Madh –Mat- S.M) dhe ka shkuar në Katundin e ri (Luzni. S.M) , në Peshkopi ,,(Dilaver Kurti ''Shënime etnografike nëpër mat.,, Geer 2004. f.92) Dhe ky mbiemër gjëndet i shkruar në pemën gjeneologjike të fiseve të Luznisë në shekuj(Mevlud Buci ''Alegoriae Luznisë dhe ''gjuha e zogjëve,, Tiranë 2010.f. 13)

Nga ky fis kemi figura të njohura si Prof. Dr. Martin Camaj ''…lindi më 21 Korrik1921 në katundin Temal të Dukagjinit dhe mbylli sytë në Munchen të Gjermanisë tue lanë në zi Zonjën Erika dhe fort të trishtuem miq e shokë, kudo që ndodhen…,, (Revisa ''Koha jonë,, Korrik – Shtator 1992. f.48).

Një ndër kuvendet më të rëndësishme që u organizuan për të luftuar kundër pushimit turk asht edhe ai i mbledhur në qytetin e Dibrës me 14 Tetor 1878. Dhe ja: ''Nga sa jemi në dijeni,- Shkruan Prof K. Frashëri - personalitetet më të shquara që u solidarizuan me këtë rezolutë qenë: Iliaz Pashë Dibra, Ahmet Karahasani, Isuf Karahasani, Isuf Doda, Bajram Buci, Llan Kaloshi, Hoxhë Moglica, MustafaLita, Hajredin Pitarka, Seit Daci, Halil Camaj, Sheh Hyseni, Mersin Dema, Sheh Sula i Zerqanit, Xhelal Qoku.,, (K.Frashëri. Historia e Dibrës. Tiranë 2012, f. 267)

Një tjetër patriot nga fisi Cami përmendet: ''Për të drejtuar lëvizjen patriotike që po rritej vazhdimisht, më 1906, u riformua ''Organizata kombëtare,, e Dibrës në kryesinë e së cilës hynë: Shyqyri Qoku, Kadri Fishta, Azis Menzelxhiu, Eqerem Cami(Camaj S.M), Sadullah Strazimiri.,, (K.Frashëri Historia e Dibrës Tiranë 2012, f. 321)

Shkrimtari, kritiku, studiuesi, poeti e autori i disa monografive Sakip Cami, mjaft prodhimtarë, dhe në fusha të ndryshme të dijes ka dhanë dhe jep ndihmë modeste në pasurimin e kulturës së gjithanshme dibrane. I lindur në Bulqizë më 06.02.1954, mesimet e para i mori në Viçisht, shkollën e lartë ushtarake e mbaroi ne vitin 1976.

Politikania e ministria e Arsimit në periudhën 1976 - 1987 Tefta Cami, duke drejtuar me zgjuarsi, kthjelltësi mendimi e kulturë arsimin shqiptar. Gjithashtu ka shkruar monografinë ''Ahmet Cami,, ka përkthyer nga frëngjishtja librin ''Historia sekrete e një grushti shteti,,. Vitet e fundit doli nga shtypi memorja historkie ''Kater ditë vizitë ne Kosovë,, ku shtjellohen ngjarjet politike në mes Kosoves dhe shqiperisë ne atë periudhë.

Ndërsa studenti i univesitetit të Mynihut Arbër Sh. Cami ka dale para lexuesve me një punim mjaft dinjitoz të titulluar'' Kalatë Shqiptare,, në fillimin e vitit 2013.

Origjina e tijë, shpërndarja në shumë vendbanime të atdheut, janë arteriet gjeografike të këtijë fisi, ndërsa zgjuarsia, arsimimi i tyre dhe veprimtaria e tyre, politike, patriotike, shkencore e kulturore asht pa diskutim historia e lavdishme e këtijë fisi të lashtë, gjithmonë me njërëz krenar, punëtor dhe të zgjuar nga natyra por dhe i çuar më tej nëpërmjet shkollimeve.

Rruga e Arbërit nr. 101
blogger

Jashtë rrugës...

Katundar nderi!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Si gjithmonë, kur vizitoj Peshkopinë, e bëj edhe unë një xhiro bulevardit, si 6000 banorët, sidomos burrat dhe të rinjtë. Njëherë, gjatë udhëtimeve të fundit, dëgjoj një zë nga pas:

- Or shoq, thkeje mor njer' krajet ka na! A ngjon, jam un' ktu!

Unë hiç, vazhdoj xhiron bulevardit. Por zëri këtë herë vjen më i fortë dhe më i ashpër:

- A naje a s'naje! Or taj i gazets, thkeje mor krajet, or turbesh! Apo t'asht rrajt menja... Shajf mor ktu! A ngjon a s'mgjon...

Njerëzit ca qeshin e ca ndalojnë, por unë prap sjam i sigurtë se a e kanë me mua, apo me ndonjë tjetër, por zëri tani bëhet më i naltë, si me dalë majëmali:

- Or taj i rrugjs s'arbnit! A nuk begenajs zotnaja jote me ba ni dor' muhabet me ne, knuesit... Po ne s'na ze xhumi mor dashamajr sa t'vije çajo gazeta, e taj s'na thken as krajet?

Tani e kuptova se "zani" pas shpine ishe për mua dhe ndaloj. Kthej kokën dhe shoh që dorë që lëvizte sa lart poshtë, e dalë nga një xhaketë a hapun që anonte nga njëra anë dhe dy këmbë që nisën të ndërrohen më shpesh. Për tre sekonda e kisha përpara. Një kokë burri ishte mbi kollaren e zhubrosur, lidhur si litar, që krijonte përshtypjen se mbante lidhur kokën pas trupit... E kisha parë edhe herë të tjera gjatë shkëmbimeve në bulevard, por asnjëherë nuk e kisha takuar. Ai sapo u afrua m'u sul:

- Ku e kishe tu kullot menjen, se kam gjith bulevardit si t'nehem mrapa... Desha me t'nal e me t'i thanë nja di vrejtje për gazetën... Shajf mu, e keni teprue pak! Filani, dhe thotë një emër, *ka qan hajdut ene e keni ba zotnaj burrë! Filani,* dhe thotë një emër tjetër, *ka qan spiun, dhe ja keni ba biografinë si me pas qan tue luftue dham për dham me Enverin. E keni prajsh krej, kur keni shkrue për filanin,* dhe prap thotë një emër tjetër, *si ka qan dënue n'koh t'partisë se shkote mas grave t'katunit, ene ju keni shkrue për ta se ka qan i deklasum.....*

Unë e ndërpreva se e pashë që po i përmendte me radhe personazhet për të cilët ishte shkruar në gazetë, dhe i thashë:

- Më fal, po si e kishit emrin, se nuk jua maj mend....

- Çish thue mor, dhe mori drejtimin e çuditur. Po taj paske lafajt krejt. Po a nuk m'njef mue... Po unë jam antar kshilli, Ae shef çet koc, po unë xhimsën e qitetarëve t'nderit i kam ba un. Ç'ki koc, ata si tarahajten rrugjave të Tiranës, i ka propozue për qitetar nderi...

- Aha, e kuptova, - bëj t'i përshtatem bisedës së tij. Por a nuk i zgjedh këshilli qytetarët?

- Vallahi, ajo Tiran ju ka ba budella ju... Po kush asht ai bir nane si m'del hasha mue? Po si t'grehem un' e t'thom se filanin do ta bajm qitetar nderi, kujt ja mà me kundërshtue... Ja çes sajt zgupthi me e menue, jo ma me e ba me t'vërtetë...

Shfaq pak mosbesim me rrudhje buzash. Ngre kokën mos shoh ndonjë të njohur që kalon andej dhe të më ndihmojë t'i largohem kësaj bisede, por e gjej veten të vetëm. Bëhem gati t'ia ndërroj me takt bisedën, por ai vazhdon:

- E shof se s'mbeson, e shof! Por a e din se un' t'bej ene toj qitetar neri! Ngjo ktu, ather' çish ke për t'thanë. Çe, e vem me bast se kam me t'ba qitet neri! Ene kur t'marrish titllin, ke me m'dhanë ni birrë ke turizmi...

- Oh, jo, shumë faleminderit! Nuk dua *"qitetar neri"*...

- Vallahi po, çki koc, - dhe i bie me grusht gjoksit aq fort, sa po më dhemb mua kraharori, *- o t'ban taj qitetar neri o ja bej bam mu ç'tu n'mes t'pazarit!*

E shoh se biseda me këtë lexues të rrallë, në mes të bulevardit bëhet e vështirë, dhe mendoj t'i hap rrugë që të më lirojë rrugën...

- Jo, jo, - nxitoj t'ia pres premtimet, - unë nuk dua *"qitetar neri"*, unë dua *"katunar neri"*...

- Prej ka je taj, si t'u thom atine t'komuns?

- Nuk ka rëndësi nga jam, rëndësi ka titulli!

- M'thuj katunin dhe e vdekme çajo punë...

Rashë dakord që ta marr titullin *"katunar neri"* por i kërkova pak kohë sa të mendohesha për katundin. I mora një numër telefoni dhe i thashë se do t'ia thoja me telefon emrin e katundit. Dhe ika me nxitim... Kur nga pas dëgjoj një zë pushke:

- Ej, m'thuj vrajk, se ene 4-5 muj ene mërdhajfën komunat!...

Prej asaj dite më ka marrë 4-5 herë në telefon, por unë nuk e kam vendosur akoma se cili katund më përshtatet! I kam në mendje 4-5 katunde, por nuk po di me zgjedhë! A keni ndonjë ide se cili katund më shkon?

ANEKDODA E MUAJIT

Erdhi kryeministri i Shqipërisë nga Kina, dhe sapo zbriti në Rinas, u nis drejt Dibrës, ku e prisnin me brohorima dhe lule mijëra dibranë.

- O dibrane, tha Rama, kam dy lajme për ju. Njëri është i mirë, tjetri është i keq. Cilin doni t'ju them të parin?

- Te majrin, të majrin, - thërriste turma.

- Lajmi i mirë është se jo vetëm që do ta ndërtojmë Rrugën e Arbërit, por do ta bëjmë autostradë!

- Edi Rama, Edi Rama, Rama, Rama, - brohoriste turma. Pas pak, ai tha: po lajmin e keq, e doni...

- Rama, Rama, thërriste turma...

- Lajmi i keq për ju është se do bëjmë Skavicën e madhe...

Turmës i mbeti "Rama" në goje sheshin e mitingut e mbuloi heshtja...

Nga fundi i turmës, një plak me zë të mekur që mezi u dëgjua tha:

- A ta lumsha, or Ram, t'paktën do vdesim me ni lajm t'gzuem!

Ditari i një vajze...

S'kam ku ec!







Idashur ditar, kam nevojë të rrëfehem tek ty, se këtu rrotull meje duket sikur askush nuk më kupton. Jo, jo, nuk kam probleme "zemre". Kam probleme ecje. Si ç'them?! Nuk kam ku ec o ditar!

Ja ta shpjegoj unë! Përpara pallatit konceptet trotuar apo rrugë si të ndryshëm nga njëri-tjetri nuk ekzistojnë. Sa dal nga hyrja duhet të shoh për ndonjë makinë që ia beh papritur nga kthesa. Ec pak dhe rruga ngushtohet, se komshinjtë kanë parkuar turrën e druve poshtë pallatit. Më tutje rruga është kthyer në fushë futbolli prej kalamajve, që nuk kanë edukatën minimale të ndalojnë lojën kur ka kalimtarë. Përkundrazi, ndonjë teveqeli ia shkrep në kokë edhe të të gjuajë me top. Që po e kapa ndonjë nga këto ditë do ia çoj s'ëmës që e ka llastuar, bashkë me një kërkesë nga pallati për ta ri-edukuar.

Më tej është Lirimi që po "spërkat" vendin para kjoskës së tij me zorrë dhe nuk pushon deri sa të bëhet llok! Unë aty, edhe në mes të verës, duhet të zgjedh qoshet e thata të rrugës duke u kacavjerrë nëpër muret e pallatit.

Dal në rrugën kryesore dhe mundohem të gjej momentin të kaloj mes makinash të tërbuara, se për vija të bardha e semafor as që bëhet fjalë! Sa ve hapin e parë në trotuarin tjetër pengohem te një arkë mollësh e pikës së shumicës. Shoh buzëqeshjen e shitësit me një dhëmb po, një jo e një ndoshta dhe vazhdoj. Dy minuta më tej xhupi më ngec tek një bisht fshese i dyqanit tjetër. Duke u munduar të çngec xhupin nga aty, shkel një kapak legeni që rrëzon gjithë turrën e legenave që ishin rreshtuar në mes të trotuarit. Zhurmë e potere. Bota ngriu për një çast. Të gjithë po më shihnin mua, që kisha mbet si pemë. Unë isha fajtorja kështu?! Xhevahiri, pronari i legenave, e si duket edhe i trotuarit, doli t'i mblidhte krejt inat.

E hutuar vazhdova aventurën e udhës për në shkollë, kur shoh atë tipin e çuditshëm me xhup lëkure e zinxhir floriri mbi golf, që më pret e përcjell çdo ditë. Kjo është histori tjetër, që do të ta tregoj ndonjë natë vere. Gjithsesi, për ta evituar si gjithmonë ndërrova trotuar. Mirëpo matanë ishte lokali Buçit, që tavolinat sigurisht i kishte nxjerrë në trotuar. Vendos të ec anës rrugës, ku duhet të bëja zig-zage nga karriget e nxjerra për të zënë vend-parkime. Aty erdhi një çerr që po hapej me makinën e të atit dhe donte të parkonte duke xhiruar gomat. Tym dynjaja! Në atë përpjekje dukej edhe më budall se ç'mund të ishte në të vërtetë.

Afrohem te shkolla dhe mu në mes të bulevardit shfaqet një kopé delesh që rëndë-rëndë po bënin xhiro. Bariu me shkop dhe me bluzë Armani po bënte një 'selfie' me telefon. Sa majtas-djathtas, mezi dola në një qosh pa dele.

Kështu mes legenash, tymi e delesh, parfumit që kisha vënë para se të dilja i ish zhdukur çdo gjurmë ..ashtu si qytetarisë në qytetin tim.

E kupton tani? Rrugët zotërohen nga makinat, trotuaret i kanë privatizuar dyqanet e lokalet dhe shëtitoren e ndajmë me bagëtitë... ne ngelet të fluturojmë!

Ndiq linqet e mëposhtëme në Web dhe Facebook për më shumë foto dhe komente nga Peshkopia e Dibra...
http://peshkopidiberalbania.wix.com
https://www.facebook.com/PeshkopiDiberAlbani

cyan magenta yelloë black

PANAIRI I LIBRIT I AUTOREVE DIBRANE

... DHE BOTIMEVE MBI DIBRËN

Botimet M&B në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Peshkopi, në kuadër të zhvillimit të edicionit të 20-të të Odës Dibrane, do të organizojnë në Peshkopi në datat 23-26 Tetor 2014, PANAIRIN E LIBRIT TË AUTORËVE DIBRANË.

7 Shtëpi Botuese, mbi 50 autorë dhe më shumë se treqind tituj librash do të prezantohen në Panairin e Librit në Peshkopi. Botime të reja nga Shaban Sinani, Agron Tufa, Naim Berisha etj. do të prezantohen gjatë ditëve të panairit. Takime të drejtëpërdrejta me shkrimtarët dhe poetët.



Speciale mbi botimet e reja në faqet 14-20

Rruga e Arbërit nr. 101

Prezantohet në Pallatin e Kulturës Kamëz
libri i ri i Xhafer Martinit

veprimtari

Një libër jo vetëm për Hilmi Kolgjegjën, por edhe për etnokulturën dibrane

Hilmi Kolgjegja – Një vend në Panteon

Nga **RASIM BUCI**

Xhafer Martini është një shkrimtar me përvojë të gjatë krijuese dhe me talent të spikatur. Një nga meritat e tij qëndron në faktin se ai shkruan me zgjedhje, jo me imponim, sidomos kur shkruan monografi, me çka kuptojmë jetëshkrime për njerëz të shquar. Kështu, për shembull, ai dyzet vjet më parë, kur emri i Elez Isufit njihej nga pak njerëz, mori nismën për të shkruar për të dhe mbas shumë peripecish të natyrave të ndryshme, në vitin 1994 vepra u botua me titull "Elez Isufi". Është një libër i cili u botua në dy mijë kopje, brenda një viti nuk gjendej në asnjë prej librarive. Por shkrimtari Martini, që nuk kënaqet kurrë me arritjet e tij, iu kthye prapë kësaj figure rreth një vjet më vonë dhe nxori në dritë librin "Gjenerali me shajak", që është më i bukur se i pari. Varianti i parë ishte shkruar në diktaturë dhe shkrimtari kuptoi që kishte lënë mjaft gjëra pa trajtuar, sidomos fakte e ngjarje te asaj natyre që i bënin hije figurës së Elez Isufit. Kësaj here ia tha të gjitha, por figura e tij në vend që të pësonte dëmtime, u ngrit më madhështore se kurrë. Kjo dëshmon thënien e një dijetari se për njerëzit e mëdhenj duhen thënë të gjitha. Një figurë tërheqëse, interesante dhe kontradiktore ishte ajo e Halil Alisë, për të cilën shkrimtari shkruajti librin "Kaq shumë gurë u hodhën përmbi mua", botuar më 2007, dhe që pati sukses. Këtij protagonisti autori i është rikthyer edhe njëherë. Ai ka gati për botim një monografi të re prej 500 faqesh. Kur kemi parasysh figura si ato që përmendëm, vetvetiu lind pyetja: po tek Hilmiu, çfarë zgjodhi, përse iu drejtua kësaj figure? Çfarë pa interesante te ai? Këtyre pyetjeve unë nuk do të dija t`u përgjigjesha nëse nuk do të kisha lexuar librin që ka shkruar autori ose do t`u përgjigjesha cekët, në mënyrë të sipërfaqëshme. Nga ky libër lexuesi mëson se Hilmiu ka qenë mbledhës i shquar folklori, studiues, qarkulluesi i folklorit, poet, muzikant, shkrimtar i talentuar, gazetar i spikatur, zbulues i talenteve të reja, metodist dhe udhëheqës i grupeve artistike, piktor dhe dizenjator i shkëlqyer, regjisor, organizator i punës shkencore dhe i veprimtarive të spikatura në këtë fushë, historian, filozof dhe mendimtar i thellë.

Hilmiu ka botuar rreth një mijë faqe folklor të të gjitha llojeve dhe gjinive të tij. Kemi këtu parasysh librin "Folklor nga Dibra" me rreth tetëqind faqe dhe librin "Perla shqiptare", rreth treqind faqe. Në Institutin e Kulturës Popullore dhe në Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë ka dorëzuar mijëra e mijëra faqe të tjera me material folklorik të të gjitha llojeve dhe gjinive. Në shtëpi ka ende një mal me këso krijimtarie, që vdekja nuk e la t`a merrte nëpër duar. Hilmiu nuk ka punuar sa një njeri i vetëm, por sa një institut në dhjetëra e dhjetëra specialistë, me rroga të mëdha dhe me të gjitha kushtet. Hilmiu nuk ka qenë vetëm mbledhës i folklorit, por edhe studiues i tij. Ka qenë edhe studiues i etnokulturës, historisë, dokeve, zakoneve, kanunit, të gjitha shtresave të kulturës popullore.

Nuk ka sesion shkencor në zona, në rreth, madje edhe në shkallë kombëtare ku ai të mos ketë kontribuar me trajtesat e tij. Ai ka qenë një organizator i shkëlqyer shkencor. Në Lurë, në pallatin e kulturës që u ngrit edhe nga vlerësimi i punës së tij të jashtëzakonshme, janë mbajtur dhjetëra sesione shkencore dinjitoze për historinë, jetën dhe kulturën popullore të trevës së Lurës, ku kanë marrë pjesë figura me peshë të madhe, si: Aleks Buda, Kristo Frashëri, Alfred Uçi, Androkli Kostallari e të tjerë.

Hilmiu projektonte dhe hartonte tematikën e çdo sesioni shkencor e aprovonte në institutin përkatës dhe u bënte ftesa me shkrim dhe me gojë personaliteteve shkencore që nuk kishin si t'ja prishnin këtij njeriu të pasionuar. Hilmiu ka qenë edhe poet, edhe muzikant i nivelit të lartë. Ai ka krijuar rreth njëqind tekste këngësh dhe i ka muzikuar po vetë. Shkoni në kartotekën e Radio Tiranës dhe i keni atje. Disa prej këtyre krijimive janë të mrekullueshme,si për shembull kenga per "Shtate liqejt e Lures",kënduar nga Arif Vlafi,kënga për Dom Nikollë Kacorrin kenduar nga Lirie Rasha, kënga "Kur lulet celin" kënduar po nga Arif Vladi, "Kam qëndisur një shami" kënduar nga Shkurte Fejza.Bashke me këngën e Hilmiut që janë krijime të mrekullueshme n ë dac si tekst, në dac si muzikë,u rriten dhe shkëlqyen këngëtarë të mëdhenj si Liri Rasha, Arif Vladi, Qerim Sula,për të përmendur vetëm më të shquarit,sepse ka me dhjetra të tjerë nga Lura ,që tek libri për Hilmiun janë evidentuar të gjithë. Hilmiu, kudo ku ka punuar, ka ngritur grupin më të mirë artistik, në shkollë, në zona rurale dhe kudo. Hilmiu ishte një regjisor i talentuar, ai dinte të punonte me të rinjtë dhe të rejat. Grupi artistik i Lurës zinte vendin e parë në takimin zonal, vendin e parë në shkallë rrethi dhe po vendin e parë në shkallë kombëtare. Hilmi Kolgjegja ishte edhe një piktor i shquar, sado që nuk bëri shkollë për pikturë. Ai na ka lënë disa autoportrete, disa portrete për familjarët, një tablo të madhe për një legjendë për Skënderbeun. Ai ka mbuluar emulacionin socialist, siç thuhej atëherë, kur duheshin zënë me shkrim të bukur dhe me fotografi sipërfaqe të mëdha muresh dhe këndesh. Ky ishte një talent që shpërdorohej, por Hilmiu ishte i detyruar ta bënte. Hilmiu ka qenë dhe gazetar i spikatur, ai ishte kryeredaktori i gazetës "Lura", revistë e ilustruar me fotografi me ngjyra. Nuk arriti të botonte vetëm dy numra të saj, por edhe nga ato dy numra mund të arrish në përfundimin se ajo shënoi një ndër kulmet e shtypit tonë të këtij lloji.

Që në numrin e parë, krahas fotografive të shkëlqyera, nga bukuritë e Lurës dhe të gjitha vendeve turistike të Shqipërisë, ai ka botuar shkrime interesante nga mjeshtrit e fjalës si Dritëro Agolli, Shaban Sinani e të tjerë. Hilmi Kolgjegja ishte edhe mendimtar, edhe filozof. Këtu dikush mund të buzëqesh me ironi! Por Martini e argumenton atë që thotë me shembuj nga krijimtaria e Hilmiut, nga thëniet e mendimet e tij.

A mund të rrinte Xhafer Martini, që edhe vetë është një figurë poliedrike, pa u interesuar për një njeri me kaq shumë prirje dhe talente? Por këto unë i përmenda shkurt, fare shkurt dhe pa cilësinë e nevojshme, Xhafer Martini i thotë në vendin e duhur, në kohën e duhur dhe në mënyrë shumë shkencore dhe shumë artistike. Kjo është figura e Hilmi Kolgjegjës, në librin e mrekullueshëm të Xhafer Martinit.

Kur lexon këtë libër, ndjen dhe kupton që ai nuk është vetëm për Hilmiun, nuk është vetëm për Lurën, nuk është vetëm një studim për atë ç'ka solli Hilmiu, po për gjithë kulturën dhe etnokulturën tonë në përgjithësi. Kjo vjen nga fakti se autori e pasuron krijimtarinë e Hilmiut me prurje të reja nga gjithë kultura shqiptare, duke ballafaquar dhe përqasur vlera të natyrave të ndryshme. Kjo dëshmon se libri nuk është shkruar shpejt e shpejt, me nxitim. Më kujtohet se ky autor interesin për Hilmi Kolgjegjën dhe punën për pasqyrimin e veprave të tij e ka nisur shumë vjet më parë, kur në gazetën "Rruga e Arbërit", që në numrat e saj të parë, ka botuar studimin e plotë dhe më shumë vlera "Po vjen shkencëtari Hilmi Kolgjegja". Veprat e arrira projektohen, ndërtohen dhe shkruhen për një kohë shumë të gjatë. Martini nuk merret me jetën e Hilmiut , siç mund të merrej një tjetër. Mbasi jep pak faqe për rininë dhe shkollimin e tij, përqendrohet te vepra. Po kur flet për veprën e tij, ai gjen kohën dhe mënyrën për të na e dhënë portretin e Hilmiut, i cili me çantën në shpinë, në tufan dhe në zhegun e vapës merrte rrugët për tek arti i madh i popullit. Martini përshkruan atë dhomën e vogël të Hilmiut, që nuk kishe nga të silleshe, se ishte e mbushur me mijëra faqe e dorëshkrime. Dembelat dhe mediokrit merrnin zgjerime dhe rehatoheshin, kurse shkencëtari i madh punonte ne kushte shumë të vështira. Ja pra, pse Xhafer Martini iu drejtua kësaj figure, me nismën e vet, pa asnjë ndihmë dhe asnjë përkrahje.

Thashë vetëm disa konstatime të përgjithshme për një libër që vërtetë të pasuron, të jep kënaqësi dhe të frymëzon në punën tënde, pavarësisht nga profesioni që ke, sepse ky libër përshkohet nga mendimi se puna dhe vetëm puna krijon vlera. Natyrisht, që në librin e Xhafer Martinit kemi punë dhe talent të spikatur. Kur puna dhe talenti bashkohen bëjnë mrekulli.

Në mjediset e Pallatit të Kulturës të qytetit të Kamzës është zhvilluar ceremonia e promovimit të librit të autorit Xhafer Martini, "Hilmi Kolgjegja – Një vend në Panteon", studim monografik, organizuar nga Bashkia dhe Qendra Kulturore Kamëz, në kujdesin e kryetarit të bashkisë z. Xhelal Mziu.

Nën drejtimin e regjisorit Fran Vukaj, kjo veprimtari mblodhi shumë miq e të afërm të autorit si dhe studiuesit dhe artistit të shumanshëm Hilmi Kolgjegja. Në prezantimin e librit që përkonte me 75-vjetorin e lindjes së z. Kolgjegja dhe 15-vjetorin e vdekjes së tij, morën pjesë studiues, kritikë të artit dhe të kulturës, bashkëpunëtorë të të dy autorëve të nderuar, Martini dhe Kolgjegja, miq dhe bashkëkrahinas të Hilmi Kolgjegjës.

Përshëndetën në këtë veprimtari edhe këngëtarë e muzikës popullore, mes tyre e mirënjohura Liri Rasha, ish-nxënëse e Hilmi Kolgjegjës, për të cilin ajo u shpreh se hapat e parë të artit i kishte marrë nga Hilmiu. "Ai më dha dorën dhe unë vazhdova rrugën e artit", - tha ajo para se të këndonte një nga këngët e krijuara pikërisht nga Hilmi Kolgjegja.

Librin e fundit të Xhafer Martinit e kanë përgëzuar studiues dhe bashkëkohës të Hilmi Kolgjegjës, si dhe kolegë të autorit Martini. Mund të përmendim Fejzulla Gjabrin, Osman Vladin, Xhezair Abazin, Rasim Bucin, Esat Rukën, drejtorin e Pallatit të Kulturës Kamëz, Baftjar Çera etj. Si shenjë mirënjohjeje për krijimtarinë dhe veprën e dy autorëve, Martini dhe Kolgjegja, kryetari i Bashkisë Kamëz u akordoi atyre edhe certifikatat "Mirënjohja e Qytetit". Në fjalën përshëndetëse të tij, kryebashkiaku Mziu u shpreh se ndihej i nderuar që promovimi i librit të Xhafer Martini zhvillohej në Pallatin e Kulturës Kamëz, dyert e të cilit, siç u shpreh z. Mziu, janë të hapura për këdo.

"Ky është një organizim që ka të bëjë me një figurë që i ka kaluar dimensionet jo vetëm të Lurës, jo vetëm të Dibrës, por të mbarë Shqipërisë dhe është me të vërtetë një kënaqësi e jashtëzakonshme për mua që të marr të drejtën e fjalës për Hilmi Kolgjegjën, i cili edhe pse



Librin e fundit të Xhafer Martinit e kanë përgëzuar studiues dhe bashkëkohës të Hilmi Kolgjegjës, si dhe kolegë të autorit Martini, si: Fejzulla Gjabri, Osman Vladi, Xhezair Abazi, Rasim Buci, Esat Ruka, drejtori i Pallatit të Kulturës Kamëz, Baftjar Çera...

ka vdekur, vazhdon që të jetë në memorien e gjithsecilit prej atyre, që kanë pasur rastin për ta njohur nga afër, por edhe kanë lexuar, kanë dëgjuar apo kanë pasur mundësinë e kontakteve në fusha të ndryshme për të parë dimensionet e tij", - tha mes të tjerash z. Mziu. Ai theksoi se Lura është mjaft e mirë, e bukur, për shkak të kushteve natyrore, por atë e ka mitizuar më shumë, e ka bërë më të bukur edhe Hilmi Kolgjegja.

"Unë gjej rastin të falënderoj z. Martini, jo vetëm për këtë libër, pasi ai është një figurë letrare kombëtare; është një privilegj për qytetin tonë që bën promovimin e një ndër librave të shumtë që ky shkrimtar i madh ka shkruar dhe jam i sigurt që do shkruajë edhe në të ardhmen", mbylli fjalën e tij përshëndetëse z. Xhelal Mziu.

Autori i librit Xhafer Martini, duke falënderuar Bashkinë e Kamzës dhe kryetarin e saj për vlerësimin dhe kujdesin në organizimin e kësaj veprimtarie, si dhe këngëtaren Lirie Rasha dhe studiuesin Xhezair Abazi për ndihmën e dhënë gjatë procesit të shkrimit të librit, tha se librin "e ka shkruar vetë Hilmi Kolgjegja, pasi si autor i tij nuk kishte ndier vështirësi të fliste dhe të shkruante për Hilmi Kolgjegjën, për jetën dhe krijimtarinë e gjithanshme të tij".

Studimin monografik për Hilmi Kolgjegjën dhe autorin e tij folësit e përgëzuan dhe e vlerësuan, duke u shprehur se libri nuk është si monografitë e zakonshme, por edhe pse voluminoz, lexohej me një frymë, duke të sjellë kënaqësi dhe respekt për këtë figurë të kulturës popullore shqiptare.

Në këtë veprimtari kanë përshëndetur edhe të afërm e familjarë të të ndjerit Kolgjegja.

recensë

Rreth librit më të ri të Xhafer Martinit
"Hilmi Kolgjegja – një vend në Panteon"

Ç'na la Hilmi Kolgjegja, që autori kërkon një vend në Panteon?





*Nga Dr.***FEJZULLA GJABRI**

Libri monografiko- shkencor "Hilmi Kolgjegja – një vend në panteon", i shkruar me një përkushtim prej shkrimtarit dhe studiuesit Xhafer Martini, nga pendat e mirënjohura të Dibrës, është një vepër ndryshe-monografi. Kjo ndryshe-monografi, na bën ta cilësojmë një vepër studimi e plotë jo vetëm për Hilmi Kolgjegjen, por në tërësi për folklorin dibran dhe më tej. Autori Xhafer Martini ka përcjellë te lexuesi një pasionant të kulturës popullore që "nuk i rëndohej puna, nuk e lodhte, nuk e mërziste, ajo i jepte kënaqësi. Hilmiu ka qënë i lumtur, siç thotë autori, me gjithë privacionet dhe vështirësitë ekonomike, me gjithë pakënaqësitë që ia shkaktonin të tjerët, me gjithë qarkullimin e shpeshtë dhe lëvizjet pa kriter, me gjithë përdorjen prej të tjerëve, për të bërë ato punë që duhej t'I bënin vetë". Dhë më tej: "Hilmiu ka vdekur i lumtur dhe kjo i ndodhi prej pune". Pak fjalë në enumercion, por që thonë shumë.

Me gjuhën e artit, autori flet pak për vendlindjen dhe rrethanat e Hilmi Kolgjegjës, për të nxjerrë në pah vlera të tjera, ato vlera që e bënë të pavdekshëm.

Në këtë aspekt, autori i bën trajtim të mirë disa etimologjive, siç është Kolgjegja, tipareve të të parëve e më tej që lidhen me traditat gojore, toponimet e caktuara, si Lura, që sugjerojnë një konkuldim për autorin se: ".. unë ju dua, ju dua se e di: Ku ka male ka edhe shqiponja, ku ka male ka edhe trimëri".

Megjithatë trungu familjar është përcjellë te lexuesit mjaft ngrohtësisht, aq ngrohtësisht sa e kanë trajtuar njeriun e ditur Hilmi, njerëzit e afërt, veçanërisht e shoqja. Në të vërtetë, ky libër monografik, me të dhëna, komente, analiza e shembuj të shumtë nga oda dibrane, nga perlat shqiptare, nga citime të personaliteteve shqiptarë e botërorë që ofron, i shërben jo vetëm lurianëve e dibranëve, por çdo lexuesi, studiuesi e letrari, si studim inspirues i kulturës dhe të të shkruarit të saj.

Së pari: Është vjelë pasuria e mbledhur, sistemuar e botuar e Hilmi Kolgjegjës;

Së dyti: Është analizuar e plotësuar me simotra, duke sjellë paralele nga krijimtari të tjera popullore;

Së treti: Vlerëson në shkallën më të lartë punën skrupuloze të 'shkencëtarit', lënë prapa, siç thotë autori, edhe studiues që janë marrë një jetë me këtë punë, kanë fituar grada shkencore, por janë larg Hilmiut;

Së fundi, sjell risi në mënyrën e të shkruarit të një monografie. Në këtë formë, kjo monografi, përveç se plotëson një boshllëk jo të vogël, është një lloj grishje për të filluar dokumentimin e punës së atij që i kushtohet monografia, në forma dhe variante të ndryshme. Dhe, mënyra më e mirë, absolutisht më e mirë, për të bërë këtë, është përmes analogjive, duke shkuar në kohë.

* * *

Libri që kemi në dorë vlen edhe si përjetshmëri e ngjarjeve jo vetëm në folklor, por edhe te mbledhësi e dokumentuesi i vlerave kulturore. Sigurisht që edhe ata jetojnë në një kohë, që është e ndryshme nga e sotmja. Kjo mënyrë e stili gjuhësor, të shtjellimit të veprës (qoftë punëtor i mendjes apo i luftës) Xhafer Martini tërheq vëmendjen e studiusve të zakonshëm, që flasin e flasin për jetën e dikujt me fraza të zakonshme (pa u thënë boshe), duke lënë thelbësoren: lidhjen me atë që ka të veçantë, nëpërmes të zakonshmes.

Ç'na la Hilmi Kolgjegja, që autori kërkon një vend në Panteon?

Kësaj pyetje, pa përdorur pyetje, autori përgjigjet: Të njohura janë dy vepra: Folklor nga Dibra dhe Perla shqiptare. Po jo vetëm kaq. Mjaft shkrime të tjera, bile edhe piktura. Por autori ngul këmbë të ajo kryesorja: pasioni i tij për mbledhjen e pasurisë kulturore, te disiplina e punës, që kudo shkoi la gjurmë, te personaliteti i tij që nuk u zemërua asnjëherë me punën, me vështirësit, qoftë edhe kur t'i sillnin të tjerët. Pra, studimi është konceptuar qartë që në krye, duke shenjuar mirë cilat ishin detyrat, që duhej të zgjidhte dhe si do të arrihej deri në përfundimet e pritshme. Kjo shprehet edhe në strukturën e qëndrueshme të studimit, në rendin e përpiktë të parashtrimit të lëndës, duke shkuar prej detyrës më të përgjithshme tek ajo më e përveçmja dhe, duke i dhënë përfundimisht punës së Hilmi Kolgjegjës edhe një rezultat të drejtpërdrejtë shkencor folkloric e filologjik. Thirrja e krahasimeve dhe njohurive bashkëkohore, çon autorin në shqyrtimin kritik dhe stabilizimin e tekstit të poezisë apo prozës popullore.

VLERËSIMI

Autori i monografisë vlerëson dijet e Hilmiut. Kjo se dikur e kaluara historike rrëfehej përmes mitesh e më pas legjendash. Të dyja këto erdhën në ditët tona të mjegulluara, ku pjesa më e madhe e miteve humbën gjatë rrugës në shekuj. Këtu Martini bën edhe një kritikë për mungesën e pasqyrimit të tyre. Pastaj erdhi balada, kënga, poezia, të cilat pothuajse janë vjelë nga Kolgjegja. Pra, lindi arti. Këngën e këndonin njerëzit e veçantë, ata që në shpirt kishin muzën, frymën hyjnore, frymëzimin. Kjo krijimtari flet për bëmat e popujve e heronjve të tyre. Këto bëma, mbetën të pavdekshme, falë këngëtarëve popullorë, bardëve të lashtë e rapsodëve të mëvonshëm. Pikërisht ky mendim ishte përkushtimi i Hilmi Kolgjegjës dhe këtë na e thotë me art shkrimtari, Xhafer Martini.

Tashmë, vëllimet "Folklor nga Dibra" dhe "Perlat shqiptare", si dhe mjaft mbledhje të tjera, mbeten kronika të gjalla të jetës heroike, të ngjarjeve të rëndësishme të Dibrës e më tej, të punës dhe jetës, të filozofisë e artit popullor. Vlerësimin për Kolgjegjën autori e jep në një kapituul të veçantë, me titull "Si punonte Hilmi Kolgjegja me artin e madh të popullit". Edhe këtu autori bën një analizë dhe jep mendime të vyera, duke u përqëndruar te 'heroi' i punës, Kolgjegja. "Parimi i të mbledhurit të folklorit është ai fonetik, që fjala duhet shkruar ashtu siç shqiptohet...", shkruan Xhferi. Duke dhënë shembuj konkret, ai flet dhe për vështirësitë, për përgatitjen dhe durimin e atyre që mbledhin fjalën artistike popullore, duke shtuar, se një shembull është Dhimitër Shuteriqi, kur regjistroi këngën e Jovan Bardhit.

Ndërsa për Kolgjegjën, shprehet: "Hilmiu si ato stenografistët, mbante njëzet lapsa të mprehur mirë e mirë dhe shkruante e shkruante. Ai zotëronte edhe shenjat diakritike të paraqitjes së ngjyrimeve fonetike.." (f.128). Diku tjetër thotë se "Hilmi Kolgjegja e ka përmbushur këtë detyrë shumë të madhë dhe të vështirë jo vetëm për shkak të njohurive të thella që kishte për folklorin letrar në veçanti, por edhe për tërë kulturën shpirtërore të popullit në përgjithësi, si dhe për karakterin si njeri".

KRITIKË?!

Po, jepet edhe kritikë, por jo për faje të Kolgjegjajt. Martini di të bëjë kritikë. Bile, mund të them se në këtë lëmë shkëlqen. Në kritikën e tij janë thyer ato modele kritike, që e bënin lexuesin të pandjeshëm, të painters, ose e thyenin. Kjo mendoj se vjen ngaqë autori njeh mirë Dibrën dhe viset përreth. Njeh traditën dhe folklorin. Njeh edhe Kanunin për të cilin ka një vepër të plotë. Njeh edhe Kolgjegjën e veprën e tij. Prandaj di dhe të bëjë kritikë. Martini ka njohuri të marra në biblioteka nga shkrimtarë të mëdhenj vendas e të huaj, si Osho, Cvajku, Ludvig etj, të cilët edhe i citon në këtw monografi. Në mënyrë elegante për Folklor nga Dibra, sqaron se: "...nuk mund të pretendohet se folklori i kësaj përmbledhje është e gjitha nga Dibra...", duke veçuar Lurën e Kalanë e Dodës. Dhe fajin e hedh te koha që nuk ishte mundësia e mbledhjes së gjithë folklorit të Dibrës, duke lënë Dibrën e Madhe, apo folklorin religjoz. Ndonjë vërejtje është krejt konkrete, siç është fjala për strukturën e botimit "Folklor nga Dibra" dhe këtu duhej të ishin specialistët e Institutit të Kulturës Popullore.

Kritika e Martinit 'shpon' larg. Larg për Kolgjegjën, por mu në zemër atyre që janë marrë gjithë jetën me këtë punë. Fundja, një mësues, një përgjegjës kulture, qoftë edhe në një qytet të madh, qoftë edhe zheni, kohën më të madhe do ia kushtojë punës për të cilën paguhet, ndër të cilët ishte edhe Hilmi Kolgjegja.

Pikërisht kritika shkon të ata që paguhen për këtë punë. Ata nuk dallojnë, siç thotë autori për këtë vëllim, se: "... ka ngatërresa mes këngëve të dasmës dhe të dashurisë", duke cituar studiues të njohur të trevave tona. Jam i sigurt se mendimet kritike të autorit godasin fort në mangësitë e punës së institucioneve shkencore të profilizuara për këtë punë.

MJESHTRI I ALEGORISË

Kështu e titullon një kapitull më vete Martini, kur analizon ketë zhanër të mbledhur nga Kolgjegja. "Një nga librat më të rëndësishëm të Hilmi Kolgjegjës është ai me titull "Perlat shqiptare". Pjesa më e bukur e tij është alegoria" – shkruan Martini, i cili u bën një analizë dhe kritikë studimore për t'u patur zili. Fundja çdo studim që bëhet, ka një synim. Dhe autori e ka dhënë mesazhin në ketë studim. Nuk është fjala thjeshtë për studimet, por për përdorimin e alegorisë dikur dhe sot në ligjërimin e përditshëm.

Duhet thënë se gjithë studiuesit e kanë quajtur gjuhë të fshehtë, me emërtimin "mesele", të folur *me "shifër" apo "rrotulla", llaf nën mutaf etj. Gjithashtu ata kanë konstatuar se kjo* mënyrë të komunikuari është i ndërvarur nga rrethana të caktuara. Një pyetje shtrohet, kur flitet për alegoritë popullore: A duhet gjykuar për përdorimin e këtyre shembëlltyrave, ose më saktë a duhen përdorur alegoritë?

Mendoj se alegoria ka pikat e saj të forta, të cilat janë dhënë në monografinë e Martinit. Janë thënë qëllimet e hershme dhe të sotme, prandaj po jap edhe një mendim. Alegoria popullore vjen nga hershmëria dhe si nevojë komunikimi në rrethana të caktuara historike e shoqërore. Gjithashtu rrethanat kanë përcaktuar që brenda një nëndialekti (jo vetëm në Dibër, por edhe në vise tjera) të kemi sot këto visare. Në pamje gjuhësore, që autori i ka sqaruar më parë, ato janë si shprehje të bilinguizmit dialektor, me vlera të shumta për pasurinë e fjalëve të rralla shqipe, sintaksën popullore, begatinë artistike etj. Nga ana tjetër ato duhen parë si një dukuri e etnolinguistike, me shtrirje gjeografike të ndryshme në trevat shqiptare. Aty jeton në simbiozë kultura shpirtërore dhe materiale, të lidhura natyrshëm midis tyre. Këto e të tjera vlera janë pika të forta të shembëlltyrës, të folurit me shifër.

Nëpër studimin e Xhaferit është folur për rrethanat e përdorimit të komunikimit me shifër. Ky komunikim ka faktorët e brendshëm si dhe mjedisin e saj, që mund t'i marrim si faktorë të jashtëm. Faktorët e brendshëm, zakonisht ose të paktën pjesërisht, janë në kontrollin e drejtpërdrejtë të aktorëve kryesorë. Po mjedisi, si reagon? Duhet parë më thellë, sidomos në rrethanat e sotme. Në vise shqiptare ka edhe një aforizëm: "Miku është si shishja e llamës". Anëtarët e një komuniteti e njohin njëri-tjetrin dhe gjuha "me bente" nuk merr vlera mesazhi për ta. Me një fjalë, me të afërmit nuk flitet me shifër. Faktorët e jashtëm zakonisht nuk janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të aktorëve kryesorë, prandaj kujdesi për të mos 'vra' mikun është i vazhdueshëm, pasi gjuha alegorike ndonjëherë kthehet në bumerang.

Por, vlera mbetet vlerë. Të gjithë ata që kanë kontribuar në mbledhjen e botimin e alegorive duhen përgëzuar. Përgëzimi u takon së pari mbledhësve, ndër ta Hilmi Kolgjegjës, por edhe studiuesve, ndër të cilët është Martini.

Së fundi, në monografinë e Martinit, ashtu si në veprën e Kolgjegjajt, nuk mungon asnjë zhanërr i krijimtarisë popullore, pa analizuar. Aty është këngа legjendare, historike, humori, vajet, dashuria, dasma, këngët e Luftës Na-cl., veprat në tërësi të Kolgjegjat etj. Së fundi është edhe vendi në Panteon. E vështirë është vendosja në Panteon.

Njeriu ndjehet mirë, kur ka bërë dicka të vlefshme, por ndjehet i lumtur, kur u ka dhënë të tjerëve shansin, mundësinë apo motivin për të qënë mirë! Hilmiu në penën e Xhafer Martinit ka plotësuaar kushtet për në Panteon. Kjo edhe se i ka dhënë shansin, motivin për të shkruar për të. Prandaj, mendoj se edhe autori ndjehet mirë me motivin e Kolgjegjajt. Erich Fromm, thotë: "Nuk ka deklaratë më krenare, të cilën mund ta bëjë njeriu, sesa kur thotë: Do të veproj në harmoni me ndërgjegjen time".

Parabola në fund të monografisë flet së tepërmi...

Rruga e Arbërit nr. 101

Në prag të panairit të parë të librit në Peshkopi

panair

Ta kthejmë librin në një pjesë natyrale të Odës Dibrane



Ky panair është hera e parë që mbahet në Peshkopi dhe organizatorët mendojnë se libri do ta zbukurojë "Odën Dibrane", festivalin tradicional folklorik, që këtë vit mbush 20 vjetorin, si dhe do të shënojë një risi për ta bërë panairin e librit më të madh dhe tradicional, vit pas viti, për ta shndërruar Odën në një festë të madhe kulturore...

Nga **ILMI DERVISHI**

Botimet M&B në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Peshkopi, në kuadër të zhvillimit të edicionit të 20-të të Odës Dibrane, do të organizojnë në Peshkopi në datat 23-26 Tetor 2014, Panairin e Librit të autorëve dibranë dhe botimeve mbi Dibrën.

Në këtë panair janë ftuar të marrin pjesë shtëpi botuese dhe autorë që në fondin e botimeve të tyre kanë botime të këtij karakteri. Sipas informacioneve nga organizatorët, deri më 30 shtator, janë regjistruar për pjesëmarrje në këtë panair mbi 7 shtëpi botuese, mbi 50 autorë dhe gjatë ditëve të panairit do të prezantohen mbi 300 tituj të ndryshëm, nga botime të reja të posaçme për këtë panair, deri në botime në vitet e fundit dhe më herët.

Ky panair është hera e parë që mbahet në Peshkopi dhe organizatorët mendojnë se libri do ta zbukurojë "Odën Dibrane", festivalin tradicional folklorik, që këtë vit mbush 20 vjetorin, si dhe do të shënojë një risi për ta bërë panairin e librit më të madh dhe tradicional, vit pas viti, për ta shndërruar Odën në një festë të madhe kulturore.

VËSHTRIM MBI BOTIMET MBI DIBRËN

Letërsia gojore folklorike dibrane i ka fillesat e saj të kahershme, lënda folklorike është e gjerë dhe përfshin këngë historike, patriotike, këngë dasme e rituale. Në krijimet popullore mes shumë elementëve ka dhe karakteristikë dhe elementin dialektik të të folurit të krejt zonave të Dibrës. Një ndër këto krijime është dhe kënga për pashain turk Hajredin Pasha, që dhe sot ka vlerat e saj historike dhe si tekst vlera artistike. Në librin "Mbledhës të hershëm të folklorit" (1635-1912) botuar nga Instituti i Folklorit në vitin 1962 gjejmë si krijim të Dibrës dhe këto vargje:

Disa në Shkup disa në Janinë/ Dil e shif ushtarët ke vijnë /Serasqeri me Radinë /ku vallë janë malet e Dibrës? /Bëjnë llogore në fushë të Gjoricës.

Te kjo këngë bëhet fjalë për luftën që bëri populli i Dibrës kundër forcave ushtarake, të cilat u dërguan në vitin 1844 nën komandën e Hajredin Pashës për të zbatuar Tanzimatin në këto krahina, që njihet dhe si këngë "Hajredin Pasha po i bie Radikës", kënduar nga Haziz Ndreu.

Në revistën "Albania" 1897-1909, krahas këngëve mjaft të njohura edhe në ditët tona është dhe kënga: "Hajde-hajde o Selman Lika / Sot e sot na qenka dita",

Ku bëhet fjalë për ngjarjet në periudhën e Lidhjes së Prizrenit, janë edhe shumë këngë të tjera që bëjnë autorësi "Dibrën" dhe ruajnë origjinalitetin e dialektit:

Ç'këndon bilbili në kafës të argjendë /A s'të vjen keq për vatanin tënd / Keq më vjen, më këputet zembra / Po bëj me dalë e s'më çelet dera.

Botimi i gazetës "Shqypja e Shqipnisë" që drejtohej nga Josif Bageri (1868-1915) u botuan dhe mjaft poezi me frymë popullore nga autorët dibranë e më gjerë, por deri tani njihet si libri i parë me poezi i autorëve dibranë vëllimi "Kopsht malësori" 1910 nga Josif Bageri nga Reka e Dibrës. Më vonë rreth viteve 1920 "Marshi i djelmërisë dibrane", shkruar nga mësuesi i popullit Haki Sharofi, erdhi jo vetëm si himn, por edhe si një krijim me vlera artistike. Botimi i vargjeve të lira të Migjenit, viti 1936, po me origjinë nga Reka e Dibrës si dhe romanin "Sikur të isha djalë" i Haki Stërmillit, po në vitin 1936, filloi proza e parë me autorë dibranë dhe dy nga veprat më të mira për lexuesin e gjithë kohërave dhe vlerësuar nga kritika edhe në ditët tona.

Mençuria natyrale e dibranëve e trashëguar në breza nëpërmjet thënieve e tregimeve alegorike gjeti veten edhe në krijimet artistike, emra të njohur si Haziz Ndreu, mjeshtër i madh, artist i merituar, botoi librin "Valët e Drinit të Zi" më 1966, "Një trim i Skënderbeut në Dibër", pasuar nga dramaturgët dibranë Sulejman Pitarka (mjeshtër i madh) me dramën "Familja e peshkatarit" i cili u vlerësua dhe me çmime dhe dramaturgu dhe kritiku i artit Ismail Hoxha me dramën "Në emër të lumturisë". Emra të rinj, por me një pjekuri artistike, erdhën në poezi si Xhafer Martini me vëllimin "Tingulli rinor" (1967), "Kur bie shi" (1973), në prozë Faik Ballanca me vëllimin me tregime "Mbasdite të lagta" dhe "Letra anonime"; Lutfi Hanku "Në gjurmët e heroit"; Prof. As. Dr. Arjan Kadiu në librin "Takimi i parë" dhe "Pse dridhej harku i violinës", si dhe krijimet e Bajram Hysenit, Mexhit Prençit, Inajet Shehut etj. Botimi i gazetës "Ushtima e Maleve", ndonëse e kufizuar në botime letraro-artistike, nxori në pah emra të rinj në letërsi si Agron Tufa, Mevlud Buci, Mentor Hoxha, Garip Troci, Naim Berisha etj.

RISITË E PANAIRIT

Botimet e njëpasnjëshme të poetëve dhe shkrimtarëve dibranë jo vetëm pasuron bibliotekat tona, por dhe kritika letrare e mirëpriti dhe i vlerësoi si veprat e shkrimtarit Agron Tufa: "Aty te portat skee" – poezi, "Dueli" – roman, "Mërkuna e zezë" – roman etj.

Në panairin e Peshkopisë Agron Tufa do të prezantojë një botim të ri me esse.

Një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e autorëve dibranë zënë dhe botimet e Prof. Dr. Shaban Sinanit, ndër të cilët përmendim studimet monografike "Mitologji në eposin e kreshnikëve", "Hebrenjtë në Shqipëri: prania dhe shpëtimi", "Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës", apo botimet me studime për letërsinë si "Pengu i moskuptimit", "Një dosje për Kadarenë", "Përveçime", "Prurje kulturore orientale", "Për prozën e Kadaresë", "Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të", "Midis dy Rilindjesh", "Etnos ne Epos" , Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K.","Camaj i paskajuar", "Tradita gojore si etnotekst", "Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit", "Ndajfoljet përemërore në gjuhën shqipe", etj. Një pjesë e madhe të këtyre botimeve do të jenë në Panairin e Librit në Peshkopi, madje autori do të prezantojë personalisht për herë të parë në Peshkopi edhe librin e tij që ndodhet në shtyp "Kodikët kronografike të Shqipërisë - Shkrime dhe dorëshkrime prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen Kombëtare"

Në festën e librit në Peshkopi do të prezantohen edhe botime të tjera të autorëve dibrane dhe jo vetëm, që kanë në fokus Dibrën, kulturën dhe historinë e saj. Në stenda do të gjeni librin "Historia e Dibrës" e akademik Kristo Frashërit, botime nga Xhafer Martini: "Optika e Shmitit për Skënderbeun", romanin "Kanuni", monografinë "Gjenerali me shajak" kushtuar Elez Isufit si dhe dy botimet më të reja të tij, monografinë për Hilmi Kolgjegjën dhe "Tempullin e Dashurisë".

Gjithashtu, një vend të rëndësishëm do të gjejnë edhe romani i Ramiz Gjinit, me të cilin është vlerësuar si romani më i mirë në vitin 2011 "Bibollasit" si dhe vëllime me tregime të zgjedhura "Posta që sjell era".

Me një prurje të madhe në këtë panair vjen edhe poeti dhe shkrimtari Naim Berisha, i cili vetëm para pak ditësh botoi romanin "Zemërimi i malit të Shënmërisë", si dhe vëllimin me poezi "Sagë e kohës sonë". Naim Berisha nuk do të jetë fizikisht i pranishëm në panair, por atje do të ketë mbi 10 botime të ndryshme, për të gjitha moshat dhe me çmime të arsyeshme.

Disa nga autorët e tjerë janë Miradie Maliqi nga Dibra e Madhe, e cila vjen me disa romane: "Kthimi i trashëgimtarës së tradhtuar", "Një lot më shpejt se fjala", "Ditët e heshtjes" apo romani i fundit "Rebelimi i ndjenjave" etj. Po kështu poetja Gonxhe Letmi Begisholli vjen me vëllimin me poezi për të rritur "Pasioni i ëndrrave" dhe vëllimi me poezi për fëmijë "Lutjet e nënës". Edhe poetja dibrane Marjana Zeneli Bulku me librin me poezi "Zemra e thyer" dhe "Lutja e vetmisë" vjen para lexuesit dibranë e më gjerë me risi dhe vlera artistike në poezinë e saj. Nexhi Baushi pas dy librave me poezi "Kur loton qielli", "Autograf i pazbardhur" dhe "Poezi më solli pranë sytë e ty" vjen me novelën e parë "Pengu".

Pjesëmarrës në panair do të jenë edhe libra nga Eqrem Basha, Lutfi Hanku, Abdurrahim Ashiku, Iljaz Kaca, Moisi Murra, Skënder Cala, Gafur Zoto, Adem Buguri, Xhemal Domi, Petrit Ferhati, Elliot Moglica, Shpetim Cami, Ymer Keta, Arbër Cami, Ilmi Dervishi, Emrie Skuka, Zenel Sula, Zyber Gjoni, Haki Përnezha, Destan Rama, Sakip Cami, Xhelal Luca, etj.

Ndër pjesëmarrësit më të rinj në këtë panair janë edhe poetet e reja Urime Straka dhe Donika Paci. E para vjen me dy botime me poezi, "Qetësisht" dhe "Përtej ëndrrës", ndërsa e dyta me librin me poezi "Mjaft më tha loti im", si dhe Hamdi Skeja me librin "Ekstremume" etj.

Disa nga botimet interesante për panairin, thonë organizatorët, është edhe libri "Po Dibrës - Jo Skavicës", një përmbledhje publicistike me shkrime dhe komente që sjellin argumente kundër ndërtimit të hidrocentralit, një çështje aktuale. Gjithashtu do të kemi botime nga Velo Cfarku, "Golloborda në optikën time" dhe "Të parën kemi Dibrën".

Në këtë ditë të librit, një vend të rëndësishëm do të kenë edhe shkrimtarët dhe poetët që nuk jetojnë më. Naim Plaku vjen me disa botime, të cilat përshtaten shumë me Odën, "Krojet e zanave - folklor nga Viset e Dibrës" dhe "Po të mos ishte Drini, një vëllim me rrëfenja popullore të përpunuara.

"Ne po presime dhe pak ditë për të përgatitur materialin final për panairin, - thonë organizatorët, dhe shpresojmë se libra interesantë dhe të vlefshëm do të kemi edhe studiues e shkrimtarë të tjerë dibranë".

"Gjatë ditëve të Panairit në stendën e librit do të jenë të pranishëm shumë shkrimtare dhe poetë. Së shpejti do të bëjmë publike programin, por ia vlen të theksohet ceremonia zyrtare e çeljes më datë 24 dhe takimi i datës 25 tetor me tematikën "Shkrimtarët dhe vendlindja", ku në panel do të jenë tre personalitete të rëndësishëm dibranë, emrat e të cilëve do të jenë edhe surpriza e këtij panairi". Pasi të flasin për ndikimet e vendlindjes në krijimtarinë e tyre, një debat mes shkrimtarësh dhe lexuesish presim që të jetë shumë interesant", - thonë organizatorët e këtij panairi, pranë Shtëpisë Botuese "M&B".

Me këtë panair, shpresojmë që të marrë udhë tradita dhe vit pas viti, ta kthejmë Dibrën një qendër të kulturës dhe traditës popullore.

botime

Naim Berisha është një poet me ndërgjegje të lartë qytetare, që ua ka kushtuar krijimtarinë e vet problemeve më të rëndësishme të jetës së bashkëkombasve

Naim Berisha, poet i analizës dhe sintezës

Nga **HAMIT TAKA**

Nuk e di pse nga rinia e hershme më ka mbetur në mëndje filmi "Beteja për Romën", mbase nga romantika e moshës ose nga ndjeshmëria e momentit, por ishin edhe aq mbresëlënëse fjalët e vajzës së monarkut të Romës, dashuruar me pushtuesin e qytetit të saj të bukur, Totila: Këtu edhe zogjtë këndojnë: Totila, Totila, Totila!

Tani, duke lexuar poezitë e poetit Berisha, një mbiemër tingëllues, shumë i përhapur te shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë së Veriut (gazetarë, poetë, fotografë, këngëtarë, futbollistë, kryeministra etj,) më duket sikur nëpër vargjet e tij, në lirikat e zogjve përsëritet refreni: Berisha, Berisha, Berisha! Por edhe pse ky mbiemër më duket se ka diçka të përbashkët në toponimi dhe artikulim me mbiemrin Frashëri (Naim)! Kështu, unë përmblodha disa mendime modeste për krijimtarinë poetike dhe jo më gjerë të Naim Berishës. Në se ndonjëherë shkruaj Naim Frashëri, nuk është, thjesht, harresë. Pa dashur shprehet përqasja e pashmangshme në mjaft elemente arkitekturore të poetikës së tij të magjishme. Deri dhe në vargjet 16-rrokëshe, që u japin autorëve hapësirë gjithëpërfshirëse të natyrës e njeriut, fizikes e shpirtërores.

Diku, poeti kishte afishuar vargjet: Shkrimtarët janë si mirazhet/Zakonisht duhen nga larg/Afër janë të padurueshëm. Duke medituar mbi këta vargje sintezë, për një çast shtrova pyetjen: Mos vallë e pëlqej kaq shumë krijimtarinë e Naim Berishës nga që ai është larg? Edhe ku? Në Londrën frymëzuese! Jo. Mendoj se Berishën do ta doja më shumë nga afër, sepse duket edhe një mik i ëmbël, hokatar e mjaft komunikues, por mbi të gjitha poet i vetëdijes mitike e hyjnore. Megjithatë, nuk mund të mos mohoj se poetët s'kanë ca huqe e ca teka, aq sa, për ata që nuk i kuptojnë, mund të bëhen të bezdisshëm. Por, në fund të fundit, nuk kam aq forcë, imagjinatë, qoftë edhe jetë të përbashkët me poetët, për të dhënë një mendim të pranueshëm për shumicën e lexuesve. Prandaj them se ky status i Berishës ha diskutim dhe do të ftoja poetët, shumica shumë më të mençur se unë, të japin opinionet e tyre, në se janë vërtet "të padurueshëm" nga afër.

Poezia në një farë mënyre është sintezë. Prandaj konciziteti në një poezi të vetme, në një vëllim poetik, siç është rasti i vëllimit që po marrim në dorë "Sagë e vjedhur kohe" apo në gjithë krijimtarinë e një poeti, është shenjë pjekurie. Dhe aq më tepër meriton të admirohet ky koncizitet sot, kur, në masë të madhe, krijimtaria voluminoze poetike vuan nga proliksiteti, plagjiatura dhe mungesa e transparencës poetike, nga përkthimet e përshtatjet nga gjuhë të tjera. Është poeti Berisha që, gjithmonë, ka ditur e, aq më tepër, di të përcjellë mendimet dhe ndjenjat, duke i kursyer fjalët. Janë të shumta poezitë në librat e botuara të tij me pak vargje dhe që të mbeten në mëndje për forcën e mendimit dhe të ndjenjës.

Përfundova në një vend të largët
Si midis lamtumirës dhe absurdit
Si vdekja e kalit, vdekja e burrit. - nga libri "Shpirt i heshtur".

Në disa raste vjersha mbështetet mbi një figurë, në të tjera mbi një imtësi, apo në një tablo, që shprehin thelbin e idesë së saj.

Ç'motiv e shtyn ardhjen tënde
Imazhin tënd ç'e sjell s'e di
Sa shkon e vjen e del prej ëndrre
Prej shpirtit tim, mister, magji; - Nga libri "Le te vijnë vajzat".

Ndonëse Naim Berisha ka një prodhimtari të begatë, më shumë se 25 libra artistikë, ku përfshihen vëllime poetike, fabula, hajke, tregime dhe romane, me një larmi të admirueshme tematike, në të gjitha spikat një profil unik, i heroit lirik, i cili është po ai, si kur këndon himne për Atdheun, heronj, rilindas e deri te artistët, si: Vaçe Zela, Arif Vladi, Alqi Lepuri, por edhe kur shkruan këngë lirike drithëruese, siç është ajo "Aromë nëne".

Tematika e poetit Berisha është aq e pasur, sa nuk gjen cep të hapësirës apo universit fizik e shpirtëror të njeriut, pa e prekur. Ai këndon për Atdheun, për vendlindjen, për problemet shoqërore dhe politike, për drithërimat



dashurore të rinisë, për Tiranën e Londrën. Por vendin më të gjerë, ashtu siç e meriton, e zë motivi për femrën, të cilën poeti e shikon në dy dimensione, si krijesë e qelqtë e qiellit dhe, mbi të gjitha, si nënë, që është perëndia e tokës:

Mungesa juaj më ka robëruar
Kam ndjerë tronditje, mërzi e mall
Kur përbri, befas, më keni kaluar
Kam parë me sy mortin e gjallë;
(Kjo poezi më sjell në kujtesë këngën popullore të jugut:
Hanko mos shko nëpër varre/ Se të vdekurit i ngjalle/ Dhe të gjallët i vdiqe fare.)

Por ti ke lënë shumëçka në mua
S'më mbyt trishtimi, loti a prekja
Aromën tënde gjithë mollë e ftua
Nuk kish sesi ta merrte vdekja. – te libri "Pengu i nëndheshëm".

Një linjë mjaft e begatë dhe gjithëpërfshirëse në këtë vëllim dhe në tërësinë e krijimtarisë së poetit N. Berisha, është ajo e dashurisë, e cila shquhet për dlirësinë e thjeshtësinë e interpretimit, siç është vetë ajo. Fjalët e mëdha për dashurinë i përdorin vetëm ata që s'kanë dashuruar kurrë, kurse Berisha memorizon çastet më të ëmbla dashurore që në adoleshencën e tij:

Sill në mënd, moj shpirt, sill në mënd, e dashur
Kur të vija pas brigjeve të Drinit ...
Me sytë e skuqur dhe buzën e plasur
Me shpirtin që digjej, flakë, prej dashurimit…! - (Ekstazë pranverore). Më qartë, më bukur e më çiltër nuk kishte si të bëhej. Do të përmendja edhe hajket e fabulat e veçanta të Berishës, por sidomos sonetet e Shekspirit, të cilët ai i ka shqipëruar me një freski, qartësi e thjeshtësi të pazakontë, duke e çliruar Shekspirin nga ato nëntekstet filozofike dhe arkitektura e rëndë e shqipërimeve të tjera.

Por poeti Naim Berisha, gjuha e të cilit është Atdheu, nuk mund të mos ruante në kaleidoskopin shumëngjyrësh të kujtesës bukuritë e natyrës së mrekullueshme të krahinës se Dibrës, peizazhet e së cilës i ka pikturuar me fjalë në poezitë më të ndjera të shkruara nga dora e tij, sidomos ato për lumin legjendar të Drinit, i cili hyn edhe në gjumin,edhe në ëndrrat, edhe në dashuritë e tij. Të tilla janë: *"Peizazh me hënë"; "Lulet e mollës"; "Mall", etj.*

Poezia e Naim Berishës është e qetë, e ekuilibruar. Ky ekuilibër i brendshëm i poezisë së tij shprehet edhe në sintaksën e vargjeve, mbizotërimin e fjalive dëftore, gjë që u jep një forcë të veçantë pyetjeve dhe eksklamacioneve të rralla. Kjo bie ne sy me shume ne vjershat: pas 100 vitesh, s'e dua jetën, lirike dashurie, sonet, etj. Por ky ekuilibër nuk e ka çuar aspak poetin në ftohtësi dhe aq më pak në racionalizëm. Ky ekuilibër shpreh pikërisht thellësinë e mendimeve dhe të ndjenjës, thellësi që është armike e fjalëve të tepërta dhe efekteve të jashtme. Ajo që është më mbresëlënëse dhe që

Lexuesi është adhurues i poezisë së Berishës, mbi të gjitha se në tërë krijimtarinë e tij, në të ri dhe në pjekurinë e vet, poezia e Naimit është e gjendjes së gëzuar, e emocioneve pozitive dhe të hareshme të jetës. Ato kanë dritë, ngrohtësi dhe sinqeritet njerëzor...

e bën poetin sa origjinal aq edhe të freskët është se figurat e vjershave te tij janë sa te veçanta dhe origjinale, aq edhe spontane:

Shtëpia ime në sy të diellit
Hënë e gremisur mbi një kreshtë mali
Kurban i bashkimit;
"Hënë e gremisur", figurë që krijon krejt një tablo. –nga libri "Vjershe e ndaluar".

Naim Berisha shkruan në mënyrë të veçantë, me dashuri të veçantë, për atë çka ka më afër.

Ti kostumziu me kostumbardhën
Ti kravatkuqi qe i druhesh rrugës
Lot i pafaj kryqëzon plakën
Përtej lëkurës. – nga libri "Ç'm'i ra vrugu gjethit t'verës".

Krijuesit i duhet një farë kohe dhe një seri botimesh, për të krijuar një përfytyrim të plotë për individualitetin artistik të tij. Unë them se Naim Berisha e ka konsoliduar individualitetin dhe personalitetin e tij artistik. Bile një individualitet shumëplanësh: fillimisht publicist, (një fillim shumë i dobishëm për një shkrimtar), pastaj poet, prozator, veçojmë prozën poetike, të cilën e ka për shumë hosh, fabulist, tregimtar, hajkist dhe romancier, pa bërë fjalë këtu për të si kantautor. Mjaft tërheqëse janë edhe tregimet e shkurtra të tij si dhe fabulat e hajket, por unë jam ndalur vetëm tek poezia dhe, veçanërisht, tek ajo e këtij vëllimi, ku e dalloj më qartë shpirtin artistik në intimitetin e universit të bukurisë shpirtërore e verdiktit për vazhdimësinë e njerëzores.

Së pari, se Naim Berisha është një poet me ndërgjegje të lartë qytetare, që ua ka kushtuar krijimtarinë e vet problemeve më të rëndësishme të jetës së bashkëkombasve. Krijimtaria e tij, me gjithë pasurinë e madhe të brendisë dhe larminë e mënyrave dhe mjeteve artistike që përdoren për ta shprehur, mund të grupohen rreth disa vatrave ideore: krenaria kombëtare, dashuria për vendin dhe njerëzit, qëndresa në vështirësi, optimizmi për të ardhmen dhe, natyrisht, dhe malli i mërgimtarit. Por të gjitha këto linja i përshkon një fill i gjelbër, do ta quaja, lirizmi i freskët dhe i ëmbël, herë-herë, brilant. Heroi lirik i tërë krijimtarisë është qytetari me emrin Naim Berisha.

Kaher e gjelbra më ka mahnitun,
Në mal e kodër, fushë e korije,
Në vise t'blerta gjithkah shëtitun
M'u ngjit ajo në dritë të syve … - "E gjelbra".

Një ndihmesë për poetin ka qenë edhe përvoja e tij si gazetar. Vështrimi i tij poetik e realist kap edhe ato anë dhe tema të larmishme që burojnë nga mbresat dhe përshtypjet vetjake. Kështu poetika e tij rrok edhe probleme të mëdha të kohës që e preokupojnë, të cilat jo pak herë i trajton me frymë polemiste dhe ngjyrat e satirës. Përdorimi me masë dhe saktë i figurës dhe detajit, struktura e thjeshtë dhe kompozimi i qartë i poezive e bën poetin më të afërt me lexuesin.

Për një krijues të mirëfilltë nuk mund të anashkalojmë gjuhën e ligjërimit poetik dhe komunikimit me lexuesin e zakonshëm dhe atë elitar. Një poet i mirënjohur grek thotë: Atdheu është gjuha ime. E, kështu thotë poeti, që do të thotë se gjuha është rrënjë, nuk është strukturë, sigurisht kur gjendet në terrenin e saj fizik, të natyrshëm! Më të privilegjuarit e mundësisë për ta shprehur dhe përdorur "gjuhën", për t'u ngritur mbi "rrënjën", apo për t'u mbështetur mbi të, janë shkrimtarët. Por nuk numërohen me gishta ata poetë që nuk e përdorin, nuk gjenden mbi të, ndoshta edhe e kanë harruar! Ndoshta e kanë shkulur rrënjën. Një numër jo i pakët bien në folklorizëm, një pjesë tjetër rreken dhe rendin pas fjalës së kërkuar poetike, tendencë kjo drejt hermetizmit dhe vetizolimit. Gjë që nuk ndodh me poetin Naim Berisha, i cili shkruan pastër gjuhën e popullit, me gjuhën amtare dhe atë letrare. Një farë gërshetimi dialektor, i jep më shumë kolorit gjuhësor krijimtarisë së tij dhe e bën më të pëlqyeshme.

Dhe fryma jote s'është veçse një hije
Një hije mëngjesi në bojën e vraçit të zi
Hijet më të trishta, të tuat kujtime
Dhe vjershat pikëlluese që unë thur për ty. - "Pikëllimi i vjershës".

Por lexuesi është adhurues i poezisë së Berishës, mbi të gjitha se në tërë krijimtarinë e tij, në të ri dhe në pjekurinë e vet, poezia e Naimit është e gjendjes së gëzuar, e emocioneve pozitive dhe të hareshme të jetës. Ato kanë dritë, ngrohtësi dhe sinqeritet njerëzor. Madje mund të them se poezia e tij mbetet gjithmonë rinore. Sa ura të padukshme hedh poeti Naim Berisha me lexuesin e shumtë nga të gjitha trevat ku flitet e këndohet shqip. S'të mbetet tjetër, veçse t'i urosh krijimtari të begatë në një jetë sa më të gjatë!



Botim i ri

Naim Berisha
ZËRI I MALIT TË SHËNMËRISË

Roman
ISBN: 978-9928-172-37-2
Çmimi: 500 lekë

Botimet e Shtëpisë Botuese M&B, mund t'i gjeni pranë librarisë në Rrugën e Dibrës, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.

Rreth librit poetik
"Dashuria është kudo")


recensë

Kujtim Boriçi, poeti që ka lajtmotiv dashurinë njerëzore

Nga **MEVLUD BUCI**

Ethem që në krye të herës se të analizosh krijimtarinë e shkrimtarit, publicistit e poetit Kujtim Boriçi të duket se je në një galeri të thellë me plot minerale të çmuara. Pa as më të voglën hiperbolë, por me syrin real të studiuesit, dashamirësinë dh epërfaljen para punës së përkushtuar e mjaft të çmuar të z. Boriçi e them me lindje se krijimtaria e tij është një thesar i vyer, një relikt e ndritur, mbi të gjitha një vlerë e shtuar për brezat tanë. Duke njohur krijimtarinë e kahershme e gjurmëlënëse, prozën e publicistikën mjeshtërore si krijimtarinë e larmishme poetike vërejme qartazi e në mënyrë lindëse se Kujtim Boriçi është krijues i mesazheve të cilat pasqyrojnë jetën, dashurinë, vlerat njerëzore, traditat qëndresën, vendlindjen, kohën, kombin, gjurmët e ndritura të brezave. Penda prej gazetari të palodhur, nderimi për njerëzit, traditat, shokët, respekti për vendlindjen e kombin, shëmbëllimi prej njeriu e intelektuali misionarë e vizionarë kanë bërë që z. Boriçi të pasqyrojë vlera të çmuara për lexuesit, për kohën dh brezat. Nëse do të analizonim prozën "Ata erdhën nga Stebleva" (publicistikë mjeshtërore, nga blloku i gazetarit (320 faqe), midis të tjerash shpërfaqet jeta, tradita, dituria, ... e Steblevës, mësuesi veteran Medi Lila i Sebishtit, festivali i flokut gollobordas, Klenjë maj 1977, tri vizita në vendlindje dhe "Kali i Trojës", 26 hebrenj, dy vjet mysafirë tek Biçakajt e Qarrishtes, me Raimondën, gazetaren "terroriste"... Një udhëtim me Skënderbeun drejt Prishtinës, Në Turqi dy javë në festën e Folkut Botërore... Në Shkup ku folku i fëmijëve zbut klimën e ashpër ballkanike e plot të tjera. Prozë e publicistikë kroniste e jetës, pasqyrë e dritës së shpirtit njerëzor, e vlerave të çmuara, dëshmi e shpirtbardhësisë së njerëzve të thjeshtë.

Inxhinieri e studiuesi i talentuar Eduard Abazi në analizën që bën me të drejtë midis të tjerash shkruan: ... Në botimin "Ata erdhën nga Stebleva, mendoj se gjithkush, duke shfletuar faqet e tij, do të konsistojë j ovetëm përgjegjësinë në të shkruar nga autori, por edhe drama, ngjarje e fenomene që lidhen me Gollobordën e shtresa të shoqërisë shqiptare, që ose nuk i ka njohur deri tani, ose nuk i ka "prekur", ndonëse mund të përballet me to vazhdimisht në çdo hap të jetës"... (Ata erdhën nga Stebleva", f. 7). Publicistika e Kujtim Boriçit u ngjan gurgullimave të Gollobordës, mjeshtrisë së ndërtuesve të rrallë të kësaj treve fisnike e bujare, i ngjan Raduçit shekullor, kjo është pasqyrim i traditave, fisnikërisë, heroizmit, gjurmëve të djersës e të diturisë. Para se të flasim sado pak për poezinë e z. Boriçi ma thotë zemra të citoj atë çka autori shkruan në hyrje të librit "Dy martirët e Steblevës": "Këtë libër ua kushtoj martirëve Xhemile e Rabije Abazi, si dhe të gjitha grave e vajzave të zonës, që luftuan me heroizëm dhe u vranë me armë e bajoneta nga pushtuesit serbë në mësymjet dh masakrat e tyre në Gollobordë e treva të tjera shqiptare në vitet 1912-1920" (Faqe 3 "Dy martirët e Steblevës"). Dëshmitë, përshkrimet, mbresat, ngjarjet, faktet, refleksionet, virtytet njerëzore, episodet interesante, detajet jetësore, mesazhet nga Golloborda e luftës dh ee punës, pasqyrimi i njerëzve dhe vlerave nga trevat e ndryshme të atdheut e në vende ku banojnë shqiptarë tregojnë se autori Kujtim Boriçi është një bahçevan i kujdesshëm, i palodhur dhe korrekt në pasqyrimin e vlerave njerëzore, dritës së jetës e të shpirtit, një publicist, shkrimtar e poet që punët e bukura e gjurmëlënëse të tij nisin nga udhët e brezave të vendlindjes, nga udhët e atdheut e përjetojnë atë çka kërkojnë koha dhe fisnikëria e gjurmët e jetës njerëzore në realitetin bashkëkohor.



Lirizmi, detajet e holla jetësore, ndjenjat e pastra nderimi njerëzor, monologu meditues, filozofik, malli e frymëzimi poetik, dashuria e zjarrtë, përdorimi me vend i figurave stilistike e bëjnë vargun dh epoezin ëe Kujtim Boriçit tërheqëse, frymëzuese, të thellë me plot ide e mesazhe, me plot ngarkesë idevemosionale, një udhërrëfyes të çmuar për të kërkuar e për të jetuar me dashurinë gjë e cila sjell lumturinë njerëzore...

***

Po mbushen gati 40 vjet qëkurse libri "Këngët tona" i poetit të talentuar Kujtim Boriçi përzgjidhet mes tre vëllimeve të krijimeve të rinj në shkallë vendi dhe diskutohet paa botimit në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Duke rilexuar librin tjetër poetik "Dashuria është kudo" sigurisht që ndjeva detyrim shpirtëror të shkruaj sado pak për këtë pasuri tepër të çmuar, e cila njom zemrat, dritëson shpirtrat dhe e bën lexuesin të meditojë, të frymëzohet dhe të jetojë me kohën, jetën, atdheun me flladet e lirisë e të dashurisë, me dritën e virtyteve me krenarinë legjitime e përmallimin, me gjurmët e jetës, brezave e të kohës, të cilat na i përcjell në vargjet mjeshtërore poeti gollobordas e mbarëkombëtar z. Kujtim Boriçi.

"Në morinë e librave me poezi të botuara me shumicë gjatë këtyre viteve, - shkruan inxhinieri e studiuesi Eduard Abazi – mendoj se "Dashuria është kudo" i Kujtim Boriçit është ndër më të veçantat, ndër më të arrirat artistikisht..." (f. 5).

Libri pas nëntitullit "Vegim" fillon me poezinë "Dashuria është kudo" që përbën kryemesazhin njerëzor për të patur vetëm dashuri, seps ekështu ndritet jeta, lumturohen njerëzit.

Pra, poeti Boriçi ka një konceptim të gjerë filozofik për dashurinë, me të drejtë e kërkon me shpirt, bën thirrje që ajo të jetë kudo. Tetë vargje që kanë vlerën e rrallë të një libri të tërë, të një gurgullimë me plot fllade të cilat kërkojnë që njeriu ta kërkojë dashurinë:

Nga çasti i lindjes, në koshiencën e parë,
Me etje, dhimbje, dashurinë e kërkojmë
Rrimë me të ngopemi, uri prapë kemi
E të pangopur nga kjo botë shkojmë...

Por diçka secili nga ne mund të bëjë
Plaku, i riu në qyet pyll e ngado...
Të nxitojmë nga strofilla të nxjerrim
Dashurinë, për ta patur kudo...
(Poezi "Dashuria është kudo", f. 7).

Lirizmi, detajet e holla jetësore, ndjenjat e pastra nderimi njerëzor, monologu meditues, filozofik, malli e frymëzimi poetik, dashuria e zjarrtë, përdorimi me vend i figurave stilistike e bëjnë vargun dh epoezin ëe Kujtim Boriçit tërheqëse, frymëzuese, të thellë me plot ide e mesazhe, me plot ngarkesë idevemosionale, një udhërrëfyes të çmuar për të kërkuar e për të jetuar me dashurinë gjë e cila sjell lumturinë njerëzore. Janë të realizuara mjaft mirë artistikisht secila poezi e librit, veçanërisht "Ashtu si dikur, më erdhi në gjumë", "Fqinjës", "Tek gurra e bjeshkës" (lirikë dashurie), "Betimi", "Të dua", "Dashurisë", "Shiu", "Nën detin e yjeve", "Gruas", "Mbeti vegim", "Dehje", "Trishtim", "Etyd", et plot të tjera. Poeti Boriçi e shikon jetën me sytë e mendjes, me sytë e dritës së shpirtit. Mishërimin e fjalës e kërkon tek rrënjët e dashurisë së vërtetë, tek praktika në mirësinë dh edashurinë, godet në shenjë kundër formalizmit dhe falsitetit bosh në dashuri:

Vije shpesh tek unë, mbarojë punë, ikje
Gjithmonë betoheshe "Veç ty unë të dua"
Por kjo vakancë, nuk mund të ish e gjatë
Se kur nuk doje veten, si do më doje mua?!
(Poezia "Mbeti vegim", f.20).

Poeti Kujtim Boriçi në vargjet e tij zbulon rrënjët e dashurisë, vlerat e virtytit përshkruan poetikisht duke pasqyruar dritën e shpirtit, bukurinë e jetës e të dashurisë. Vargjet vërtet vrullojnë dashuri, kanë fllade frymëzimi, ndjenjë çiltërsie, dallgë malli. Poeti Boriçi sikur kërkon me pasionin e inxhinierit të mineraleve të çmuara kërkon gjënë më të çmuar për jetën, për njerëzit, për brezat, që është dashuria njerëzore:

... Shpatet e malit një erë i çan
Një etyd pranvere buzëmbrëmja sjell
Nxitojnë vajzat se ika dhe një ditë
Zjarri i dashurisë nga shtëpia i nxjerr.
(Strofa e parë e poezisë "Etyd", f. 28).

Me të drejtë lexuesi apo studiuesi pasi të rilexojë poezitë e librit "Dashuria është kudo" do ta quajë Kujtim Boriçin bahçevanin e vargjeve të dashurisë një mjeshtër të poeziazhit poetik, një mjeshtër të lirikave shpritërore, një këngëtar që ndez mesazhe të zjarrta dashurie, ku edh etek loti zbulon gëzime të mëdha:

Pika e lotit, nuk ka ngjyrë
As shije pika e lotit s'ka
Se lotët janë dhimbje e zemrës
Dhe produkt i gëzimeve të mëdha...
(Poezia "Loti", f. 33).

Mjaft bukur poeti Boriiç ka realizuar edhe dy kapitujt e tjerë "Dritare në vite" dhe "Zëra në kohë". Autori e gdhend në vargje legjendën e "Shpellës së Pëllumbave" që ndodhet diku mes fshatrave Steblevë dhe Borovë në Gollobordë. Vargjet japin në mënyrë sintetizuese, artistike e frymëzuese dhimbjen, legjendën:

... Ndërsa dielli humbi tutje majës së malit
Një zemër e re dridhej majë kalit...

Pas dekadash arkeologët nga thellësitë e shpellës

Nxorrën stolitë e nuses dhe fillin legjendës...
(Poezia "Në gjurmët e një legjende", strofa e fundit, f. 37).

Poezitë: "Lirikë", "Momenti i një kurbetçiu", "Ligësi", "Si lindi një këngë", "23 vjetorin e martesës", "Çast dimri", "Guri i bareshës" (motiv popullor), "Mbrëmje detare", "Dasma e aviatorit", "Kujtesë vitesh", "Çast marshimi", "Shqetësimi i nënës në dasmën e fqinjës" e plot të tjera vrullojnë dashuri njerëzore, sikur na bëjnë të udhëtojmë për njerëzoren të thjeshtën, të mirën, të cilat duhet të jenë geni i çdo zemre e shpirti njerëzor. Në pjesën "Zëra në kohë" në mjaft poezi poeti Boriçi edhe kur godet përcjell dashuri. Autori jeton me kohën tregohet "sitë" e hollë e saj. Pra, u prin me dritën emendjes shpirtrave për t'i dritësuar. Që nga poezia "Koha", "Ndjesë dallëndysheve", "Servilin", "Meri", "Masakra e Prodanit", "Këshillë servilo-spiunnit", "E vërteta", "Vrasja e sorkadhes", "Jam Europë", "Akropoli", "Qemal Stafës" e të tjera z. Boriçi pasqyron jetën, dukuritë, përcjell mesazhe me vlerë për sot dhe nesër. Pa mëdyshje e themi se krijimtaria e birit të Gollobordës Kujtim Boriçi ka plot lajtmotive dashurie është dhe mbetet një vlerë e çmuar dhe e shtuar për brezat.

Urime Kujtim Boriçi!

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

botim i ri

Vështrim historiko-gjeografiko-linguistik

Gurabardha e Dibrës dhe Maqedonia

Nga **AGIM ÇADRI**

Arsyet që më nxitën të shkruar këtë libër janë: botimi para ca vitesh i Enciklopedisë së Maqedonisë nga shovinistët sllavë të Shkupit dhe pretendimet e tyre të vazhdueshme ndaj krahinës shqiptare të Gurabardhës, që ardhësit sllavë të shekujve VI-VII të erës sonë në trojet e stërlashta iliro-arbërore e konsiderojnë si tokë të tyre, ndërsa popullsinë shqiptare të së ashtuquajturës Republikë e "Maqedonisë", që është "pronarja" e vërtetë, të paktën në gjysmën perëndimore të kësaj Republike, i konsiderojnë si të huaj apo si "pushtues" të tokave "sllave"?!

E vërteta është krejt ndryshe nga pretendimet e shovinistëve sllavë të Shkupit; mbasi sllavët e kësaj Republike kurrsesi nuk mund të quhen si pasardhës të maqedonëve të lashtë, të kohës së Aleksandrit të Madh të Maqedonisë, siç pretendojnë shovinistët e sotëm sllavë të kësaj Republike. Historia tregon se maqedonët e kohës së Aleksandrit i ndan një epokë rreth njëmijë vjeçare nga ardhësit e parë sllavë në gadishullin Iliro-Thrak (sot "Ballkani", d.m.th. se në kohën e Aleksandrit në këtë gadishull nuk kishte shkelur këmba e sllavit dhe as ishte dëgjuar gjuha e tyre. siç e thashë edhe më sipër, para shekullit të VI-VII të erës sonë në territoret e Ballkanit, ku jetojnë sot sllavët, zotur ishin Iliro-Thrakët, të cilët ishin edhe emërdhënësit e parë, në gjuhën e të cilëve u emërtuan malet dhe lumenjtë e këtyre trojeve. Ilirët në pjesën perëndimore, kurse Thrakët në pjesën lindore të gadishullit të sotëm të Ballkanit.


(Në poemën "Iliada" të Homerit tregohet se Thrakët e lashtë poetin dhe këngëtarin e tyre më të madh e quanin "Thamir", që në shqip mund të përkthehet si "Tha-mirë", d.m.th "ai që thotë flet mirë, apo që këndon mirë/ bukur", siç ndodh me të vërtetë me poetët dh ekëngëtarët). Ata që e populluan të parët territorin e Republikës së sotme të "Maqedonisë", d.m.th. Iliro-Thrakët, lumin më të madh që përshkon territorin e kësaj republike, e quajtën "Bardhar" (shqip: lumi i bardhë), që në greqisht u bë "Vardar", mbasi në këtë gjuhë është i zakonshëm këmbimi B-V, ndërsa tingulli "Dh" në greqisht nuk ekziston.

Këtë mendim e mbështet edhe fakti që degën më të madhe të lumit Vardar, që kalon pranë qytetit të sotëm të Manastirit, sllavët e Maqedonisë e quajnë "Cërna" (lumi i zi), por në hartat e vjetra ai emërtohet si "Erigon" (lumi i zi, nga mbiemri shqip "i errët". Pra, sllavët e Republikës së "Maqedonisë" e përkthyen në gjuhën e tyre emrin iliro-arbëror të kësaj dege të Vardarit (Bardharit) sikurse Gurabardhën iliro-arbërore e shndërruar në "Gollobordë".

Kjo mënyrë emërtimi e lumenjve gjendet edhe sot ndër shqiptarët, siç kemi Drini i Bardhë dhe Drini i Zi, apo Lumbardhë dhe Lumzi (dy degë të lumit Fan).

Në emërtimet sipas ngjyrës hyjnë edhe emrat e krahinave "çermenikë", që në sllavisht do të thotë "vendi i gurëve të kuq". Ky emërtim është një përkthim në sllavisht i emrit iliro-arbëror "Gurakuq", emër që mban sot një fshat i madh në rrethin e Librazhdit, në kufi me Gurabardhën. Ata që kanë udhëtuar në rrugën automobilistike që lidh Librazhdin me Gurabardhën, duhet të kenë vënë re ngjyrën e kuqerremtë të tokës së rrethinave të Librazhdit, e cila e ka prejardhjen nga shpëlarja miliona vjeçare e shtresave të mineralit të hekurit, që ka një ngjyrë të kuqerremtë. Kjo gjë vihet re edh enë dy emërtime vendesh në rrethin e Pogradecit. Pasi kalon Qafë-Thanën (në drejtim të Pogradecit), duket fshati i Çervenakës (nga sllavishtja "cervenij" – "i kuq", pasi edhe aty gjenden shtresa të kuqe të mineralit të hekurit. Pranë qytetit të Pogradecit ndodhet vendi i quajtur "Guri i Kuq", ku gjithashtu gjenden shtresa të mineralit të kuq të hekurit.

Sapo rruga e makinës kapërcen fshatin e madh Gurakuq të rrethit të Librazhdit (kur udhëton në drejtim të Dibrës), hyjmë në krahinë e Gurabardhës. Në këtë krahinë, ndryshe nga Gurakuqi (Çermenika), toka, në vendet e zhveshura (mbasi Gurabardha është një zonë pyjesh, siç janë pyjet e rajonit të Steblevës, ku kanë qenë Sharrat e Steblevës etj), shfaqen kudo shkëmbinjtë e bardhë gëlqerorë. Për këtë arsye, iliro-arbërorët këtë krahinë e kanë emërtuar "Gurabardhë", që pushtuesit sllavë e shndërruan në "Gollobordë" (malësi e



Unë pajtohem me mendimin e shprehur nga Prof. Dhimitër Shuteriqi" se gjuhën sllave në Gurabardhë e kanë përhapur gratë dhe vajzat bullgare të Sfetigradit që ndodhet pranë (një koloni bullgarësh në tokën arbërore), të cilat kalonin në anën tjetër të Drinit të Zi në kohën kur aviteshin aty ushtritë turke për të rrethuar këtë kështjellë, ku mungonte madje edhe uji i pijshëm...

zhveshur), që nuk pajtohet me realitetin.

Në librin tim lexuesi do të gjejë shembuj të shumtë që dëshmojnë se si sllavët kanë bërë ndryshimin e emërtimeve iliro-arbërore: ose i përkthyen ato, si në rastin Gollobordë-Gurabardë (fenomen që linguistët e emërtojnë si "lojë fjalësh").

Një shembull tjetër i përshtatjes fonetikore (ku ndryshohet kuptimi fillestar i emërtimit), e gjejmë edhe në emrat e dy fshatrave të Gurabardhës; Ostreni i Madh dhe Ostreni i Vogël. Në sllavisht këto dy emërtime kanë, përkatësisht, kuptimet "majëmali e madhe" dh e"majëmali e vogël". Udhëtari që kalon pranë këtyre dy fshatrave mund të shohë një mospërputhje të emërtimeve sllave me realitetin. Por ai mund të vërejë se pranë tyre kalojnë dy lumenj, degë të Drinit të Zi, si dhe praninë e burimeve të ujit. Ky fakt na bën të mendojmë se emërtimi "Ostren", është një lojë fjalësh e pushtuesve dhe emigrantëve sllavë, të cilët emrin e parë, që i ka rrënjët në gjuhën pellazgo-ilire, "Istren", nga rrënja pellazge "is"-"ujë", që sipas linguistëve është një trajtë e rrënjës "id-"ujë" (krahaso me fjalën "hidro"-"ujë").

Në gjuhën shqipe sot kemi emërtimin "Drin" i dy lumenjve (Drini i Bardhë dhe Drini i Zi), formë e tkurrur e emërtimit "Idrin", nga rrënja "id"-"ujë". Po kështu, emri i lumit "Vjosë" duhet parë si një trajtë e tkurrur e emërtimit "Ujosë". (Këtë fenomen gjuhësor linguistikët e emërtojnë si "humbje të fillestares" d.m.th. humbje e tingullit/ shkronjës në fillim të fjalës).

Një studiues shqiptar (I.M.) emrin e detit Jon e përkthen si "deti jon/ynë" si kundërvënie ndaj emrit të detit Tiren (në perëndim të Italisë), që sipas tij do të thotë "deti i tyre".

Unë nuk pajtohem me këto shpjegime. Sipas mendimit tim, deti Jon është një trajtë e tkurrur e emrit "Ujosë", ndërsa emri i detit Adriatik është një trajtë e tkurrur e emrit "Ujosë", ndërsa emri i detit Adriatik është një shprishje e emrit deti "Idriatik" (nga rrënja pellazge "id"-ujë", të cilën e gjejmë edhe në emrin e malit Ida-strehë e Zeusit (perëndi e bubullimës dhe i shiut, bir i Reas, e cila nuk është tjetër veçse perëndeshë e reve të shiut. Emri i Reas dhe ai i Idës për disa linguistë janë "të pakuptueshëm".

në poemën "Iliada", me përjashtim të dy këngëve të para, ky mal i Trojanëve emërtohet gjithmonë si "Ida burmshumë", gjë që mbështet mendimin tim se emri Ida lidhet me fjalën shqipe "ujida" – "vend i ujërave".

Në grupin e emërtimeve që lidhen me ujin, mendoj se hyn edhe emri i qytetit Janinë (nga Ujaninë), pasi ky qytet ndodhet pranë një liqeni të madh. Mirëpo, një studiues shqiptar (Z.M.) emrin Janinë e lidh me emrin e gjellës jani? (Ky është një absurditet i madh, që ia kalon ati jtë një studiuesi që emrin "Maqedoni" e shpjegon si vendi "me qe, dhen e dhi").

Në përfundim të këtyre shpjegimeve për etimologjinë e emërtimeve sllavë në Shqipëri dëshiroj t'i përgjigjem edhe vërejtjes që mund të bëjë dikush se "përderisa në Shqipëri ka emërtime sllave, aty ka patur edhe sllavë". Kësaj vërejtje më parë i jam përgjigjur se këto emërtime sllave i kanë vendosur administratat e pushtuesve sllavë. Sipas mendimit tim kjo është një mundësi reale, por nuk përjashtohet edhe mundësia e ardhjes të kolonëve sllavë në Shqipëri. Një shembull në këtë drejtim paraqet edhe krahina e Gurabardhës, ku megjithëse flitet gjuha sllave, burrat mbajnë kostumin shqiptar, ku bie në sy veçanërisht mbajtja masive e qeleshes së bardhë, ndërsa gratë nëpër dasma këndojnë në sllavisht këngën "Rosa rosit vlar banoshka zemja" (vesa po veson në tokën arbërore), pra ato pohojnë se jetojnë në Arbëri. Unë pajtohem me mendimin e shprehur nga Prof. Dhimitër Shuteriqi" se gjuhën sllave në Gurabardhë e kanë përhapur gratë dhe vajzat bullgare të Sfetigradit që ndodhet pranë (një koloni bullgarësh në tokën arbërore), të cilat kalonin në anën tjetër të Drinit të Zi në kohën kur aviteshin aty ushtritë turke për të rrethuar këtë kështjellë, kiu mungonte madje edhe uji i pijshëm, siç na tregon Marin Barleti. Të tilla situata mund të kenë ekzistuar edhe në periudhën paraturke. Vajzat sllave martoheshin me djemtë iliro-arbërore. Fëmijëve që lindnin nga këto masa, nëna u mësonte gjuhën e saj "bullgare", siç e emërtojnë gjuhën e tyre sllavofolësit e disa fshatrave të Gurabardhës që ndodhen përballë Sfetifradit...

Shpërngulje të tilla popullsish kanë ndodhur edhe para epokës turke, çka vërtetohet nga prania e Valakëve (Vllehëve) në Shqipëri. Studiuesit thonë se ngulimet valake në Shqipëri i gjejmë në vendbanimet ilire përgjatë rrugës Egnatia. Disa studiues janë të mendimit se këto ngulime e kanë origjinën nga ushtarët romakë që ruanin këtë rrugë, ndërsa disa të tjerë i konsiderojnë si ngulime Thrako-Dakesh të romanizuar, sikurse janë edhe rumunët e sotëm, që kryeqytetin e tyre e quajnë Bukuresht (krahaso me fjalën "bukurështë" të gjuhës shqipe. Edhe ky shembull mund të merret si një dëshmi se Thrako-Dakët e lashtë, që poetin dhe këngëtarin e tyre më të madh e quanin Thamir (Tha-mirë), flisnin një gjuhë të ngjashme me gjuhë iliro-shqipe.

Unë pajtohem me kërkesën e sotme të Greqisë se emërtimi "Republika e Maqedonisë" duhet ndryshuar, mbasi pozicioni gjeografik i kësaj republike nuk pajtohet me të vërtetën historike. Maqedonia e lashtë thuhet se si qendër ka patur rrethinën e sotme të qytetit të Selanikut, ku ndodhej edhe kryeqyteti i Maqedonisë së lashtë, qyteti Pella.

Sipas studiuesve emri fillestar i Maqedonisë ka qenë "Emathia/Emetia (krahaso me emrin e lumit dhe të krahinës së sotme të Shqipërisë-Mati). Është shprehur mendimi se zgjidhja më e mirë e problemit të "Republikës së Maqedonisë" do të ishte zhdukja e kësaj republike artificiale nga harta politike e Ballkanit, duke ia bashkuar gjysmën perëndimore të saj Republikës së Shqipërisë, ndërsa gjysmën lindore Republikës së Bullgarisë, mbasi sllavët e "Maqedonisë" së sotme nuk janë gjë tjetër veçse Bullgarë" (Vollgarë, d.m.th. sllavë të rajoneve të lumit Vollga të Rusisë). Në të vërtetë kjo do të ishte zgjidhja më e mirë e problemit të sotëm politik që lidhet me konfliktin greko-"maqedon".

Së fundi, unë pajtohem plotësisht me mendimin e shprehur nga ish-presidenti Bamir Topi gjatë një vizite në rajonin e Prespës, i cili porositi banorët sllavishtfolës të asaj krahine që t'i zhduknin toponimet sllave, duke i zëvendësuar ato me emërtime që na i kanë bërë "dhuratë" ardhësit sllavë, sot shfrytëzohen nga pasardhësit e tyre shovinistë të Shkupit si "gozhda të Nastradinit", ku ata varin pretendimet e tyre territoriale ndaj Gurabardhës iliro-arbërore etj. Këto "gozhda", në të vërtetë shfrytëzohen për t'iu kundërvënë kërkesave të drejta të popullsisë shqiptare të pellazgo-iliro-arbërore. Emërtime të tilla, si Gora e Kukësit, si Golloborda e Dibrës, si Çermenika e Librazhdit, si Çorovoda e Skraparit etj., duhet të zëvendësohen me emërtimet e tyr origjinale iliro-shqiptare, përkatësisht, me Malësia (ndoshta këtë kuptim ka edhe emri i republikës të Malit të Zi, që në sllavisht emërtohet si Cërna Gora), Gurabardha, Gurakuqi, Lumi i Zi.



Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund t'i gjeni në:

http://saveriverradika.com

100 vjetori i Shkollës Shqipe
Peshkopi

Natasha Ashiku mësuese edhe në mërgim

Shënime me një urim nga larg

Natasha Ashiku (Shehu) mbaroi shkollën me zë të madh në përgatitjen e mësuesve, Shkollën Pedagogjike Peshkopi, në qershor të vitit 1966

Pas dy vjetëve punë si mësuese në shkollën 8-vjeçare të qytetit të Krujës ku kishte familjen, martesa e ktheu në vendin ku kishte lindur më 15 qershor 1948, në Peshkopi.

Një shtatori i vitit 1968 ishte dita e parë si mësuese në shkollën tetëvjeçare "DemirGashi", ditë që do të përsëritej për 28 vjet, deri në shtatorin e vitit 1996.Një vit më vonë shtatori do ta gjente në vend të huaj, larg vendlindjes dhe venddashurisë së saj të madhe për mësuesinë, larg nxënësve të saj...

E kam jetuar atë ditë kur një pikë loti rrodhi nga liqeni i shpirtit të saj të mbushur me mall e dashuri. E kam jetuar edhe gëzimin e saj kur herë pas here takonte Silva Mehmetin, nxënësen e saj të bukur, kur uleshin e kuvendonin, herë në shtëpinë e njërës e herë në shtëpinë e tjetrës, për ditët e bukura në vendlindje.

E kam ndjerë në rrugë kur zëra të malluar i thërrisnin nga larg "Mësuese...".

E kam përshkruar në një reportazh një çast kur duke mbajtur njeri tjetrin zbrisnim sokakëve të bardhë, tepër të pjerrët të ishullin Santorini, kur dikush i doli përballë dhe i thirri i qeshur "Ti je mësuese Natasha?" Ishte thirrja e gëzuar e Besnik Kokës nga Kraj Reçi, nxënësi që kishte kaluar para syve të saj në praktikën mësimore në "Shkollën Ushtrimore të Pedagogjikes së Peshkopisë" ku Natasha Ashiku ishte mësuese jo vetëm e nxënësve të vegjël por edhe e nxënësve të rritur, atyre që pak më vonë do të merrnin në dorë mësimin e fëmijëve në zonat më të thella të vendit. Pimë një kafe me të dhe, në atë pamje të papërsëritshme, shtypa butonin e fotoaparatit...

Dy ditarë , në dy blloqe, janë pjesë e relikteve nga dy vitet e fundit në shkollën tetëvjeçare "DemirGashi", pjesë e bibliotekës familjare në mërgim. I ruan me dashuri e xhelozi ashtu siç ruan shumë fotografi me nxënësit e saj në vite dhe me shoqet e saj mësuese.

Nostalgjia për vitet e bukura mësuese në Peshkopi shpejt do shndërrohej në një punë të vërtetë, punë vullnetare si Rilindësit e kohëve kur Gjuha Shqipe ishte hedhë në zjarrin ndezur nga pushtuesi osman e kishte mbetur në hirin e zi.

Një ditë, tek udhëtonim nga një lagje e Athinës ku banonte vajza jonë Erblina qëlloi që rrugën ta bëjmë me një taksist arvanitas. Folëm me të në shqipen tonë, në shqipen e tij përcjellë në njëqind breza...

Kur u ndamë ai na tha:

"Na jeshëmskipëtarë një qind për qind, po greku na thithi. Nuk na la të vazhdonim skolinë dhe nuk mundëm me mësue dhe me shkrue-gluhëntënë. Edhe juve kështu do t'ju ndodhë. Fëmijët tuej nuk e mësojnë gluhën e mëmës, nuk kanë disirë të këthenenë në Skipëri, do bënenëgrekër si na..."

("Një arvanitas taksixhi" A. Ashiku "Rilindësit e kohës sonë" f.198-200)

Në Greqi numri i fëmijëve shqiptarë në shkollat greke, fëmijë që shkruanin, lexonin, madje edhe mendonin greqisht i kalonte të njëqindmijtët. Duhej sensibilizuar opinioni, duhej që ata të flisnin shqip, duhet të shkruanin e lexonin shqip që të mos ndodhte që... ***Fëmijët tuej nuk e mësojnë gluhën e mëmës, nuk kanë disirë të këthenenë në Skipëri, do bënenëgrekër si na..."***

Vetë e pesta mësuese Natasha bëhet nismëtare e mësimit të gjuhës shqipe në mërgimin e vështirë grek, vendi ku fjala shqipe vazhdonte të shkrihej në prushin e zjarrit mesjetar..

Më 7 mars 1998 firma e mësuese Natashës do të përjetohej në dokumentin : ***"Të mësojmë të shkruajmë e lexojmë gjuhën e nënës",*** nënjë letër drejtuar Presidentit dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Letra fillonte..."***Sot, më 7 Mars 1998, këtu, në Athinë, në kuadrin e përvjetorit të shkollës së parë shqipe, një grup arsimtarësh me përvojë të gjatë në arsim, njerëz të dashuruar pas profesionit të mësuesit, emigrantë me banim në Athinë, formuam GRUPIN NISMËTAR TË MËSUESVE për tu mësuar fëmijëve të emigrantëve***




Dita e pare

të shkruajnë e lexojnë në gjuhën e bukur shqipe, në gjuhën e nënës"...

...Dhe mbaronte...

"Ne besojmë se Kryeministri dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, të cilët kanë qenë vetë pedagogë, do të ndihmojnë për këtë dhe do të përdorin autoritetin e tyre që fëmijët e emigrantëve të mësojnë gjuhën shqipe dhe të integrohen në jetën shqiptare si të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre."


Ne besojme se Kryeministri dhe Presidenti i Republikes se Shqiperise,ta cilet kane qene vete pedagoge,do te ndihmojne per kete dhe do te perdorin autoritetin e tyre qe femijet e emigrantevе ta mesojne gjuhen shqipe dhe te integrohen ne jeten shqiptare si te barabarte me bashkemoshataret e tyre.

GRUPI NISMETAR

JOVAN MEHILLI EVANTHI LOLI NATASHA ASHIKU

BUKURIE KODRA THANAS MICA

(A. Ashiku: "Rilindësit e kohës sonë" f 16-18)

Letra është formuluar nga ana ime, është shtypur në makinën time "Omodoro" dhuratë e një emigranti shqiptarë në Kanada nga Sohodolli i Dibrës, në adresë të shokut të tij emigrant i hershëm në lagjen "Kipseli" të Athinës.

Firmëtarë të saj kanë qenë mësuesit Jovan-Mëhilli, Evanthi Loli, Natasha Ashiku, Bukurie Kodra dhe Thanas Mica.

Letra i është dorëzuar fillimisht ambasadorit tonë në Athinë Kastriot Robo ku edhe janë fiksuar nga ana ime disa fotografi të të pesë nismëtarëve.

Në mbështetje të nismës vjen një letër drejtuar Ambasadës Shqiptare në Athinë nga ana e Institutit Kombëtar të Diasporës, firmosur nga drejtori ThimiNika ku lajmërohet:

"Nga një grup mësuesish emigrantë me banim në Greqi informohemi se është formuar grupi nismëtar i mësuesve, i cili do të mësojë fëmijët e emigrantëve. Emrat e tyre janë:

1.JovanMëhilli
2.Evanthi Loli
3.Natasha Ashiku
4.Bukurie Kodra
5.Thanas Mica
Do lutemi të kontaktoni me ta..."

(Abdurahim Ashiku: "Rilindësit e kohës sonë" f . 21)

Përpjekjet vazhdonin. Pengesat ngriheshin e uleshin si dallgë furtunash detare. Në Selanik më 7 mars 2001 hapet kursi i parë i mësimit



ranti të Thivas në shkollën e parë shqipe në fshat. Më tej atë do ta gjejmë në seminaret pedagogjike tek "Porta", kurs i mësimit plotësues në Athinë. Do ta takojmë në seminarin e Selanikut, Korinthit... Në seminarin e organizuar nga Shkolla Shqiptare e Athinës Natasha do të vinte tashmë si pjesë e grupit nismëtar për kalimin e organizimit të mësimit të Gjuhës Shqipe në Greqi nga "Këshilli Pedagogjik" formuar në seminarin mbarëkombëtar të Durrësit në vitin 2007 në "Lidhjen e Mësuesve Shqiptarë në Greqi". Natasha Ashiku një ditë do të ndodhej në ishullin e Tinosit dhe të Sirosit së bashku me mësuesen e njohur në Dibër Dylbere Shehu në gjirin e rreth shtatëdhjetë nxënësve që nën drejtimin e mësueses së pasionuar Vera Shkurti hapën siparin e mësimit të Gjuhës Shqipe nga fëmijët e mërgimtarëve edhe në ishuj. Ndihmesa e saj për mësimin e fëmijëve mërgimtarë të shkruajnë e lexojnë shqip do ti kalonte kufijtë e Greqisë, do të ishte pjesë



Natasha Ashiku nxënësit e saj



Mësuesit e Selanikut

plotësues të gjuhës shqipe. Në Volos në tetor të atij viti ndizet një dritë tjetër. Shkolla Shqiptare e Athinës krijon kushtet më të mira jo vetëm për mësimin e kompjuterit dhe të gjuhës angleze por edhe të shkollimit në gjuhën e nënës, gjuhën e bukur shqipe. Vijojnë, pas vitit 2007 hapja e kurseve të reja për mësimin plotësues të gjuhës shqipe, shkolla, si na pëlqen ti quajmë... Natasha Ashiku në tërë këtë proces është aktive, e kudondodhur, jo vetëm në Athinë por edhe në Sa-

e përvojës që vinte nga Greqia në seminaret për mësimin plotësues të Gjuhës Shqipe në diasporë organizuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit dhe e Teknologjisë e Republikës së Kosovës. Atë do ta gjeje mes mësuesve në Mitrovicë, Prekaz, Buletin, në majat e larta të Bajgorës e në bregdetin e Ulqinit... Një jetë të tërë Ajo profesionin e mësuesit e ka pas brenda në shpirt. Rrethanat e jetës e detyruan që të mos e çojë deri në fund ëndrrën e jetës së saj në shkollën ku dha mësimin e parë, shkollën "Demirgashi" në vendlindje, mes brezash fëmijësh që rriteshin si gruri nën kujdesin shqip të saj. Larg vendlindjes e nxënësve të saj Natasha Ashiku e ndjeu se diçka kishte lënë pa bërë.

Ndaj, modestisht, e radhiti veten midis "Rilindësve të Kohës Sonë", siç i ka quajtur DritëroAgolli mësuesit vullnetarë të mësimit të gjuhës shqipe në Greqi.

Shkolla në Peshkopi, në prill të këtij viti, do të festojë 100 vjetorin e Ditës së Parë, e Orës së Parë të Mësimit Shqip...

Një gëzim për të, mësuesen e saj...
Një gëzim edhe për mua, nxënësin e saj...
Dhe një urim nga larg...
GËZUAR E PËR SHUMË VJET!

Abdurahim ASHIKU
Athinë, 29 mars 2014

reagim

Reagim kundër veprës së Mirjana P. Mirçevskës,
"Verbalni i neverbalni etniçki simboli vo Gorna Reka"

Reka e Epërme, plagë e pashëruar në popull

Saa mûnn t'mênnohet diëlli paa dritë,
Aq mûnn t' mênnohet komi paa gjuhë!
At Shtjefan Gjeçovi

Nga **EDIBE SELIMI-OSMANI**

Edhepse pjesa dërmuese e banorëve të Rekës së Epërme, ishin të detyruar të migrojnë në vise të ndryshme të botës, ata pa dallim feje sot kudo që gjenden qëndrojnë krenar, nuk ju tremben tërbimit të politikës as në të kaluarën dhe as sot.Bartin mbi supet e tyre kudo që gjenden traditën, folklorin, ritet, veshjen popullore shqiptare e tjerë.

Nga hulumtimet e bëra në terren gjatë viteve (1994-1997) dhe të botuara në veprën Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivar, Edibe Selimi-Osmani. Një vend të rëndësishëm në këtë krahinë e zënë mitologjia e besimet popullore me ritet e tyre përkatëse. Ato janë, shprehje e jetës shoqërore e shpirtërore të popullit, janë psiha e tij, janë ndjenjat e mendimet, janë ëndërrimet, me natyrën praktike apo dhe të mbinatyrëshme: në to shprehet gjallëria e njerëzve në jetë, përfytyrimet, vuajtjet e gëzimet...E vetmja krahinë që kremtojnë 44 kremte, që do të thotë se bëhet fjalë për një popull me tradita shekullore, pa dallim se cilës fe ata i takojnë.

Sipas disa burimeve të shkruara, popullsia e Rekës së Epërme, deri në vitet 60' të shek.XIX, e tëra fliste shqip e pra ishte shqiptare. Në tre dhjetëvjetshat e fundit të të njetit shekull është shpërbërë në anë gjuhësore. Për ta sllavizuar atë ndikoi administrta shtetërore: aty u hapën shkolla vetëm në gjuhën maqedone, u dërguan gjyqtarë, psalltë, ikonografë maqedonas dhe kështu u arritë që një pjesë e popullsisë ta nxjerrë nga përdorimi gjuhën shqipe (Shih për këtë:Echo de Bulgaric", Sofia, 1931, nr.4 f.2)[1]

Sipas të dhënave , po të J.Ivanoff-it, popullsia shqiptare në Dibër të Maqedonisë e në Pollog, po dhe më tej , u masakrua dhe u shfaros nga ushtria serbe më 1913; në këto rrethana gjetën vdekjen rreth 120.000 shqiptarë të këtyre viseve (Shih për këtë:I.Ivanoff, La Questie on Macedonienne..., Paris, Imprimerie, Rochon Jent-Buhler, 1920, f.158-159)[2].

Ndërsa sipas Patrikanës greke, turqit mbështetshin kishën sërbe, patrikanët sërb në Pejë dhe kishën e pamvarur të mitropolit në Ohër. I pëlqente apo jo patrikanit grek, nuk i interesonte. Po në atë kohë filluan dyndjet e hershme. Dyndjet më të rëndësishme ishin të priftërinjëve që nuk ishin të përgaditur për ta kryer profesionin e tyre. Për to u hapën shkolla të larta në Manastirin e Shën Bigurit... Edhe kjo ishte e pasuksesshme, atëherë populli hapi shkolla popullore. Mësuesit kanë qenë njerëz të ditur nga vise të ndryshme si nga krahina e Sërbisë, Bosnjës, Dalmacisë e tjerë. Me libra i furnizonte Sërbija. Mësuesit paguheshin nga 600 grosh në vjet...[3]

Shqiptarët nën këtë qiell të hapur ku jetojnë sot, edhe ata të Rekës së Epërme, këtu janë para ardhjes së sllavo-maqedonasve, por edhe para ardhjes së imperatorit turk. Nuk është lehtë t'i ç'rrënjosish ndjenjat, traditën, gjuhën dhe kulturën e një populli si që janë shqiptarët.

Vepër shkencore që përhap urejtje në mesin e popujve që kanë jetuar me shekuj dhe jetojnë edhe sot.

Na befason fakti që këtë vepër e mbështesin një grup recensues dr-prof. universitar si që janë d-r prof. Aneta Svetijeva, d-r prof Aleksandar Stojmilov, d-r prof.Krste Bogoeski, akademik prof. d-r Petar Vllahoviq, d-r.prof.Gjorgji Zdravev, dhe kanë lejuar që kjo vepët me shumë ofendime kundër shqiptarëve t'a mbrojedisertacionin shkencor Mirjana Mirçevska. Po ky libër i Mirçevskës, në të ardhmen do të shfrytëzohet si leteraturë profesionale, po ky libër që përhap urrejtje dhe e thellon atë në mesin e popujve që nderojnë njëri tjetrin.

Në hyrje të veprës Mirçevska, potencon se ka të bëjë me hulumtimin personal në segmente të kulturës popullore në kontinuitet dhe se pjesa më e madhe e materialit hulumtues është vjelur nga vetë autorja në terren gjatë viteve (1998-1999, 2000) kështu që edhe segmentet më të rralla të popullit të cilët jetojnë edhe sot, por nuk praktikohen, ata janë ruajtur në kujtesën e vet popullit dhe të shënuara me saktësinë më të madhe. Në vazhdim ajo shkruan: Pas shumë përpjekjeve për ta verifikuar identitetin etnik të banorëve të Rekës së Epërme, studimi kuptohet që nuk është imun i subjektivizmit.[4]



Në këtë krahinë përfshihen këto fshatra të banuara: Beliçica, Bibaj, Bogdeva, Vau(Brodeci), Vallkavija, Vërbeni, Vërbjani, Grekaj, Zhuzhnja, Kiçinica, Krakornica, Nistrova, Niçpuri, Ribnica, Senca, si dhe fshatrat e shpërngulura[5]. Autorja, nuk i përmendën fshatrat e djegura nga bullgarët dhe sërbët gjatë viteve (1912-1916), siç duket "nuk e ka vërrejtur" në literaturë ose qëllimisht nuk i ka përmendur.

Edhe pse Mirçevska në veprën e saj shkencore mundohet të na binde se:

Numri më i madh i shkencëtarëve konsideron se banorët e Rekës së Epërme, në mesjetën e hershme nëpër këto vise kanë kaluar barinjtë vlleh, të cilët në stinën e verës kanë kullotur kopetë e dhenve. Pikërisht këto llogariten si banorë të parë që kanë ndërtuar kasollat e përkohshme verore.[6]

TË DHËNA TË SHKRUARA NGA STUDIUES TË NDRYSHËM PËR REKËN E EPËRME

Ia bëjmë me dije Mirçevskës, se:

Emrin krahina e ka marrë nga qyteti i Dibrës, i cili përmendet, me sa dimë deri tani, qysh në vitin 1019, në një dokument të perandorit Vasili II.[7]

Në mesjetë emri i qytetit i kaloi edhe krahinës.

Më 1257, autori bizantin G.Akropolit, e përdor emrin e krahinës në shumës: Dibrat , gjë që tregon se ndarja e trevës në dy pjesë: Dibra e Sipërme dhe Dibra e Poshtme, që do të thotë se janë të njohura qysh në shekullin XIII.[8]

Dr. Pëllumb Xhufi, në studimin e tij shkencor, argumenton se qysh më 1273 Pal Gropa, sundonte në shumë territore në pronat e krahinave (Reka e Epërme dhe Reka e Poshtme).[9]

Më 27 mars 1308, në një dokument përmendet emri "krahina e Dibrës". Pukëvili shënon në këtë krahinë dy qytete:Dibrën e Epërme dhe Dibrën e Poshtme. Doktori Myler e shënon Dibrën me 500 shtëpi, kurse konsulli Hahn me dy mijë shtëpi. Vetë turqit në regjistrin e vitit 1467 e ndajnë gjithashtu krahinën e Dibrës në dy pjesë:Dibra e Poshtme dhe Dibra e Sipërme.[10]

Bashkimi i nahive Reka e Epërme dhe Reka e Poshtme, të cilët i takojnë sanxhakut Dibra e Epërme, bashkohen në një kaza me qendër në fshatin Trebishtë, 3.o4.1885.[11]

Milorad J.Mitreviq, shkruan: Në rrethin e Dibrës, më të fuqishmit janë shqiptarët: ata numrohen 52, 144 banorë. Në Rekën e Dibrës, e njohur te neve si rekali, ka shqiptarë krishter 8548[12]. Në Defterët, e shekullit (XIV, XVII) të përkthyera në gjuhën maqedone nuk përmenden sllavo-maqedonasit, por vetëm: shqiptarët, bullgarët, grekët, sërbët dhe vllehët[13].

Citojmë nga vepra Verbalni i neverbalni etni~ki simboli vo Gorna Reka, faqe 44 dhe 146: "Të parët-vendasit e fshatit Shtirovicë (sot krejtsisht të shpërngulur)... dikur të gjithë kanë qenë të krishterë... meshkujt ishin konvertuar, ndërsa gratë dhe baballarët ishin të krishterë.Ata i kanë varrosur në varrezat krishtere në fshatin fqi Reç.Duke e patur parasysh pozitën gjeografike të krahinës ata kanë ballë për ballë më parë popullin shqiptar fqinjësor, fiset shqiptare plaçkitës, bandit të cilët vazhdimisht kanë kryer vrrasje dhe vjedhje me leje dhe nën heshtjen e pushtetit lokal, kanë qenë të detyruar banorët e Rekës së Epërme të kërkojnë rrugdalje dhe ta pranojnë islamizmin. Shtirovicacit, gjithmonë kanë qenë njerëz keqtrajtues, kaçak, me nji fjalë keqan , të cilët pas zhdukjes së Shtirovicës, rekanase, kanë ikur në të njejtin fshat në Shqipëri, dhe prap prej atje gjithmonë i kanë sulmuar dhe i kanë plaçkitur banorët e Rekës së Epërme. .. .Shtirovicasit edhe kurbetin e kanë patur të pazhvilluar. Me një fjalë kanë egzistuar vetëm si barinj, shumica kanë qenë dhe anëtarë të grupeve plaçkitëse që kanë patur lidhje me Shqipërinë."

KUSH ISHIN VENDASIT E FSHATIT SHTIROVICË?

Shqiptarët nuk janë ardhacak, bandita, por kanë qenë janë dhe do të jenë një popull me kulturë të lartë, me traditë të lashtë dhe sidomos banorët e Rekës së Epërme. Nga hulumtimet e bëra në terren (1992-2011) dhe nga bisedat e shumta të bëra me banorë të Shtirovicës së shkretuar, kemi të dhëna të sakta edhe nga literatura e shfletuar se ky fshat ka patur më shumë se 300 shtëpi. Kanë jetuar të krishterë dhe mysliman . Shumica e banorëve në të kaluarën kanë marrë rrugën e mërgimit. Më së shumti kanë shkuar në Sërbi, Greqi-Selanik, Turqi, Bullgari dhe Rumani. Nga brezi i moshuar, mësuam se ka qenë fshati më i pasur në mesin e fshatrave Vërbjan, Ribnicë dhe Bibaj. Nga larg këto fshatra dukeshin si fole shqipesh të ndërtuara rënzë shkëmbit. .. Pikërisht në këtë fshat, në Shtirovicë, ka lindur stërgjyshi, gjyshi dhe babai im, i cili gjithmonë kujtonte kujtimet e paharruara si bullgarët e dogjën tërë fshatin dhe me të vërtetë sot në këtë vendbanim nuk mund të gjejshë tjetër por vetëm gurthemele, barë i rritur, gurëz dhe shkretirë, pa shtëpija dhe pa banorë. Babai im dhe të afërmit e familjes sime djegjen e fshatit e përjetuan. Një natë para se ta djegin fshatin, natë Bajrami, bullgarët dhe sërbët të cilët në atë kohë sundojshin i mblodhën 40 burra të fshatit Shtirovicë dhe 2 të tjerë që kishin ardhur mysafir nga fshati Niçpur. Në mesin e tyre ka qenë dhe gjyshi im, tre xhaxhallarët dhe më të afërmit e familjes sime. Të gjithë këta i kanë dërguar në manastirin e Shën Bigurit, i kanë vra një nga një, dhe i kanë hedhur në gropën e madhe të manastirit në të cilën gropë më parë e kanë shfrytëzuar për djegjen e gëlqeres. Nga të gjithë të masakruarit shpëtuan vetëm dy persona, rëndë të plagosur.Ashtu të plagosur pas dy ditë rrugë këmbësore arijtën në Shqipëri. Pas një kurimi të mirë, migruan njëri në SHBA, ku jetoi edhe 20 vjet, ndërsa tjetri në Turqi, ku ndroi jetë më 1985. Edhe pse personat që të dy ishin në moshë të thyer shëndetligë arijtëm të vijmë në kontakt dhe biseda jonë është e incizuar (kasetat e incizimit gjendet në arhivën e autores.)

Gjithashtu të gjitha këto informata i kemi shënuar nga babai im dhe të afërmit e mi që i përjetuan ndodhitë. Pasi Shtirovica u shkatërrua dhe u bë rrafsh me tokën popullsia shqiptare e atyshme u dëbua.Shumë prej tyre ishin të detyruar të jetojnë në Gostivar, Shkup, Saraj, Karshijakën e Shkupit kurse disa lagje ndodhen në Izmir të Turqisë.

Të shkruajsh për Shtirovicën, dhe të mos e përmendish Bajazit Elmaz Dodën, i lindur më 1888 në fshatin Shtirovicë, është absurde. Si shumë djem të regjionit të Rekës, edhe ai mori rrugën e mërgimit dhe shkoi në Rumani për të punuar. Në Bukuresht më 1906 takon albanologun, kontin Franz Nopsca, i cili tetëmbëdhjetëvjeçarin Bajazit Dodën, e pranon në punë.Edhe në vitet para dhe gjatë Luftërave Ballkanike, Nopsca, udhëtoi nëpër shumë zona të Shqipërisë Veriore, nëpër Kosovë e Maqedoni.

Pjesë të shkëputura nga vepra e Noscës: Nga urrejtja kundër çdo gjëje austro-hungareze, dhe ngaqë unë isha angazhuar shumë posaçërisht për Shqipërinë, nga urrejtja ndaj meje, serbët vranë në Shtirovicë, babin dhe vëllanë e Bajazitit më 1913.[14]

Studimi që u hartua nga Bajazit Doda, nën mbikqurjen e Franz Baron Nopsca, titullohet Jeta e bujqve në pjesën e epërme të Lugut të Rekës afër Dibrës.Fragment nga libri i B.E. (Botoi Albanika nr.72): Shtirovica i takon kazasë së dikurshme të Dibrës, vilajetit të Manastirit. Shtirovica , me njëqind shtëpitë e saj të banuara tërësisht nga shqiptarët. Në Shtirovicë ka shumë gurra ... Si pasojë e një politike shkurtpamëse dhe të prirur nga barbaria, është ndarë i tëri nga bota. Gjatë ndodhive të fundit ajo mbeti nën sundimin serb, si pasojë e ndarjes nga bota, mund të zhbëhet tërësisht nga faqja e dheut. Me qëllim që ta luftoj këtë të keqe, t'u ndihmoj bashkëfshatarëve të mi që të ruajnë tërësinë e tyre dhe njëkohësisht që të lë një vepër për të qenë në Shqipëri. Unë kam shkruar këtë studim mbi jetën e shqiptarëve në Lugun e Epërm të Rekës. Ajo çka ka shkruar Spiridon Gopçeviq në librin e tij namkeq Maqedonia dhe Serbia e Vjetër, 1889, rreth Rekës, është tërësisht e pavërtetë dhe gënjeshtër tendencioze, gjë që është argumentuar nga unë dhe shtegtarë të tjerë.

Unë nuk kam dashur as të bëj një studim etnografik, as ndonjë punim tejtër të ngjajshëm e shumë sfidues, por thjesht , trup e këput, të përshkruaj jetën e kësaj pjese të botës, ashtu siç e kam përjetuar ditë për ditë. Tevona, mu ata që kanë zhbërë shqiptarët e rrethit të Nishit, duket se do bëjnë të njëjtën edhe me bashkëfshatarët e mi... Dy vjet pas hartimit të këtij studimi, u shkatërrua dhe u bë rrafsh me tokën nga focat ushtarake bullgare. Sot regjioni është i pabanuar. Një botë e përftuar.[15]

(Vijon në numrin e ardhshëm)

---

[1] I.Ivanoff, Bëllgarite v.'Makedonija, Sofia, 1915, f.LXIII)
[2] I.Ivanoff, La Questie on Macedonienne..., Paris, Imprimerie, Rochon Jent-Buhler, 1920, f.158-159)
[3] Izdaëe Чupiђene zadu`bine GODI[ËICA NIKOLE Чupiђa (Izdaje ëegova zadu`bina, këiga XXI, u Beogradu 1901 u Beogradu) {tampano u dr`avnoj [tampariji Du{an Dadiђ, faq. 186-187.
[4] Mirjana P. Mir~evska, Verbalni i neverbalni etni~ki simboli vo Gorna Reka, Skopje, 13-14.
[5] Po aty f.16.
[6] Verbalni i neverbalni etni~ki simboli vo Gorna Reka, faq.17.
[7] Shif më gjërësishtë, në veprën Josif Bagri – Ruzhdi Mato f. 4 .
[8] Arian Kadiu, Dibra e Madhe –Sheheri i Dibrës (monografi), Toramë.2003, f.16.
[9] Arian Kadiu, po aty.
[10]Defteri i Dibrës dhe i Matit. Arkivi i Kryeministrisë, Stamboll, dosje 508, pranë AIH të Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë.
[11] Monografi e shkurt-Unikate e gjetur në Arhivin e Stambollit.
[12] Nova iskra Jedna statistika iz sredëe Maћedonije, 1899, str.250-251.
[13] D-r.Aleksandar Stojanovski Gradovite na Makedonija od krajot na XIV do XVII vek,
Institut za nacionalna istorija-Skopje, Zavod za unapreduvaëe na stopanstvoto vo SRM – Samoupravna praktika-Skopje, 1981.
[14] Albanika eksluzive, Shtator 2007, nr.72, faq.88-90.
[15] Autori, Robert Elsie, Vjenë, prill 1914, Bajazit Elmaz Doda, unter mitëirkung von Franz Baron Nopsca. Hrg. Von Robert Elsie, Albanisches Bauernleben im oberen Rekatal bei Dibra (Makedonien). Reihe: Balkanologie, Beitrage zur Sprach-und Kulturëissenchaft. LIT Verlag, Ëien 2007 ISBN 978-8258-0711-5) Përktheu nga doreëshkrimi dr. Baron Nopsca.

portret

Hibe Palikuqi mori pjesë në demostratën e 28 nëntorit 1942 në qytetin e Dibrës së Madhe bashkë me të rinj të tjerë Lutfi Rusi, Met Kërliu, Xhaferr Kodra, Avzi Muça, Shaban Qemali, Zinete Kërliu e disa të tjerë.

Heroina e Popullit Hibe Palikuqi

Nga **XHELAL ROÇI**

Hibe Palikuqi lindi më 1 maj 1927 në qytetin e Dibrës së Madhe. ajo shkollën fillore e kreu në vendlindje. Hibja që në moshën 9 vjeç mbeti jetime, se i vdiq i ati Sherifi dhe u rrit nën kujdesin e nënës së saj Lumnijes. Lumnija ishte grua e denjë, që ruante në kujtesë porositë e burrit të saj Sherifit, i cili atdheun dhe kombin i kishte të shpejtë dhe sa ishte gjallë punoi e veproi pa u lodhur për interesat e atdheut. Hibia shkollën e parë të edukimit, që e armatosi me ndjenjat patriotike dhe atdhetare e kreu në shtëpinë e saj. Ajo ishte shumë e vëmendshme dhe i pëlqenin tregimet historike, sidomos ata që kishin të bënin me historinë e Dibrës.

Nga fundi i vitit 1941 erdhën nga Tirana në Dibër të Madhe shokët Nazmi Rushiti, Irfan Hajrullai e të tjerë, të dërguar me mision nga Partia Komuniste Shqiptare, e krijuar më 8 nëntor 1941, për të organizuar luftën ANÇ kundër pushtuesve fashistë e bashkëpunëtorëve të tij në Dibër, Tetovë, Gostivar, Kërçovë e Strugë. Në vitin 1942, sinjalin e luftës së hapur partizane në Dibër e dha çeta e lirisë e krijuar dhe e komanduar nga Haxhi Leshi që më 20 qershor 1942, në fshatin Zogje të Grykës Vogël, në Dibër.

Familjen Palikuqi në Dibër të Madhe e lidhi me Luftën Antifashiste NÇ Irfan Hajrullai. Irfan ishte intelektual i formuar. Kishte aftësi të veçanta. U fitonte zemrën njerëzve dhe menjëherë i bënte për vete. Ishte propagandist komisar i vërtetë, ai dinte t'u krijonte urrejtjen për armikun, fashizmin italian që kishte pushtuar vendin e bashkëpunëtorët e tij. irfani i lidhi me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare Lumnije, Esherefin dhe Hibe Palikuqin. Ata e urrenin pushtuesin, që në Tiranë ishin lidhur me ilegalët që luftonin për liri. Hibia ishte vajzë e re, e rritur dhe edukuar me ndjenja atdhetare dhe me urrejtjen për armikun.

Shtëpia e familjes Palikuqi u bë bazë sekrete strehimi e furnizimi për partizanët dhe ilegalët që luftonin fashizmin. Në shtëpinë e tyre bëheshin mbledhje ku diskutoheshin e merrnin detyra për luftën. Aty mësoheshin e këndoheshin këngë partizane patriotike. Hibia megjithëse e re në moshë, u bë aktiviste shumë e vendosur. Asaj shkathtësia, zgjuarsia dhe vendosmëria për të kryer detyrat me korrektësi e besnikëri nuk i mungonte. Në atë periudhë kohe nga Shqipëria në Dibër të Madhe shkuan shumë arsimtarë për të dhënë mësime në shkollat shqipe që u hapën në ata territore të banuar nga shqiptarë.

Shkolla shqipe u hapën edhe në krahinat e Gostivarit, Tetovës, Strugës e rrethina. Hibia krijoi shoqëri të ngushtë me arsimtarët veçanërisht me dy arsimtarë në Dibër, Marieta Kreshovën dhe Erieta Pandukun. Edhe këto ishin aktiviste ilegale në ndihmë të LANÇ. Ata i sillnin Hibes libra dhe ajo i lexonte. Ata bashkëbisedonin me njëra-tjetrën për detyrat që kryenin në mënyrë ilegale në shërbim të Luftës Antifashiste Nacionalçliritmare.

Hibia krijoi shoqëri me familjen e Sulejman Bahollit i cili ishte i lidhur familjarisht me LANÇ. Ajo bashkëpunonte me motrat Sulës, Myzejenin, Qefseren dhe Doshin që zhvillonin aktivitet të madh e të gjithanshëm në shërbim të LANÇ. Doshi punonte infermiere, mjekonte edhe plagët e partizanëve. Ajo i kishte mjekuar plagën edhe Esheref Palikuqit kur ai ishte plagosur në luftë.

Nëna e Irfan Hajrullai, Aishja, ishte bazë kryesore e LANÇ dhe aktiviste në Dibër, ndërsa Irfani ishte person kryesor që drejtonte veprimet legale dhe ilegale në shërbim të LANÇ. Hibia kishte krijuar shoqëri të ngushtë me Aishen. Ajo shkonte me nënë Aishen nga njëra lagje në tjetrën dhe merrnin takim me gratë, të rejat, propagandonin kundër pushtuesve fashistë, bashkëpunëtorëve të tyre, mblidhnin ndihma për partizanët, ndërlidhnin ilegalët nga njëra bazë në tjetrën, shpërndanin materiale propagandistike, grumbullonin të dhëna informatike për armikun, sa forca ka, për armatimin, për rezervat ushqimore, për personat që bashkëpunonin e ndihmonin fashistët dhe këto të dhëna ua jepnin shokëve të lëvizjes. Hibia për efekt sekreti gjatë LANÇ mbante pseudonimin "Flaka".

Aishja dhe Hibia ishin komisare të vërteta popullore. Në këto veprime u angazhua edhe Lumnija, e ëma e Hibes.

Hibia që në vitin 1942 bënte pjesë në grupet edukative të rinisë në qytetin e Dibrës së Madhe. vullneti dhe guximi për të kryer detyra nuk i mungonin.

Hibia e mbuluar me çarçaf lëvizste nga njëra bazë në tjetrën dhe merrte takim me të rinj e



Pulle poste dedikuar dy heroinave tw popullit, Hibe Palikuqi dhe Liri Gego

të reja, aktiviste të LANÇ, u transmetonte atyre detyrat që merrnin nga shokët drejtues të LANÇ. Gjithashtu u shpërndante atyre materiale që vinin nga qendra. Këto veprime ishin me rrezik të madh mbasi fashizmi kishte organe të specializuar zbulimi e kundërzbulimi në Dibër që punonin për të zbuluar veprimtarët e LANÇ e aktivitetin e tyre revolucionar.

Hibe Palikuqi mori pjesë në demostratën e 28 nëntorit 1942 në qytetin e Dibrës së Madhe bashkë me të rinj të tjerë Lutfi Rusi, Met Kërliu, Xhaferr Kodra, Avzi Muça, Shaban Qemali, Zinete Kërliu, Esheref Palikuqi e disa të tjerë. Këto parakaluan me parulla antifashiste në dorë. Hibia me grupe shokësh shkonte edhe në fshatra përreth Dibrës. Ajo me të rinj të tjerë të grupit edukativ të rinisë si Lutfi Rusi, Xhafer Kodra, Met Kërkiu, Jeshar Hamja punonin me të rinjtë në fshatrat për rreth Dibrës. Mbanin lidhje me arsimtarët, aktivist të LANÇ që punonin e vepronin në ata fshatra si me Naide Çaushin, Erieta Pandukun, Marieta Kreshovën, Nasive Jahaagen e të tjera.

Punën me rininë në Dibër të Madhe e drejtonin komunistët Nazmi Rushiti, Sulejman Baholli, Irfan Hajrullai, Qemal Agolli. Këto ndiqeshin nga fashizmi dhe e kishin vështirë të lëviznin lirisht. Këto punë i bënte Hibia dhe shoqet e saj të mbuluar me çarçaf. Ajo i ndërlidhte ata me njërin-tjetrin.

Në Dibër ishte zakoni, që vajzat të mos dalin nga shtëpia. Ishte më e vështirë të punosh në Dibër se në qytete të tjera. Lufta Nacionalçlirimtare i përmbys këto zakone. Kështu vajzat e Dibrës si Hibe Palikuqi, Qerime Muça, Vera Jegeni, Vera Bogdani e disa të tjerë ditë e natë lëviznin dhe kryenin detyrat e LANÇ.

Për aktivitetet e LANÇ në muajin prill 1943 arrestohen nga kuestura, organ policor i fashizmit, të gjithë pjesëtarët e familjes Palikuqi, Lumnija, Hibia, Firdezi, ndërsa vëllai i tyre, Esherefi kishte dalë partizan dhe ishte bashkuar me çetën e Dibrës. Fashistët kishin siguruar informacion të plotë së Hibe Palikuqi ishte zgjedhur përgjegjëse e grupit edukativ të rinisë komuniste. Në drejtim të arrestuarve fashistët filluan hetuesi intensive duke përdorur torturat fizike dhe psikike. Ata u kërkonin të dhëna për lëvizjet e partizanëve dhe të vëllait të tyre Esherefit. Këto të tria nuk nxorën asgjë. I mbajtën në burg një javë dhe për mugnesë provash dhe nga presioni që bënte populli i qytetit të Dibrës së Madhe u detyruan t'i lirojnë nga burgu.

Ky veprim i fashistëve Hibes dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes Palikuqi u shtoi më shumë urrejtjen kundër fashizmit dhe u bënë më aktivë për LANÇ.

Në muajin shtator 1943, Hibe Palikuqi pranohet anëtare e Partisë Komuniste Shqiptare. meqenëse Hibia për aktivitete në shërbim të LANÇ kishte rënë në sy të fashistëve, ajo doli partizane dhe u bashkua me forcat e Batalionit partizan të Dibrës nga Haxhi Lleshi. Hibia nuk pranonte të qëndronte në prapavija. Ajo luftonte me vijë të parë dhe merrte pjesë në të gjitha luftimet e veprimet që zhvillonte batalioni. Mbas kapitullimit të Italisë fashiste disa kohësh Dibra ishte zonë e lirë. Në këtë kohë në qytetin e Dibrës së Madhe ndodhej edhe shkrimtari i shquar dibran Haki Stërmilli.

Hibia që kishte lexuar romanin e tij "Sikur t;isha djalë" shkruan në vitet 1930 i doli përpara me uniformë partizane, me automatik në gjok dhe i tha: "Mixha Haki, apo të dukem si djalë? Djalë dhe shkuar djalit, një djalë që se kisha menduar kurrë, iu përgjigj shkrimtari i cili tashmë kishte veshur uniformën njëlloj si Hibia. Hibia ishte e veshur me xhaketë, pantallona, rrip krahëqafë, çantë, bllok, laps, kapele bushtine dhe automatik anglez. Reaksioni, bashkëpunëtor të fashizmit u përpoqën më kot për ta ripushtuar qytetin e Dibrës. Populli nuk dëgjonte parinë, por dëgjonte Irfan Hajrullain, partizanët, jo bashkëpunëtorët e fashizmit. Kur këto nuk mundën ta pushtonin, thirrën në ndihmë gjermanët të cilët në muajin nëntor 1943 e sulmuan Dibrën e Madhe me tanke, artileri e aeroplanë. Gjatë luftimeve në Dibër të Madhe pati shumë të vrarë, të plagosur, shtëpi të djegura e të shkatërruara. Partizanët me shumë vështirësi u detyruan të tërhiqen nëpërmjet një shtegu dhe kaluan nëpër lumin Drin. Hibia gjatë ditëve të Luftës në datat 31 tetor, deri ë 3 nëntor dhe 16-17 nëntor 1943 tregoi shumë trimëri në luftimet në Dibër të Madhe.

Në këtë kohë Irfan Hajrullai për aftësitë që kishte treguar në organizimin e LANÇ në Dibër të Madhe u dërgua me detyrë për të organizuar luftën në zonën e Kërçovës me disa shokë të tjerë. Por atje një dorë e zezë ndërsa ishte me shërbim e vrau mbas shpine. Kjo ishte një humbje e madhe për Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe për familjen e tij.

Gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre në Dibër të Madhe shtëpinë e parë dogjën atë të nënë Aishes. Aishja pa iu trembur syri tha: Turp të keni. Shtëpinë digjeni... digjeni, por edhe vetë në zjarr do të digjeni. Ne kemi për ta ndërtuar shtëpinë përsëri, bile edhe më të mirë se sa e kishim.

Megjithatë familja Hajrullai nuk u shkëput nga Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare, përkundrazi të gjithë pjesëtarët e familjes u lidhën e u aktivizuan më shumë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Irfan Hajrullai është dëshmor i atdheut.

Mbasi u pushtua Shqipëria dhe Dibra nga gjermanët, batalioni partizan i Dibrës u nda në disa grupe dhe kaloi në ilegalitet. Hibia me dy tre shoqe të saj shkoi në fshatrat Zhupe, Ballancë, Selcë dhe deri në Karaoman. Kjo kishte vështirësi shumë të madhe për të lëvizur. Ishte femër në moshë të re, akoma pa i mbushur 17 vjeç, në gjurmim të vazhdueshëm nga nazistët gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tyre, nën presion të fanatizmit të madh, që trashëgonin ata fshatra në atë zonë, Hibia punonte natë e ditë për të kryer detyrat.

Bashkëpunëtorët e armikut krijonin thashethemeë e intriga ndaj saj me qëllim që ta izolonin e t pengonin të mos mund të kryente detyrat që ajo i kishte vënë vetes. Këto veprime bëheshin me qëllime të caktuara e konkrete për të dëmtuar Luftën Nacionalçlirimtare e për ta larguar popullin nga lufta. Hibia kishte fituar autoritet dhe dashuri në popull.

Fjala e saj dëgjohej jo vetëm nga gratë e të rinjtë, por edhe nga burrat. Ata e strehonin e mbanin në familjet e tyre duke e fshehur nga pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tij. kishte nga ata që e ndihmonin për të kryer detyrat që lidheshin me LANÇ. Lufta partizane e kishte kalitur Hiben. Ajo kishte marrë pjesë në aksione e luftime me batalionin partizan të Dibrës.

Lidhjet që kishte mbajtur me intelektualë, me arsimtarë, me njerëz të shtresave të ndryshme dhe literatura që ajo kishte lexuar e kishin përgatit e kalit Hiben, e kishin bërë atë më të ndërgjegjshme për të kryer detyrat e LANÇ. Hibia i kishte mësuar edhe dredhitë e armikut dhe të bashkëpunëtorëve të tij. Ajo e dinte se ata janë të pabesë, armiq të kombit dhe të atdheut edhe në çdo veprim ruhej nga provokacionet e intrigat që ata mund të kurdisnin. Ishte koha e operacionit armik të dimrit, reaksioni i lidhur e i ndihmuar nga nazistët gjermanë kishte arritur kulmin e ashpërsisë për të eliminuar jo vetëm partizanët, bazat e LANÇ, Këshillat Antifashist Nacionalçlirimtar por edhe simpatizantët e thjeshtë të kësaj lëvizjeje. Hibia qëndronte në fshatra, lëvizte nëpër bazat e luftës në ilegalitet, propagandonte kundër pushtuesve e bashkëpunëtorëve të tij, shpërndante materiale propagandistike në popull. Të gjitha këto veprime i bënte për të mbajtur gjallë frymën luftarake, optimiste e besimin e popullit në fitoren e lirisë.

Në këtë kohë partizani Lutfi Rusi që edhe ky zhvillonte aktivitet ilegal në shërbim të LANÇ në Dibër me disa shokë të luftës e tërhoqën Hiben nga fshatrat dhe e sollën në qytetin e Dibrës. Porsa erdhi në qytet, Hibia, filloi menjëherë nga aktiviteti. Ajo qytetin e njihte shumë mirë. Disa nga bazat e luftës i kishte njohur. Ishte periudha e dimrit të vitit 1943-1944, Hibia e mbuluar me çarçaf, me bomba në gji, me armën e brezit të fshehur në rrobat që kishte veshur lëvizte nga njëra bazë në tjetrën.

Krijoi menjëherë lidhje me ilegalët, propagandistike kundër nazistëve e bashkëpunëtorëve të tij. Mbante gjallë frymën optimiste për t'u shtuar besimin e plotë në fitoren e plotë të lirisë, çlirimin e plotë të vendit nga pushtuesit e huaj. Realizonte ndërlidhjen në mes ilegalëve të cilët ndiqeshin nga pushtuesit e qëndronin në baza të veçanta. Grumbullonte ndihma për partizanët dhe familjet e dëshmorëve që kishin mbetur të izoluar. Të gjitha këto veprime i bënte nën hundën e armikut e bashkëpunëtorëve të tij, në mënyrë shumë të maskuar. Ajo mbante lidhje me njerëz nga shtresa të ndryshme të popullsisë, me gra, me të rinj, të reja, burra, me arsimtarë, tregtarë, fetarë, të moshuar edhe ushtarak që punonin e shërbenin në formacionet e armikut por që ishin në shërbim të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në këtë kohë këto nuk ishin të paktë.

Duke vlerësuar veprimtarinë e aktivitetin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Haxhi Lleshi, "Hero i Popullit" dhe "Hero i luftës së II Botërore", në kujtimet e tij, "Vite, njerëz dhe ngjarje" shkruan: - Shembullin kryesor gjithmonë e jepte Dibra e Madhe, ku edhe në kushtet e reaksionit më të egër, kishim veprues të tillë, shokë të vendosur, si Esheref Palikuqi, Hibe Palikuqi, Skënder Pustina, Qeram Greva, Xhafer Kodra, Aziz Asllani, Amzi Muça, Qerime Muça, Zinete Kërliu e shokë të tjerë.

Në muajin janar 1944 organizata e rinisë bëri mbledhje në kushtet e ilegalitetit në shtëpinë e Fiknete Kërliut. Merrnin pjesë Esheref Palikuqi, Hibe Palikuqi, Femi Muça, Qeram Kaba, Qeram Greva e Hyqmet Gonxha etj. Puna e Hibe Palikuqit u vlerësua shumë e mirë. Ajo u quajt komisare e vërtetë popullore.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Taf Cani shpëtoi fshatin
nga një masakër

Taf Can Ajazi, *mjeku popullor që shpëtoi Lurën nga masakra*

Nga **RAMADAN AJAZI**

Tafa lindi në fshatin Arrëmollë, Lurë e Dibrës në vitin 1907 dhe ndërroi jetë në vitin 1971. Ishte biri i Can Dali Ajazit. Vinte nga një familje patriote dhe antikomuniste. Të parët e tij kishin bërë emër brez pas brezi. Hasan Ajazi ishte në pleqtë e parë të Lurës. Fjala e tij e mençur dëgjohej me vëmendje dhe zinte vend. Në këtë ambient lindën dy djemtë e Canit, Hazizi e Tafa. Në memorien e tyre natyrshëm u rrënjosën tiparet më të shkëlqyera të familjes, fisit dhe krahinës si: Besa e mençuri, guximi e bujaria dhe atdhetarizmi.

Tafa ishte me trup të lartë e të shëndetshëm, me pamje të hijshme, fisnik. Ishte serioz, por i dashur dhe me humor. I matur në dhënien e mendimeve, por i vendosur në realizimin e tyre. Zëri i tij kishte një tingull të veçantë, të qetë e tërheqës, por toni i ligjëratës ndryshonte sipas karakterit që kishte biseda. Tafa urrente: Servilët, parazitët e llafazanët. Humori i tij godiste pa mëshirë veset e këtyre tipave. I vinte në lojë duke i detyruar të qeshnin edhe ata vetë, kurse Tafa rrinte serioz dhe i futur në mendime.

Në kohën e Monarkisë, Tafa ishte efektiv i Gardës Mbretnore me detyrën e nënoficerit. Zëri i tij ishte piskamë. Për këto merita iu dha detyra e komandimit të efektivit të gardës. Çdo mëngjes e mbrëmje efektivi do komandohej nga nënoficeri Taf Cani.

Mbas vitit 1939, Tafa kthehet në vendlindje, në Arrëmollë. U caktua me problemet e fshatit. Ishte personi më i respektuar dhe më i afti. Mbas çlirimit drejtoi për disa vite si kryetar i këshillit të fshatit. Drejtoi me moral të lartë e me korrektësi. Në të gjitha gëzimet apo hidhërimet që kishin familjarët, Tafa do të ishte i pranishëm, do ti besohej drejtimi. Aftësia e tij ishte e padiskutueshme. Çdo gjë e përdorte me nikoqirllëk.

KANALI VADITËS I TAF CANIT

Fshati Arrëmollë kishte dy kanale. Njërit i merrej uji nga lumi i Mollës dhe tjetrit nga gura e Lmorit. Me këto dy kanale vaditeshin vetëm 80 për qind e tokave. Me kalimin e kohës familjet u shtuan, detyrimisht do të hapeshin toka t'reja, të cilat nuk i mbulonin kanalet ekzistuese. Për të mposhtur thatësirën duhej të hapej një kanal i ri me ujin e lumit t'Mollës. Për këtë qëllim kishte menduar Taf Cani. Mendimin e tij ua parashtroi fshatarëve. Këtë e pritën me entuziazëm mendimin e Tafës. Po problemi ishte: Kush do të jetë projektuesi dhe zbatuesi i kësaj vepre. Me fjalë të tjera, inxhinieri. Përgjigjau dha e menjëhershme nga vetë ideatorë i saj: Projektuesi dhe zbatuesi i kanalit do të jetë inxhinieri pa diplomë, Taf Cani. Fshatarët u përgjigjën unanimisht: "Ne jemi të gjithë në rresht pas teje or Taf!".

Tafa filloi projektimin e kanalit pa patur as mjetin më të thjeshtë, nivelin e ujit dhe as mjetin më të thjeshtë, nivelin e ujit dhe metrin. Po mendja, syri dhe dora e tij ishin mjetet më të sakta e të pagabueshme. Me një shkop, me një fije peri dhe me dy kunja, me syrin e tij shigjetë që nuk e gënjente, projektoi kanalin n'atë terren të thepisura që vetëm këmba e dhisë mund të kalonte. Mobilizoi fshatarët, i ndau në grupe, caktoi punën për secilin grup dhe me entuziazëm, filloi puna. Tani, Tafa do të zbatonte projektin, do të organizonte punën dhe do të shikonte cilësinë.

Brenda një kohe rekord, uji i lumit të Mollës gurgulloi në krye të fshatit. U gjallërua bujqësia, mirëqenia ekonomike e fshatarëve. Urimet dhe lavdet iu drejtuan inxhinierit pa diplomë, projektuesit dhe zbatuesit të këasj vepre, Taf Can Ajazit. Këtij njeriu të mirë që vetë zoti e kishte lindur për të bërë të mira dhe vetëm të mira. Thellë nga zemra e atyre fshatarëve të urtë, e punëtorë pa llafe, bujar pa interes, të respektueshëm e shumë të dashur, natyrshëm dilte urimi: "Të paçim për jetë e mot or Tafë"!

TAFA MJEK POPULLOR

Tafa ishte një mjek popullor pothuajse kishte mbaruar shkollën përkatëse. Me sy, me veshë, e dorë ishte në gjendje të përcaktonte sëmundjen.

Me bimët medicinale që kanë malet e Lurës mbi tokë e nën tokë (rrënjët), përgatiste ilaçe sipas sëmundjeve si: Dhimbje koke, barku, grip, kollitje dhe temperaturë. Por edhe sëmundje që shfaqeshin në sipërfaqen e jashtme të lëkurës, puçrra apo plagë të shkaktuara nga sende rrethanore deri në plagët e shkaktuar nga arma.



Taf Can Ajazi ishte me trup të lartë e të shëndetshëm, me pamje të hijshme, fisnik. Ishte serioz, por i dashur dhe me humor. I matur në dhënien e mendimeve, por i vendosur në realizimin e tyre. Zëri i tij kishte një tingull të veçantë, të qetë e tërheqës, por toni i ligjëratës ndryshonte sipas karakterit që kishte biseda. Tafa urrente: Servilët, parazitët e llafazanët. Humori i tij godiste pa mëshirë veset e këtyre tipave...

Për mjekimin e plagëve, Tafa përgatiste një ilaç të veçantë, Melhem. Për përgatitjen e melhemit bashkonte katër komponentë: Dyll blete, gjalp lope, lëvore shtogu, rrëshirë pishe. Mbasi bënte bashkimin e tyre, i fuste në tigan dhe i vinte në prushin e zjarrit. I linte për një kohë të zienin. Me kujdes veçonte lëngun. Ky ishte Melhemi, i cili kishte ngjyrën dhe formën e mjaltit. Me këtë ilaç, mjeku popullor Taf Cani ka shëruar shumë persona në fshatrat e Lurës.

TAF CANI SHPËTOI FSHATIN NGA NJË MASAKËR

Pas çlirimit kur vendit i vinte akoma era barut, një kompani e forcave të ndjekjes kalon natën mespërmes fshatit Arrëmallë. Në të dalë të fshatit ndodhej shtëpia e veçuar e vëllezërve Vladi, Sulës e Misimit bashkë me nënën e tyre. Kur forcat kaluan pranë banesës në dritare dukej një dritë. Komandanti dyshoi. Urdhëroi dy forca të shkonin e të verifikonin banesën. Ata shkuan, trokitën në derë dhe kërkuan të futeshin brenda. Por për fat të keq në banesë ndodheshin dy t'arratisur në ambientet e brendshme të saj. Personat në fjalë e kuptuan se ishin të rrethuar.

Për të shpëtuar duhej të kalonin vetëm nga dera kryesore, tek e cila ndodheshin dy forcat kundërshtare. T'arratisurit urdhëruan plakën të hapte derën. Dera u hap. Ata, të ndodhur në gadishmëri prapa shpinës së nanës gjuajtën dy forcat. Njëri prej tyre mbeti i vdekur pranë portës. Kjo bëri të mundur largimin me shpejtësi të personave në fjalë pa pësuar asgjë.

Forcat e ndjekjes arrestuan Sulën e Misimin. Komandanti u egërsua dhe vendosi të hakmerrej me fshatin reaksionar. Egërsinë e komandantit, që tashmë kishte arritur kulmin e zbuti Taf Cani. Me guximin e zgjuarsi, pa marrë parasysh rrezikun e tij, të nesërmen me të dalë drita, shkoi në vendngjarje, aty ku ishte kufoma. Me mjeshtri t'rrallë, e duke luajtur rolin e një artisti profesionist që për momentin rrallëkush mund ta luante, takoi komandantin, kaloi mes përmes forcave të ndjekjes duke i ra me grushta kokës e duke qarë me zë të lartë për këtë humbje të madhe. Shkoi tek kufoma, qëndroi pranë kokës viktimës, u ul në gjunjë dhe nisi vajtimin me zë të lartë e me lotë në sy.

Të vranë armiqtë, o vllai im, o vlla
Hakun do ta marrim, o vllai im, o vlla
Ju na larguat natën, o vllai im, o vlla
E na sollët dritën, o vllai im, o vlla.
Në shpitë tona erdhi lumturia, o vllai im, o vlla
Tani vendin e mbuloi zija, o vllai im, o vlla
E gratë tona kanë vu shami t'zeza o vllai im, o vlla

Në fakt gratë luriane shami t'zeza mbajnë në kokë.

Të gjitha fjalët, Tafa i shoqëronte me zë të lartë, me lot, e duke i ra kokës me grushta. Me rolin e tij prej artisti që vetëm në filma shikohen, mallëngjeu komandantin dhe gjithë efektin. Shpëtoi fshatin nga një masakër e ngjashme me atë që bëri Shefqet Peçi në zonën e Kuksit.

Fshati shpëtoi falë zgjuarsisë së guximit të Tafës, por nuk shpëtuan vëllezërit Vladi, Sula e Misimi. Këta mbas një gjykimi të kohës së partizanllëkut u dënuan: MIsimi me pushkatim dhe Sula më burg. Por edhe ky vdiq në burgun famëkeq të Burrelit nga torturat e gardianëve.

Taf Can Ajazi me vajtimin e tij (në thonjëza) po ironizonte fund e krye regjimin komunist, këtë farë të keqe që erdhi në pushtet duke vrarë pa mëshirë: Ballist e zogist, intelektual nga familjet më të mira të vendit. Babëzia vazhdoi për një gjysmë shekulli. Përdori etiketime të padëgjuara si: Kulak, armik, fashist, nazist etj. Presionet psikologjike vazhdonin: E di kush je, i kujt je, kë ke dajë, kë ke nip e tjera e tjera.

Alegoria e Tafës po u thoshte haptazi: O vëllezër të mallkuar. Ju na sollët natën, na mohuat lirinë, na sollët varfërinë ekstreme, atdheun e kthyer në nj kamp të rrethuar me tela me gjemba. Na detyruat që edhe natën në gjumë të thoshnim: "Parti Enver". Edhe fëmija kur fillonte të fliste dy fjalët e para ishin "Parti Enver" në vend të fjalëve: Babi e mami. Këto të vërteta Tafa ua këndoi tek koka asaj fare të keqe që vazhdoi të sundonte për një gjysmë shekulli.

Në brezin e Taf Canit kanë shkëlqyer edhe disa figura të tjera. Ata nuk duhen harruar, jo vetëm nga moshatarët e mi që kemi patur fatin t'i njohim e të jemi pasardhësit e tyre, por duhet tua bëjmë të njohur edhe brezit të ri. Këta duhet ta dinë se kush ishin gjyshërit e tyre, si e përballuan diktaturën më të egër që ka njohur populli ynë. Ata ishin burra fisnikë, të besës, guximit, bujarisë, të mençur, të urtë e të çiltër. Me alegorinë e tyre thumbonin ashpër: Dembelët, llafazanët, matrapazët, të pabesët, hajdutët dhe kopracët. Mjeshtria e tyre godiste edhe diktaturën e diktatorin që me forcat e veta po ndërtonte socializmin, parajsën e vërtetë.

Fshati Arrëmollë ka patur brez pas brezi burra me emër, por ata që i kemi njohur e i kemi dëgjuar me vëmendje janë: Taf Cani, Hasan Nura (Vladi), Mehmet Xhetan Ajazi, Xhem Dulla (Vladi), Sul Ramadan Ajazi, Zenel Musa, Liman Buci, Ahmet Peka.

Në jetën familjare, Taf Cani u gëzua me lindjen e dy djemve, Daliu e Xheladini dhe vajza Nafija. Ishte koha kur sistemi komunist e kishte varfëruar popullin në maksimum. Tafa i edukoi fëmijët që edhe në kushtet e krijuara jeta duhet përballuar me dinjitet. Daliu vazhdoi me vendosmëri në rrugën e tij. Përballoi me sukses sfidat e kohës.

Në jetën familjare, Daliu pati fatin të lumturohej me lindjen e gjashtë djemve, secili më i mirë se tjetri: Të dashur, të mençur, korrekt, familjar, shembullor e të zotët e punës.

Pas viteve '90, të gjashtë djemtë e Daliut të prirë nga vëllai i madh Shefqeti u vendosën njëri pas tjetrit në zonën e Kamzës, Tiranë. Ndërtuan shtëpi bashkëkohore, hapën lokale e u sistemuan në punë të ndryshme. Krijuan kushte normale jetese. Jetojnë pranë njëri-tjetrit në harmoni të plotë.

Dy prindërit Daliu e Hankja patën fatin t'i shohin fëmijët e tyre të rritur me sakrifica të sistemuar, të martuar e me fëmijë.

Tani as Daliu as Hankja nuk jetojnë më, por u lanë amanet djemve që të vazhdojnë rrugën e gjyshit, Tafës dhe të prindërve, Daliut e Hankes.

Botim i ri



Femi Sufaj
SISTEMI I NDËSHKIMEVE NË SHQIPËRI GJATË REGJIMIT KOMUNIST 1945 - 1990

Botimet Dita 2000
ISBN: 978-99956-92-96-4
Çmimi: 1000 lekë

Në kuadrin e rishikimit të historisë së sotme të Shqipërisë dhe veçanërisht të periudhës komuniste, tema e mësipërme hedh dritë në një aspekt shumë të rëndësishëm të historisë së vendit tonë. Studimi në fjalë do të ndihmojë për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Europës në Rezolutën nr. 1096 datë 27.06.1996 dhe nr. 1481 datë 25.01.2006 si dhe vendimin e Kuvendit të Shqipërisë për dënimin e krimeve të komunizmit.



Përshëndetje miq!

I larguar nga shtëpia që në moshën 15 vjeçare, por asnjë moment nuk kam harruar që jam Shqiptar! Në këtë drejtim më ka ndihmuar shumë dhe ajo që unë jam rritur në një familje shumë patriotike. E kam treguar identitetin tim kudo ku jam ndodhur, gjë që tashmë e kam të fotografuar në krahun tim.

Kam pasur gjithmonë dëshirë të bëj ndeshje në Shqipëri, gjë të cilën e arrita në 2007, por ëndërr të ndeshem në vendin tim të lindjes dhe të dëgjoj brohoritjen e fansave të mi, në tokën në të cilën kam hedhur hapat e mi të parë!

Më në fund ëndrra ime do të bëhet realitet, pikërisht më 18 tetor 2014!

Mbështetja dhe brohoritja juaj janë katalizatori i aksionit tim!

Falëminderit të gjithëve!

Gjetan Keta

NDIQ DREJTPËRDREJTË NDESHJEN

KETA - KHUZEEV

BULQIZË, 18 TETOR 2014

Pajtohu në gazetën
RRUGA E ARBËRIT

***Merr versionin* PDF ose kopjen**
print duke filluar me 50 lekë/muaj



Gazeta ofron faqet e saj
për REKLAMA apo NJOFTIME
të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME
për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë
(1/16 e faqes) ofrohen falas!

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603



Princesha e Mynihut takon Ambrën

"Ndihem shumë e vlerësuar kur një nga princeshat e Mynihut vjen për të më vizituar në spital. Është një kënaqësi për mua të bashkëbisedoj me të rreth meje, rreth sëmundjes time si dhe të njoh njerëz të tillë!

Ky bashkëbisedim është publikuar edhe në revistat Gjermane. *(Ambra Meda)*